Model		Sum of Squares	Df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	17.909	1	17.909	16.792	.006^b
	Residual	6.399	6	1.067		

2	Total	24.309	7			
	Regression	21.882	2	10.941	22.545	.003 ^c
	Residual	2.426	5	.485		
	Total	24.309	7			

a. Dependent Variable: Вкупна Продуктивност На Економијата

b. Predictors: (Constant), НФК_Вкупно

c. Predictors: (Constant), НФК_Вкупно, Инфлација

Во Табела 10 според нестандардните коефициенти утврдуваме дека влијанието на НФК е незначајно или многу мала (сама) врз Вкупната продуктивност на економијата каде за една константа на Вкупната продуктивност на економијата резултира .000 стапка на НФК, но НФК заедно во група со стапката на инфлација имаат значајно влијание на Вкупната продуктивност на економијата каде што за една константа на Вкупната продуктивност на економијата резултира -.505 (негативна) стапка на НФК и Инфлација.

Табела 10. Стандардни и Нестандардни коефициенти

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error			
1	(Constant)	-6.348	1.612		-3.937	.008
	НФК_Вкупно	.000	.000	.858	4.098	.006
2	(Constant)	-4.354	1.292		-3.371	.020

НФК_Вкупно	.000	.000	.682	4.421	.007
Инфлација	-.505	.177	-.441	-2.861	.035

a. Dependent Variable: Вкупна Продуктивност На Економијата

3.3 Резиме на заклучоци

- заклучиме дека стапките на нефункционални кредити на големите банки има ист статистички тренд како на малите банки за разлика од средните банки кои според распоредот на модата, медијаната и средната вредност, за средните банки може да заклучиме дека има асиметрична негативна распределба на стапките во периодот 2006-2020, за разлика од големите и малите банки кои имаат исто така асиметричка распределба на стапките во овој период но позитивна асиметрија.
- заклучивме дека има нагорен во раст на вкупните активи на банките што со проста компарација со стапките на нефункционалните кредити во земјата кореспондира со растот на вкупните активи
- во 2015-16 година со највисока стапка на нефункционални кредити и највисока вкупна актива на банките генерално.
- стапката на БДП на РСМ за периодот од 2006-2020 варира од -4.5 за последната пандемска 2020 година па до позитива 6.5 за 2007 година кога според статистика се и најголемите стапки на Директните Странски Инвестиции во земјата.
- стапката на инфлација последните 3 години 2018-2020 е во пораст како лош индикатор на развојниот тренд на економијата на Република Северна Македонија!

- вкупната продуктивност на економијата на земјата за овој период од 2012-2019 година, кое од 2016 е во постоен пад.
- постои негативна значајна корелација $R = -.534$ со $\text{sig} = .040$ ($p < 0.05$) помеѓу БДП и Вкупната Актива на банките (БА), со други зборови со порастот на стапката на БДП се намалува Вкупната Актива на банките во земјата за овој период.
- постои негативна значајна корелација $R = -.525$ со $\text{sig} = .045$ ($p < 0.05$) помеѓу НФК и стапката на инфлација, со други зборови со порастот на НФК се намалува инфлацијата во земјата за овој период.
- постои висока позитивна значајна корелација $R = .858$ со $\text{sig} = .006$ ($p < 0.01$) помеѓу НФК и Вкупната продуктивност на економијата, со други зборови со порастот на НФК расте и вкупната продуктивност на економијата на Република Северна Македонија за овој период.
- постоење на негативна значајна корелација $R = -.714$ со $\text{sig} = .047$ ($p < 0.05$) помеѓу Вкупната продуктивност на економијата и стапката на инфлација, со други зборови со порастот на Вкупната продуктивност на економијата се намалува инфлацијата во земјата за овој период.
- постои значаен импакт врз БДП од страна само од вариаблата на Инфлација, но не и од стапката на НФК кое и анализираме со овој труд.
- По обработката на податоците со Линеарна регресија за Вкупната продуктивност на економијата според другите вариабли (Stepwise) според $R = .858$ за НФК и $R = .949$ за НФК и Инфлација заедно, и според $\text{sig} = .006$ и $\text{sig} = .003$ утврдуваме дека постои значаен импакт врз Вкупната продуктивност на економијата од страна на вариаблата на НФК и Инфлација.
- влијанието на НФК е незначајно или многу мала (сама) врз Вкупната продуктивност на економијата, но НФК заедно во група

со стапката на Инфлација имаат значајно влијание на Вкупната Продуктивност на Економијата на Република Северна Македонија.

- Генерална констатација дека Нефункционалните – Проблематичните кредити се поврзуваат само со Вкупната Продуктивност на Економијата на Република Северна Македонија за периодот од 2006-2020, значи, повисоката стапка на НФК во Република Северна Македонија се подразбира повисока стапка на Вкупната Продуктивност на Економијата, но да се напомене дека ова поврзаност на НФК е заедно во група со стапката на Инфлација.

4. ЗАКЛУЧОК

Основната цел на оваа истражување беше да се анализира концептот и природата на проблематичните кредити со ризикот кој го носат како за банкарскиот систем така и севкупно за економијата на Република Северна Македонија во глобала. Исто така, во теоретската анализата на проблематичните кредити и кредитниот ризик може а заклучиме дека проблематичните кредити и кредитниот ризик се еден од основните ризици со кои се соочуваат банките и неговото навремено идентификување, мерење, контролирање и пратење претставува темел за успешно работење во банките. Со цел ова да се постигне банката е должна да формира посебна организациона единица чија работна активност ќе биде во опсегот на управување со ризикот. Исто така, банката е должна во своите акти да пропише процедури за идентификување, мерење и оценување и управување со ризикот.

Банкарскиот менаџмент постојано прави компромиси помеѓу големината на ризикот и големината на стапката на приходи.

Банките со пласманот на кредити генерираат приходи, но од друга страна тие се соочуваат и со кредитниот ризик кој не може целосно да биде елиминиран. Кредитниот ризик е најважниот во банкарската индустрија, адекватното управување со овој ризик е основна цел на банките. Кредитниот ризик се дефинира како можност од загуба поврзана со намалување на кредитниот квалитет на должникот или договорните

страни. Во портфолиото на банката, загубите произлегуваат од неисплаќање на обврските поради неспособност или неподготвеност на клиентот или другата договорена страна да ги исполни обврските во врска со заеми, тргување и други финансиски трансакции. Кредитниот ризик главно произлегува од дадените кредити и аванси на клиенти и други банки, издадени гаранции и акредитиви и вложувања во хартии од вредност.

Исто така , може да се наведе и заклучокот дека најчестите проблеми во процесот на управување со кредитниот ризик со кои се соочуваат банките се:

- Недоволно следење на економските, правните, политичките и останатите околности може да доведе до намалување на кредитниот рејтинг на банките;

- Несоодветно одредување на цената на ризик;

- Прекумерен раст на кредитната активност;

- Прекумерена концентracија;

- Недоволна контрола на должниците и на колатералот;

- Неквалитетен пристап на управување со портфолиото на кредитната изложеност

Но сепак треба да се напомене дека и покрај стабилниот кредитен рејтинг кој го има Република Северна Македонија, кредитниот ризик е најзастапениот ризик во банкарскиот сектор, кој се должи пред сè на учеството на бројот на нефункционалните кредити во вкупните кредити. Со ова констатација се надоврзуваме и на заклучоците од емприскиот дел на истражувањето каде што заклучивме дека бројот на проблематичните кредити во последните десет години во Македонија е во пораст, како и дека овој раст е во корелација со растот на вкупните активи на банките, при што заклучуваме дека проблематичните кредити директно влијаат врз профитабилноста на банките.

Генерална констатација дека Нефункционалните – Проблематичните кредити се поврзуваат само со Вкупната Продуктивност на Економијата на Република Северна Македонија за периодот од 2006-2020, значи, повисоката стапка на НФК во Република Северна Македонија се подразбира повисока стапка на Вкупната Продуктивност на Економијата, но да се напомене дека ова поврзаност на НФК е заедно во група со стапката на Инфлација..

5. Користена литература

1. Bank for International Settlements, *Sound Practices for the Management and Supervision of Operational Risk*, Basel, 22 July 2003.
2. Basel Committee on Banking Supervision (1999) *Principles for the Management of Credit Risk*, Konsultative paper issued by the Basel Committee on Banking Supervision, <http://www.bis.org/publ/bcbs54.htm>
3. Basel Committee on banking Supervision, (2000), “*Principles for the Management of Credit Risk*“, Basle, September
4. Basel Committee on Banking Supervision, (2003), *Principales for the Management and Supervisin of Interest Rate Risk*, Basel;
5. Bessis J. (1999) „*Risk Management in Banking*“, John Wiley&Sons, Chichester ,England;
6. Bessis, J., (2001), *Risk Management in Banking*, 2nd ed., Willy & Sons Ltd., Chichester,England;
7. BIS, (2003) *Credit risk transfer*. Basel: Committee on the Global Financial System;
8. Brigham E.F., Grapenski L. C.,(1994) ”*Fundamentals of Financial Management - Theory and Practice*“, The Dryden Press, New York
9. Van Horne J.C.,(1993) ”*Financijsko upravljanje i politika*“, (Financijski menadzment), Deveto izdanje, Zagreb
10. Виолета, М., (2010),,,*Управување со кредитиниот ризик во комерцијалното банкарство* “Центар за банкарство и финансии,Скопје;
11. Виолета, М., (2011) „*Кредитна политика*“, Универзитет „Гоце Делчев” - Штип

12. Greuning, H., Brajoviæ Bratunoviæ, S., (2003), *Analyzing and Managing Banking Risk*, The World Bank, Washington, USA;
13. Давитковски, О. (2011), *"Перформансите на кредитните портфолија на комерцијалните банки во Југоисточна Европа, компаративна анализа со Р.Македонија"*, Докторска дисертација, Економски факултет, Скопје
14. Dedu, V. and Nexhif, R. (2010) *Banking Risk Management in the Light of Basel II*, Teoretical end Aplplied Economics Volume XVII, <http://www.ectap.ro/articole/445.pdf>
15. Jorion P., (2003), *Financial risk manager handbook*, John Wiley & Sons, New Jersey
16. Joetta C.,(2007), „*Credit Risk Management*“, Mercy College,USA;
17. Jakovljevic, D. (2000),„*Upravljanje kreditnim rizikom u suvremenom bankarstvu*” TEB Zagreb
18. Jana S. (2003)*Uloga kreditnih derivata u tekućoj finansijskoj krizi*“ Udruženje banaka Srbije; 9
19. Cade, E. (1999) *Managing banking risks reducing uncertaints to improve bank performance*, GPCo, Chicago, Illinois
20. Crouhy M.,Galai D.,Mark R.,(2006),*The essentials of risk management*,McGraw-Hill,New Yor
21. Comptroller of the Currency, (2008) „*Country Risk Management*“,Comptroller’s Handbook
22. Cirovic, D., (1995), *Bankarski menadzment*, Ekonomski Institut Beograd, Beograd;
23. Christian B., Ludger O., Christoph W., (2002) „*An Introduction to Credit Risk Modeling*“,Chapman and Hall/CRC; 1 edition, United States of America
24. Crotty, J. (2009) *Structural causes of the global financial crisis: A critical assessment of the 'new financial architecture'*. Cambridge Journal of Economics;
25. Ciby J.,(2013) „*Advanced Credit Risk Analysis and Management*“ UK;
26. Kpmg International, (2009) „*Risk management in banking beyond the credit cris*“, 2009, KPMG Internationa, UK;
27. Ken B. , Peter M. (2012) „*Credit Risk Management*“, Edinburgh Business School Heriot-Watt University, United Kingdom;
28. Kurtzman, J.(1993), *The Death of Money*, New York: Simon and Schuster

29. Koch, W.Timothy/Macdonald, (2000) *“Bank Management”* 4th edition, The Drydent Press;
30. Kozarević E., (2009), *Analiza i upravljanje finansijskim rizicima*, CPA, Tuzla
31. Lakić, S. (1996), *Svet finansija*. Novi Sad: Vojvocanska banka.
32. Luhmann, N., (1991), *Sociologie des Risikos*, Berlin, New York
33. Matic, V., (2002), *Upravljanje kreditnom rizikom u svetlu odredbi bazelskog sporazuma*, casopis Jugoslovensko bankarstvo, br.7-8, Beograd;
34. Михаил, П., (2009) *„Финансиски пазари и институции“* Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ Економски Факултет- Скопје;
35. Moody’s Investor Service, (1996), *Corporate Bond Defaults and Default Rates 1970-1995*, Moody’s Special Report;
36. Народна банка на Република Северна Македонија. Одлуката за управување со кредитниот ризик, („Службен весник на РСМ” бр. 17/2008) Достапнона : <http://www.nbrm.gov.mk>
37. Народна банка на Република Северна Македонија. Одлука за супервизорски стандарди за регулирање на достасаните, а ненаплатени побарувања, („Службен весник на РСМ” бр. 134/2007) Достапнона : <http://www.nbrm.gov.mk>
38. Народна банка на Република Северна Македонија. Одлука за сметководствени регулаторен третман на преземените средства врз основа на ненаплатени побарувања, („Службен весник на РСМ” бр. 79/2007) Достапнона : <http://www.nbrm.gov.mk>
39. Народна Банка На Република Северна Македонија, Годишен извештај за 2020 година, Скопје, април 2021 година
40. Неновски, Т. (2005), *Формирање цени на производите и услугите на корпоративните банки*, Скопје : Нампрес.
41. Oldfield, G.S. and Santomero, A. M. (1997) *The place of Risk Management in Financial Institutions*, Newharmon Financial Institutions Center, : <http://ideas.repec.org/p/wep/pennin/95-11.html>
42. Одлука за супервизорски стандарди за регулирање на достасаните, а ненаплатени побарувања на банките, Службен Весник на РМ, бр.134 /2007.
43. Pyle, D. H. (1999) *Bank Risk Management: Theors*, Universits of California, Berkeles Research Program in Finance Working Paper RPF-271

44. Piergiorgio, A. , Mathias D.,(2009) „*An economic capital model integrating credit and interest rate risk in the Banking book*“,European Central Bank;
45. Prudential Financial Policy Department, "Guideline on Classification of Non-Performing Loans and Provision for Substandard, Bad and Doubtful Debts" (BNM/GP3)
46. Петревски, Г. (2011) *Управување со банките* (второ издание), Скопје: Економски факултет, , стр. 91.
47. Rose, P.S.,(2002) *Commercial bank management*, IRWIN, Homewood IL, 60430,Boston, US;
48. Santomero, A.M. (1997) *Commercial Bank Risk Management: an Analysis of the Process*, Newharmon Financial Institutions Center, <http://ideas.repec.org/p/wep/pennin/95-11.html>
49. Saunders A., Cornett M. M., (2006), *Financial institutions management – a risk management approach*, McGraw-Hill/Irwin, New York
50. Sylvain B., Diane Coogan-Pushne (2012) „*The Handbook of Credit Risk Management*“, published simultancouslyin Canada;
51. Standard & Poors. *Credit model*. New York: Standard & Poors.
52. Standard & Poors. February (2000.) *Rating Performans 1999: Stability & transition*. New York: Standard & Poors.
53. Uroš N. Ćurčić, Miljana B.,(2012), „*Upravljanje bankom, korporativnim i portfoliorizicima banke*“,Ĉetvrto izmenjeno i preraceno zdanje, Beograd;
54. Fazlović S., (2006), *Statistika – deskriptivna i inferencijalna analiza*, Denfas, Tuzla
55. Heffernan, S. (1996) „*Modern Banking in theory and practice*“, John Wiley & Sons LTD.
56. Hull J. C., (2007), *Risk management and financial institutions*, Pearson Prentice Hall, New Jersey 96
57. Đukić Đ., (2007), *Upravljanje rizicima i kapitalom u bankama*, Beogradska berza, Beograd
58. Закон за извршување, Службен Весник на РМ , 35/2005, 50/2006, 129/06 и 8/2008
59. Wreston F. J., Besley S., Brigham E. F.,(1996) "*Essentials of managerial finance*", The Dryden Press

PROCEDIMI PENAL DHE GJYKIMI SIPAS LEGJISLACIONIT PENAL TE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PhD. Firdusi AJAZI

Msc. Elton Kanapari

Abstrakt

Në këtë temë do të mundohemi që të trajtojmë të gjitha fazat në të cilat kalon një çështje penale sipas parashikimeve të legjislacionit penal në Republikën e Shqipërisë.

Fillimi i procedimit penal është një veprim procedural gjatë së cilës bëhet regjistrimi i njoftimit të veprës penale dhe i autorit të dyshuar të saj. Gjatë kësaj periudhe duhet që të bëhen vlerësime të shpejta për të bërë të mundur veprime të tjera hetimore, kufizimin e lirisë, dërgimin e personit në gjykatë për të caktuar masën e sigurisë dhe kur vlerësohet se nuk kemi të bëjmë me një vepër penale, mosfillimin e procedimit penal.

Në fazën e fillimit të procedimit penal duhet që nga ana e autoriteteve proceduese të respektohen të gjitha të drejtat e autorit të dyshuar të veprës penale por edhe të viktimës ose viktimave të veprave penale duke i dhënë letrën e të drejtave të tyre. Në këtë fazë është e rëndësishme që personat e arrestuar ose të shoqëruar t'i mundësohet mbrojtje efektive duke i dhënë mundësinë që të

sigurojë një avokat ose në rast të pamundësisë së personave të arrestuar ose të shoqëruar, t'i mundësohet nga ana e autoriteteve një avokat kryesisht i cili do të mund ta mbrojë atë.

Me ndryshimet që janë bërë në vitin 2017 përsa i përket legjislacionit penal në Republikën e Shqipërisë, një trajtim të veçantë marrin edhe rastet kur kemi të bëjmë me autorë të veprave penale persona të mitur ose kur viktimat të veprave penale janë të miturit. Në këtë rast legjislatori ka parashikuar specifikisht sesi duhet që të veprohet dhe masat e dënimit janë gjithmonë më të ulëta se në rastet kur autorë të veprave penale janë persona madhorë.

Megjithëse kemi të bëjmë me ndryshime ligjore të cilat favorizojnë në mbrojtje viktimat e veprave penale ose autorët e veprave penale të cilët janë të mitur sërish këto të drejta në shumë raste nuk respektohen pasi neglizhohen si nga autoritetet ligjzbatuese po ashtu edhe nga vetë viktimat e veprës penale ose mbrojtësit e tyre, duke mos kryer një mbrojtje efektive dhe të jenë pjesëmarrës aktiv në gjykim. Pavarësisht se këtë të drejtë ja ka njohur ligji sërish kemi mangësi në këtë pjesë pasi në të shumtën e rasteve viktimat është thjeshtë pjesëmarrëse në gjykim dhe nuk merr pjesë aktivisht në gjykim duke ja lënë këtë të drejtë përfaqësuesve të organit të akuzës.

DENONCIMI I VEPRËS PENALE.

Të drejtën e procedimit penal e kanë prokurori dhe policia gjyqësore. Që organi i prokurorisë dhe policisë gjyqësore të veprojnë duhet që të marrë indicie me anë të njoftimeve nga ana e viktimave, personave të interesuar, për raste kriminale, kallzime të veprave penale nga ana e nëpunësve shtetërorë, shtetasit, si dhe kryesisht në rastet e parashikuara nga K.Pr. Penale.

Kur kemi të bëjmë me kallzim të veprës penale dhe denoncuesi i veprës penale është një nëpunës i shtetit, kallzimi duhet të përmbajë, përshkrimin e faktit, burimin e provës, dhe kur ka dijeni për autorin e veprës penale, atëherë, duhet që të japë të dhëna të rëndësishme për identitetin, banimin dhe cdo e dhënë tjetër që mund të jetë e rëndësishme për gjetjen e autorit të dyshuar. Kur nëpunësi di edhe personin i cili është dëmtuar nga kjo vepër, atëherë, ai jep edhe të dhënat e të dëmtuarit me qëllim që të kemi një sqarim sa më të plotë të

rrethanave të faktit.¹⁰ Në rastet më të shumta denoncuesi i personit të dyshuar për një veprë penale është viktimë e saj. Në emër të viktimës mund të denoncojë edhe një përfaqësues i tij i pajisur me prokurë, ose në rastet kur ka vdekur, të drejtën për të bërë kallzimin e kanë edhe trashëgimtarët e tij. Ankimi mund të bëhet me gojë ose me shkrim. Kur ankimi bëhet me gojë, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore duhet që të mbajë një procesverbal, i cili në brendësi të tij duhet që të përmbajë: vendin dhe kohën kur bëhet ankimi, identiteti i personit që bën ankimin, bëhet një përshkrim i rrethanave të faktit dhe shfaqet vullneti i personit që bën ankimin që të procedohet penalisht.

K.Pr.P në nenin 58 të saj parashikon të drejtat e viktimës së veprës penale. Sipas përcaktimeve të K.Pr.P viktimë ka të drejtë që :

1. *Të kërkojë ndjekjen penale të autorit të veprës penale.*
2. *Në rastet kur ndaj viktimës ka dhunë fizike apo psikologjike, ti ofrohet ndihmë mjekësore ose këshillim me një psikolog.*
3. *Kur viktimë është shtetase e huaj dhe nuk kupton në gjuhën shqipe, atëherë, duhet që t'i sigurohet një përkthyes.*
4. *Të zgjedhë mbrojtës vetë dhe nëse nuk e ka të mundur nga ana financiare t'i mundësohet një mbrojtës nga ana e institucioneve shtetërore një mbrojtës kryesisht.*

Me anë të mbrojtësit të saj viktimë ka të drejtë që të ndjekë hetimet e organit procedues, në përjashtim të rasteve kur mund të paraqesë rrezik për mbarëvajtjen e hetimeve. Viktimë ka të drejtë që të kërkojë edhe marrjen e provave të tjera që ajo i konsideron të rëndësishme në dhënien e vendimit përfundimtar të gjykatës. Gjithashtu viktimë e veprës penale, ka të drejtë që të marrë pjesë në të gjitha seancat gjyqësore që mund të zhvillohen dhe të paraqesë të gjitha pretendimet e saj në lidhje me çështjen, vetë ose me anë të mbrojtësit të saj.

Në rastet kur kemi të bëjmë me persona të cilët nuk kanë zotësi për të vepruar, të drejtat viktimës garantohen nga përfaqësuesi i saj ligjor. Kur viktimë

¹⁰ Islami Halim, Hoxha Artan, Panda Ilir, Procedura Penale, fq.449-450.Tiranë 2015.

përfaqësohet nga një kujdestar ose një përfaqësues ligjor, rrishtu që përfaqësuesi ose kujdestari i viktimës të veprojë në kundërshtim me interesat e ligjshëm të të përfaqësuarit mund të jetë i lartë. Në momentin që gjykata vëren mospërputhje të interesave të viktimës me veprimet e kujdestarit ose përfaqësuesit, ajo duhet që të veprojë menjëherë dhe të caktojë një përfaqësues të posacëm.

Në rastet e parashikuara nga neni 59/1 i K.Pr.P, viktima akuzuese duhet që të paraqesë kërkesë në gjykatë me të dhënat e tij personale dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën, dhe në rast se e kërkon, të drejtën e shpërblimit të dëmit nga ana e personit të dyshuar.¹¹

MBROJTJA E AVOKATIT PËR TË DYSHUARIN E NDALUAR OSE ARRESTUAR

Fillimi i procedimit penal është një veprim procedural gjatë së cilës bëhet regjistrimi i njoftimit të veprës penale dhe i autorit të dyshuar të saj. Gjatë kësaj periudhe duhet që të bëhen vlerësime të shpejta për të bërë të mundur veprime të tjera hetimore, kufizimin e lirisë, dërgimin e personit në gjykatë për të caktuar masën e sigurisë dhe kur vlerësohet se nuk kemi të bëjmë me një veprë penale, mosfillimin e procedimit penal.¹²

Në rastet kur ndaj personit ka filluar procedimi penal, neni 31 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon të gjitha të drejtat që ka personi i akuzuar. Në bazë të nenit 31 të Kushtetutës personi i dyshuar ka të drejtë:

- a. Të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe ti krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij*
- b. Të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet.*
- c. Të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe*

¹¹ Kodi I Procedurës Penale, Neni 59/1

¹² Gjoleka Agim, Gjoleka Esmeralda, Avokati në procesin penal, Pjesa e Pare Hetimet Praprake, fq 17,18. Botime “Maluka, Tiranë 2006.

- d. *Të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe ti sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme,*
- e. *T'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*¹³

Menjëherë pas arrestimit ose ndalimit të personit të dyshuar, njoftohet prokuroria përkatëse dhe i arrestuari ose i ndaluari nuk mund të detyrohet që të deklarohet në lidhje me akuzën që i bëhet dhe në qoftë se do të flasë, cfarëdo që ai thotë mund të përdoret ndaj tij në gjykim. Pas arrestimit ose ndalimit të dyshuarit i lind e drejta që të zgjedhë një mbrojtës, ose në rast të pamundësisë financiare, mbrojtësi i caktohet kryesisht nga shteti pa asnjë detyrim financiarë. Në rastet kur mbrojtësi është caktuar nga shteti, duhet që të merret dhe miratimi i personit të arrestuar ose të ndaluar. Pas caktimit të mbrojtësit, personi i ndaluar ose i arrestuar ka të drejtë që ta takojë avokatin e tij pa praninë e Policisë Gjyqësore ose të Prokurorit. Gjatë kësaj periudhe mbrojtësi e njeh të akuzuarin me gjendjen ligjore në të cilën ai ndodhet dhe e siguron atë se do ta mbrojë atë pa kushte. Gjatë kësaj kohe personi i akuzuar e njeh avokatin me rrethanat e çështjes në rast se ai e ka pranuar akuzën që i bëhet nga prokuroria, ose në rast se nuk e ka pranuar veprën për të cilën akuzohet i tregon mbrojtësit të tij alibitë në mënyrë që, mbrojtësi të ketë mundësi t'ia parashtrojë këto prokurorit, në mënyrë që të ketë mundësi të kërkojë pushimin e çështjes.

Pasi personit të ndaluar ose të arrestuar i është siguruar mbrojtja, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore fillon marrjen në pyetje në prani të avokatit mbrojtës të zgjedhur nga personi vetë ose të caktuar kryesisht. Gjatë marrjes në pyetje të personit të ndaluar ose të arrestuar prokurori duhet që ti bëjë dhe njëherë me dije akuzat që rëndojnë mbi të, duke i treguar në rast se nuk ndikojnë tek mbarëvajtja e hetimeve edhe të dhënat që kanë dërguar në arrestimin ose ndalimin e tij.¹⁴ Gjatë kohës së marrjes në pyetje të ndaluarit ose të arresuarit, avokati mbrojtës i tij duhet që të jetë i pranishëm pasi me anë të përgatitjes së tij ai nuk lejon që prokurori të shfrytëzojë me pozitën superiore të

¹³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë Neni 31.

¹⁴ Kodi I Procedurës Penale, Neni 256

tij. Gjatë marrjes në pyetje të personit të arrestuar ose të ndaluar nuk lejohen pyetje sugjestionuese të cilat mund të ndikojnë në dhënien e përgjigjes. Në këto raste duhet që të ndërhyjë mbrojtësi dhe të këshillojë të mbrojturin që të mos përgjigjet, dhe t'i kërkojë prokurorit që ti shmanget pyetjeve të tilla.

Kur prokurori nuk urdhëron lirim të menjëhershëm, brenda 48 orëve i arrestuari ose i ndaluari duhet që të dërgohet për caktimin e masës së sigurimit dhe të pranishëm duhet që të jenë si prokurori edhe mbrojtësi i të arrestuarit.

Raste më të komplikuar janë rastet kur të dyshuar janë persona të mitur. Mosha e tij bën që të tregohet shumë kujdes me veprimet procedurale ndaj tij. Mbrojtësi duhet që të jetë i kujdesshëm që organi procedues të respektojë të gjitha të drejtat që parashikohen nga legjislacioni shqiptar.

VLERËSIMI I MASËS SË SIGURISË DHE ROLI I MBROJTËSIT

Neni 258 i K.Pr.P parashikon se, në rastet kur prokurori nuk urdhëron lirim të menjëhershëm duhet që brenda 48 orëve, të kërkojë mbajtjen e një seance për vlerësimin e masës së arrestit. Pas kërkesës së prokurorit gjykata cakton një orar sa më të shpejtë brenda këtyre 48 orëve duke lajmëruar prokurorin dhe mbrojtësin. Gjatë seancës prokurori paraqet shkaqet e arrestimit ose të ndalimit. Për caktimin e masave të sigurisë duhet që të përmbushen disa kushte dhe kritere. Këto kushte dhe kritere përfshijnë:

Së pari, të ekzistojë vepra penale dhe mbi personin të ketë dyshime të arsyeshme se ai mund të jetë autori i veprës penale. Ky dyshim i arsyeshëm vjen si pasojë e mbledhjes së provave, që kanë lidhje me veprën penale në hetim. Këto prova duhet që të kenë lidhje të drejtëpërdrejtë me veprën penale, dhe duhet që provat të jenë marrë në përputhje me dispozitat e K.Pr.P. Në rast se marrja e provave nuk është në përputhje me dispozitat e K.Pr. Penale atëherë ato nuk mund të cmohen nga gjykata dhe si të tilla nuk kanë vlera provuese.

Se dyti, duhet që vepra penale të jetë e dënueshme dhe të mos ekzistojnë shkaqe të padënueshmërisë. Shkaqet e padënueshmërisë janë të parashikuara në nenin 290 të K.Pr.P.

Disa nga këto shkaqe janë: personi i dyshuar ka vdekur, personi nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, është i papërgjegjshëm, vepra penale është shuar, është dhënë amnisti etj...

Për të dhënë masë sigurie me burg duhet që të ekzistojnë disa shkaqe të rëndësishme që mund të vënë në rrezik marrjen e provës, personi i dyshuar mund të largohet nga vendi, ose i dyshuari mund që të kryejë krime të tjera të cilat mund ose jo të kenë lidhje me çështjen në hetim.¹⁵

Pas arsyetimit të prokurorit, i jepet e drejta mbrojtësit dhe të arrestuarit ose ndaluarit që të japin arsyetimin e tyre në lidhje me shkaqet të cilat e kanë detyruar të kryejë veprime të caktuara me karakter penal, ose të kundërshtojë prokurorin në lidhje me deklaratimet e bëra në seancën e vlerësimit të masës së sigurisë. Gjatë kësaj faze mbrojtësi duhet që t'i kushtojë rëndësi zbatimit të kërkesave procedurale apo respektimit të të drejtave të njeriut në rastet e ndalimit apo të arrestimit të personit të dyshuar. Në rastet kur avokati konstaton shkelje të kësaj natyre duhet që t'i parashtrojë këto në seancën e dhënies së masës së sigurimit. Roli i mbrojtësit gjatë marrjes në pyetje të personit të arrestuar është i rëndësishëm pasi e ndihmon atë që të evidentojë para gjykatës rrethana që mund ta revokojnë ose zëvendësojnë masën e sigurimit. Personi ndaj të cilit zhvillohet masa e sigurimit mund të mos përgjigjet kur e shikon të arsyeshme se deklaratat që ai do të japë mund t'ia rëndojë situatën në të cilën ndodhet. Kur arrestimi është bërë në mënyrë të ligjshme atëherë gjykata, bazuar në kërkesën e prokurorit mund të caktojë masë sigurimi, kur gjykimi i personit në liri ka rrezikshmëri shoqërore ose mund që të ndikojë në prishjen e provave. Gjykata mund të vendosë një muaj paraburgim, dhe gjatë kësaj periudhe prokurori i çështjes duhet që të mbledhë të gjitha provat që i cmon të vlefshme për për gjykimin e drejtë të çështjes në hetim.

¹⁵ Gjoleka Agim, Gjoleka Esmeralda, Avokati në Procesin Penal, Pjesa e Parë, Hetimet Paraprake, fq 46,47,48, Botime "Maluka", Tiranë 2006.

Gjykata mund që të urdhërojë dhe lirim të menjëhershëm të personit në rast se, ajo vlerëson që personi i arrestuar ose ndaluar është ngatërruar me një tjetër person, kur ndalim ose arrestimi është bërë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, ose kur masa e arrestit ose e ndalimit e ka humbur fuqinë e saj pas shkeljes së afateve të përcaktuara me ligj.

Gjykata gjatë seancës për caktimin e masës së sigurisë, kur kemi të bëjmë me subjekte të mitur, duhet që të marrë në konsideratë dhe gjendjen në të cilën ato ndodhen. Për vepra penale të cilat nuk konsiderohen si të rrezikshme gjykata duhet që të marrë parasysh interesin më të lartë të të miturit. Kur është e mundur gjykata, nuk duhet që të japë masë sigurie, arrest me burg, apo arrest shtëpie, kur i mituri vazhdon procesin edukativ sic mund të jetë shkolla apo kurse të tjera profesionale ose jo.¹⁶ Për vepra penale të cilat nuk kanë rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe konsiderohen si kundravajtje penaledhe Kodi Penal për të Miturit në nenin 230/4 parashikon se I mituri nuk mund që të arrestohet, edhe kur është arrestuar duhet që të bëhet lrimi i menjëhershëm i tij.¹⁷

Kur të miturit i caktohet masa arrest me burg, duke patur parasysh dhe gjendjen e paraburgimeve tona, mbrojtësi duhet që të sigurohet se të miturit po i plotësohet gjithë të drejtat e tij. Në rastet kur të miturit mund të mos i bëhet një trajtim i specializuar dhe në përputhje me moshën e tij, kjo gjë mund të lërë pasojë në zhvillimin e mëvonshëm të tij fizik ose mendor.

Vendimin e gjykatës mund që ta kundërshtojë mbrojtja, ose prokurori brenda një periudhe kohore prej 5 ditësh nga dhënia e masës së sigurisë. Ankimi i bërë nga palët duhet që të shqyrtohet brenda 10 ditëve. Gjithashtu edhe kundër vendimit të gjykatës së apelit mund që të ushtrohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

Viktima gjatë fazës së vlerësimit të masës së sigurisë nuk ka një rol aktiv. Gjatë kësaj faze viktimë mund vetëm që të marrë pjesë si palë e interesuar

¹⁶ Kodi I Procedurës Penale, Neni 229/3

¹⁷ Kodi I Procedurës Penale, Neni 230/4

në zgjidhjen e çështjes. Ajo nuk mund që të kundërshtojë vendimin e dhënë nga gjykata tek një gjykatë e një shkalle më të lartë.

PËRFUNDIMI I HETIMEVE DHE DËRGIMI I ÇËSHTJES PËR GJYKIM.

Pas përfundimit të hetimeve dhe në bazë të provave të mbledhura, në mbështetje të nenit 327 pika 6, prokurori mund që të procedojë si më poshtë:

- a. *Vendos pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, ose i kërkon gjykatës pushimin e akuzës, apo çështjes, në rastet e parashikuara nga neni 329/a i K.Pr. Penale*
- b. *I kërkon gjykatës dërgimin e çështjes në gjyq, kur nuk procedon sipas neneve 400,406/a dhe 406/dh të K.Pr. Penale*

Në rastet kur prokurori vendos që ta dërgojë çështjen për gjykim në bazë të nenit 331, prokurori së bashku me kërkesën i bashkangjit edhe gjeneralitetet e të pandehurit dhe të viktimës, parashtrimin e faktit penal dhe cilësimin juridik të veprës penale, burimet e provës dhe faktet që ato u referohen, kërkimin që gjyqtari i seancës paraprahe të vendosë dërgimin e çështjes në gjyq, datën dhe nënshkrimin e prokurorit.

Kërkesës i bashkangjitet gjithashtu edhe aktet dhe provat që përmban fashikulli i hetimeve, duke përfshirë edhe aktet e kryera përpara gjykatës të hetimeve paraprahe, si dhe provat materiale, përvec rasteve kur ato ruhen në vend tjetër. Mbrojtësi ka të drejtë që të njihet me të gjitha aktet dhe të shprehet për to, duke parashtruar kundërshtimet që ai ka, apo edhe kërkesën e mundshme për shpalljen të pavlefshme të provave. Gjatë kësaj kohe mbrojtësi ka të drejtë që të paraqesi kërkesë edhe për marrjen e disa provave të reja që ai mendon se mund të ndikojnë në vendimin përfundimtar të gjykatës. Kur mbrojtësi mendon se ndodhet përpara kushteve të parashikuara nga neni 328 i K. Pr. Penale ka të drejtë që të kërkojë pushimin e çështjes. Këto qëndrime të mbrojtësit duhet që të

shprehen me shkrim dhe duhet që të jenë pjesë e procesverbalit për njohjen e akteve. Të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të reja e ka edhe mbrojtësi i viktimës, kur ai cmon se me marrjen e këtyre provave, viktimës i garantohen më mirë të drejtat dhe çështja në përfundim do të ketë një vendim të drejtë. Kur çështja është në kompetencë të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij i njoftohen dhe i vihen në dispozicion vetëm aktet procedurale që kanë lidhje me akuzën, të vecuara nga aktet e tjera. Njoftimi dhe vënia në dispozicion vetëm e akteve procedurale dhe jo e provave bëhet për shkak se, veprat të cilat gjykohen nga kjo gjykatë janë të një rrezikshmërie të lartë shoqërore dhe autorët e saj paraqesin rrezik në prishjen e këtyre provave.

Veprimet hetimore gjatë periudhës që kanë mbaruar afatet hetimore konsiderohen të paligjshme dhe nuk mund të përdoren në gjykatë. Pas përfundimit të hetimeve prokurori me ndryshimet e K. Pr. Penale nuk e ka më ekskluzivitetin e marrjes së vendimit në lidhje me kalimin e çështjes për gjykim ose pushimin e saj. Prokurori i drejtohet me kërkesë gjykatës me objekt kalimin e çështjes për shqyrtim gjyqësor. Heqja e ekskluzivitetit të prokurorit për marrjen e vendimit të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore ose jo, është bërë me qëllim uljen e ndërhyrjeve nga faktorë të jashtëm në marrjen e vendimit.

GJYQTARI I SEANCËS PARAPRAKE

Me ndryshimet që u bënë në sistemin e drejtësisë dhe që kanë hyrë në fuqi në shtator të 2017, një nga risitë që sollën këto ndryshime është edhe gjyqtari i hetimeve paraprake. Para ndryshimeve të ndodhura në K. Pr. Penale për faktin nëse çështja duhej të dërgohej në gjykatë ose jo vendoste vetë prokurori i çështjes. Me ndryshimet e ndodhura të hyra në fuqi në shtator të 2017, tani më kjo e drejtë i është hequr prokurorit dhe është caktuar një “shkallë e re gjyqësore”, gjyqtari i seancës paraprake. Kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake janë të përcaktuara në nenin 278 të K. Pr. Penale.

Në zbatim të këtij neni të gjitha dosjet hetimore të prokurorëve do të kalojnë për shqyrtim tek gjyqtari i seancës paraprake, që kanë autoritet të plotë të vlerësojnë nëse një dosje hetimore duhet apo dërguar apo jo në gjykatë dhe personi i pandehur duhet apo jo të merret si i tillë Kompetencat e gjyqtarëve të

seancës paraprahe mundësojnë edhe një ulje të shkallës së korrupsionit në fushën e drejtësisë, pasi tani nuk vendos më vetëm një person por kemi të bëjmë me një gjyq të mirëfilltë të çështjes në lidhje me provat apo me cdo lloj kërkesë tjetër të prokurorit apo palëve të tjera në çështje. Hetimet paraprahe vlerësohen vetëm nga një gjyqtar i cili më pas nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në trupën gjyqësore e cila do të gjykojë çështjen. Të drejtën për të marrë pjesë në seancën e hetimeve paraprahe e kanë prokurori, personi i dyshuar si dhe viktimat.

Viktima e veprës penale ka të drejtë që të kundërshtojë kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit penal. Kundërshtimet e saj viktimat i parashtron gjatë seancës se caktuar për kalimin ose jo të çështjes për shqyrtim gjyqësor. Mbrojtësi i viktimës parashtron të gjitha provat të cilat faktojnë ngjarjen dhe kërkon kalimin e çështjes për shqyrtim gjyqësor. Gjyqtari pas vlerësimit që i bën kërkesës së prokurorit dhe provave të paraqitura nga ai mund të vendosë;

Kalimin e çështjes për shqyrtim gjyqësor, ose Pushimin e çështjes. Në rast se gjyqtari vendos për pushimin e çështjes, atëherë palët kanë të drejtë që ta ankimojnë atë në Gjykatën e Apelit. Ankimi kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprahe bëhet brenda dhjetë ditëve nga marrja dijeni për vendimin e gjykatës. Gjykata e Apelit pas marrjes në dorëzim të provave duhet që të vendosë brenda 30 ditëve nga regjistrimi i çështjes.¹⁸ Pas shqyrtimit të çështjes nga ana e Gjykatës së Apelit dhe në rast se ajo ka vendosur që çështja të kalohet për shqyrtim gjyqësor, atëherë, provat dhe të gjitha aktet e administruara në seancë kalohen tek gjykata kompetente.¹⁹

GJYKIMI I ÇËSHTJES PENALE NË THEMEL.

Faza më e rëndësishme e një procesi penal është gjykimi i çështjes dhe dhënia e një vendimi përfundimtar. Për të patur një gjykim sa më të drejtë dhe real, gjykata duhet që të jetë e paanshme, a pavarur, mbi palët dhe duhet që vendimin përfundimtar në lidhje me çështjen objekt gjykimi ta bazojë në prova

¹⁸ Kodi I Procedurës Penale. Neni 291.

¹⁹ Kodi I Procedurës Penale, neni 332/gj pika 1.

dhe fakte duke cmuar vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre në procesin gjyqësor, duke argumentuar në këtë mënyrë dhe arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj.²⁰

Në këto kushte për t'i vendosur palët në pozita të barabarta, gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka njohur të drejtën që të përfaqësohen në gjyq me avokatë të zgjedhur prej tyre ose në rastet e pamundësisë financiare të caktuar kryesisht nga shteti me pëlqimin e të pandehurit ose të viktimës së veprës penale. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, mbrojtësi ka të drejtë që të ndërhyjë kur gjykon se çështja është duke u trajtuar subjektivisht dhe të drejtat e palës që ai mbron nuk po respektohen. Rëndësinë më të madhe në gjykim mbrojtësi e merr në gjykim kur personi që ai mbron nuk paraqitet në seancën gjyqësore. Mbrojtësi ka të drejtë që të njihet me cdo dokument ose provë që dërgon në zgjidhjen e çështjes. Ai ka të drejtë jo vetëm që të njihet me dokumenta apo prova që dërgojnë në zgjidhjen e çështjes, por t'i vendosen në dispozicion edhe kopje të dokumentave apo provave për aq sa është e mundur që të realizohet. Përpara fillimit të seancës gjyqësore, relatori i çështjes duhet që të kontrollojë prezencën e palëve. Kur mbrojtësi është i caktuar kryesisht dhe nuk paraqitet, gjyqtari i seances cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër. Në rastet kur kemi njoftime të parregullta nga ana e gjykatës dhe që këto njoftime të parregullta nuk kanë ardhur si shkak i dhënies së gabuar të adresave nga ana e mbrojtësit apo palëve në gjykim atëherë gjykata është e detyruar që të vendosë shtyrjen e seancës gjyqësore dhe rinjoftimin edhe njëherë të palës që nuk është njoftuar. Një rast tjetër i shtyerjes së seancës gjyqësore, është edhe kur njëra nga palët mungon edhe nëse është njoftuar në mënyrë të rregullt për datën e seancës, por nuk ka mundur që të paraqitet për shkak të forcave madhore ose një pengese tjetër që e përjashton nga përgjegjësia. Në rastet e mungesës së mbrojtësit të të dëmtuarit të veprës penale, gjykimi mund që të vazhdojë edhe pa praninë e tij, pasi është ai personi i cili duhet që të ishte i interesuar për mbarëvajtjen e seancave gjyqësore.

Aftësia e mbrojtësit të dëmtuari të veprës penale vërehet edhe gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të ngjarjes. Dëshmitarët fillimisht pyeten nga prokurori, më pas nga mbrojtësi i të pandehurit dhe më pas nga mbrojtësi ose

²⁰ Kodi Pr. Penale, Neni 152, Cmuarja e provave

përfaqësuesi i të dëmtuarit. Mbrojtësi në këtë fazë të shqyrtimit gjyqësor duhet që të jetë i kujdesshëm dhe t'i jepet e drejta të shprehet në rast se gjykon që, pyetjet e drejtura nga palët e tjera në procesin gjyqësor janë sugjestionuese dhe e drejtojnë dëshmitarin në një përgjigje të caktuar. Kur mbrojtësit të dëmtuarit i jepet e drejta për pyetje, duhet të drejtojë pyetje që janë në favor të palës së dëmtuar dhe që ndikojnë në mënyrën e trajtimit të çështjes në vijim. Pas dhënies së dëshmisë nga dëshmitari, mbrojtësi mund që të paraqesë kundërshtimin e dëshmisë, duke u bazuar në përcaktimet e nenit 362 të K.Pr .Penale.²¹Kur kemi të bëjmë me dëshmitar të mitur atëherë është relatori i çështjes ai që pyet të miturin dëshmitar. Relatori gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit të mitur asistohet nga një familjar dhe nga psikologu. Pyetjet e relatorit, drejtuar të miturit janë të hartuara në përputhje me kërkesat dhe kundërshtimet e palëve në proces.

Për çështje të cilat kanë nevojë për ekspertim, caktohet eksperti nga ana e gjykatës me marrëveshje midis palëve ose me pëlqimin e palëve në proces. Gjykata vendos një datë për dorëzimin e ekspertimit dhe për pyetjen e ekspertit në një seancë gjyqësore. Pyetja e ekspertit ose e ekspertëve bëhet duke u bazuar në përcaktimet e parashikuara nga K.Pr.Penale për marrjen në pyetje të dëshmitarëve. Mbrojtësi pasi merr të drejtën për të drejtuar pyetje, mundohet që t'i drejtojë ato në mënyrë të atillë që mendimi i ekspertit të jetë në favor të të dëmtuarit. Nëse gjatë përgjigjeve të ekspertit lindin dyshime të arsyeshme se eksperti ka dhënë mendim subjektiv, mbrojtësit i lind e drejta që të kërkojë zëvendësimin e ekspertit dhe riekspertim të provave.²²

Pasi janë verifikuar të gjitha provat për ligjshmërinë e tyre dhe janë marrë deklaratimet e të pandehurit, të dëmtuarit të veprës penale si dhe deklaratimet e dëshmitarëve, ekspertëve, kryetari i seancës gjyqësore i jep fund shqyrtimit gjyqësor dhe cakton një seancë për diskutimet përfundimtare. Parashtrimi i

²¹ Kodi I Procedurës Penale, Neni 362- Kundërshtimi I Padisë.

²²Gjoleka Agim, Gjoleka Esmeralda, Avokati në Procesin Penal, Pjesa e Dytë, Gjykimi dhe mendimet e gjykatës, fq 61-63,Botimet “Maluka”, Tiranë 2007.

konkluzioneve nga ana e palëve në gjyq bëhet sipas përcaktimeve të nenit 378 të K. Pr.P.²³

Në këtë fazë të gjykimit, mbrojtësi duhet të evidentojë para gjykatës provat në favor të të dëmtuarit, dhe të argumentojë zhvleftësimin e provave të paraqitura nga pala e akuzuar. Konkluzionet e mbrojtësit në diskutimin përfundimtar duhet që të jenë të shkruara në mënyrë që t'i bashkangjiten dosjes gjyqësore. Në të duhet që të jenë parashtruar të gjitha konkluzionet e tij në lidhje me rrethanat e ngjarjes, provat si edhe të gjitha kundërshtimet që mund të ketë në lidhje me kërkesat e palëve të tjera në procesin gjyqësor. Pas përfundimit të diskutimeve përfundimtare trupa gjyqësore mbyll shqyrtimin gjyqësor dhe tërhiqet për marrjen e vendimit.

Pas tërheqjes së trupës gjyqësore në dhomën e këshillimit merret një vendim unanim ose me shumicë nga ana e trupës dhe më pas rikthehen sërish në sallë për të komunikuar vendimin e marrë. Menjëherë pas marrjes së vendimit palëve në proces i lind e drejta që të apelojnë çështjen në gjykatën përkatëse të apelit.

Pala e cila bën kundërshtimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duhet që të plotësojë disa kushte sipas përcaktimeve të K.Pr.Penale. Duke u mbështetur në nenin 409 të Kodit të Procedurës Penale, të dëmtuarit të veprës penale i lind e drejta që të bëjë ankim si për efektet penale të vendimit ashtu edhe për ato civile. Të drejtën e tij i dëmtuari mund që ta ushtrojë personalisht ose nga mbrojtësi i tij ligjor.²⁴ Ankimim mund që të bëhet për të gjithë vendimin ose vetëm për një pjesë të tij. Fillimisht bëhet një pasqyrim i përmbledhur i fakteve dhe rrethanave që janë paraqitur dhe marrë në shqyrtim nga gjykata e rrethit gjyqësor. Pasi i kemi bërë një përshkrim të përmbledhur fakteve dhe rrethanave të marra në shqyrtim nga gjykata e rrethit gjyqësor, citohen arsyet e apelit të çështjes duke e arsyetur se ku mund të ketë gabuar gjykata në dhënien e vendimit përfundimtar. Avokati i të dëmtuarit ka të drejtë gjithashtu që të paraqesë apel kundërshtues në rast se ajo nuk ka bërë ankim por

²³ Kodi I Procedurës Penale, Neni 378, Zhvillimi I diskutimit.

²⁴ . Gjoleka Agim, Gjoleka Esmeralda Avokati në Procesin Penal, Pjesa e Dytë, Gjykimi dhe vendimet e gjykatës, fq.97. Botimet “Maluka” Tiranë 2007.

kjo e drejtë është shfrytëzuar nga palët e tjera në gjykim. Apeli kundërshtues duhet që të përmbajë vetëm kundërshtime në lidhje me pretendimet palëve të tjera. Pas paraqitjes së ankimit kalohet në seancë gjyqësore. Duhet të kemi parasysh se gjykata e apelit e shqyrton çështjen për pjesën për të cilën është bërë kundërshtim por mund edhe që ta shqyrtojë çështjen në tërësi dhe nuk kufizohet vetëm me shkaqet e paraqitura në ankim. Shqyrtimi gjyqësor fillon me parashtrimet e çështjes nga relatori. Pas parashtrimeve të çështjes nga ana e relatorit i jepet e drejta palës që ka bërë ankim, e cila bën arsyetimin e saj në lidhje me shkaqet e ankimit apo me pretendimet që ka në lidhje me marrjen ose jo të provave nga gjykata e shkallës së parë. Në rast se edhe palët e tjera kanë bërë apelim i jepet e drejta e fjalës për të arsyetuar edhe ajo shkaqet e apelit të çështjes. Në përfundim të gjykimit trupa gjyqësore e çështjes tërhiqet për marrjen e një vendimi.²⁵ Në vendimin e saj Gjykata e Apelit mund që të vendosë: *lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, ndryshimin e pjesës së vendimit të gjykatës, ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, ose prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë*. Me dhënien e vendimit nga ana e Gjykatës së Apelit, palët në proces njoftohen se kanë të drejtë që të bëjnë rekurs në Gjykatën e Lartë. Për palën e cila mendon se vendimi i apelit ishte i padrejtë dhe si i tillë kishte shkaqe të arsyeshme për të bërë rekurs, i lind e drejta që brenda afateve kohore të bëjë rekurs në gjykatën e lartë. Rekursi nga palët të cilat do të ushtrojnë këtë të drejtë duhet që të paraqitet brenda dyzet e pesë ditëve ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit nga ana gjykatës së apelit. Paraqitja e kërkesës për rekurs paraqitet te gjykata e cila ka fashikullin e e çështjes për ta bërë sa më të lehtë ushtrimin e të drejtës së rekursit.

Rekursi në brendësi të tij duhet që të përmbajë shkaqet e argumentuara nga ana e mbrojtësit të palës se përse vendimi i marrë nga gjykata e apelit është në mospërputhje me dispozitat procedurale. Palët të cilat ushtrojnë të drejtën e rekursit duhet që të jenë të përfaqësuar nga një mbrojtës i licensuar, në të kundërt rekursi është i pavlefshëm. Detyrimi që rekursi të pregatitet nga një

²⁵ Islami Halim, Hoxha Artan, Panda Ilir, Procedura Penale, fq 577-578, Botimet “Morava”, Tiranë 2012.

Gjoleka Agim, Gjoleka Esmeralda, Avokati në Procesin Penal, Pjesa e Dytë, Gjykimi dhe vendimet e gjykatës.

mbrojtës ligjor, lind për arsye që e drejta e rekursit të mos humbasë për shkak të kërkesave procedurale penale, garanci kjo e cila mund të sigurohet me anë të një përfaqësuesi apo mbrojtësi ligjor.²⁶

Rekursi mund që të ushtrohet vetëm për shkaqet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr Penale. Neni 432 i Kodit parshikon se: Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe:

- a. Për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;
- b. Për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave;
- c. Kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Pasi rekursi është dërguar në sekretarinë e Gjykatës së Lartë, është Dhoma e Këshillimit ajo e cila merr vendimin nëse rekursi i paraqitur do të kalohet për shqyrtim gjyqësor. Dhoma e Këshillimit e merr vendimin e saj duke u bazuar në nenin 432 të K. Pr. Penale. Nëse rekursi nuk është mbështetur në këto përcaktime atëherë, vendoset mospranimi i tij për shqyrtim. Në rast se Dhoma e Këshillimit merr vendim për pranimin e rekursit, caktohet kolegji penal i cili përbëhet nga pesë gjyqtarë ku kryetari i kolegjit cakton datën për shqyrtimin e rekursit, dhe sekretaria bën njoftimin për palët në proces.²⁷ Gjatë shqyrtimit gjyqësor, kolegji penal nuk ndalon në shqyrtimin e çështjes nga pikëpamja e faktit por vetëm në vlerësimin për mënyrën sesi është arritur zbatimi i ligjit material dhe procedural nga gjykatat më të ulëta.²⁸ Fillimisht të drejtën për të diskutuar e ka pala e cila ka paraqitur kërkesën për rekurs, më pas

²⁶ Islami Halim, Hoxha Artan, Panda Ilir, Procedura Penale, fq 598, 599, 600, 601, Botimet “Morava”, Tiranë 2012.

²⁷ Islami Halim, Hoxha Artan, Panda Ilir, Procedura Penale, fq 601, Botimet “Morava”, Tiranë 2012.

Gjoleka Agim, Gjoleka Esmeralda, Avokati në Procesin Penal, Pjesa e dytë, Gjykimi dhe vendimet e gjykatës.

²⁸ Islami Halim, Hoxha Artan, Panda Ilir, Procedura Penale, fq 603, Botimet “Morava”, Tiranë 2012.

kalohet tek palët e tjera në proces. Nëse rekursin e ka bërë i pandehuri, ose i dëmtuari i veprës penale të drejtën për të folur e kanë mbrojtësit e tyre për të bërë parashtrimet në emër të tyre. Mbrojtësi i palës së dëmtuar duhet që të shprehet në lidhje me mangësitë e vërejtura në gjykimet e shkallëve më të ulëta në mënyrë që ketë sa më shumë mundësi për të rikthyer çështjen për gjykim. Pasi shfrytëzojnë të drejtën e tyre për tu shprehur, palët në proces nuk kanë të drejtë replike.²⁹

Pasi mbarojnë diskutimet përfundimtare, kolegji penal mund të marrë vendim brenda seancës së fundit por nëse çështja është e komplikuar, atëherë, kryetari i kolegjit mund të shtyjë marrjen e vendimit për aq kohë sa është e nevojshme por jo më gjatë sesa përcaktimet kohore të ligjit.

Në vendimin e saj Kolegji Penal mbështetet në nenin 441 të K.Pr.Penale, ku përcaktohet se Kolegji Penal ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mund të vendosë: *lënien në fuqi të vendimit, prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rishqyrtim, prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes pa e kthyer për shqyrtim.*³⁰

Me marrjen e vendimit nga kolegji penal i gjykatës së lartë, çështja konsiderohet e zgjidhur përfundimisht.

Një mjet i jashtëzakonshëm i goditjes së vendimeve penale të formës së prerrë është dhe kërkesa për rishikimin e vendimeve. Rishikimi i vendimeve parashikohen në nenin 449 të K.Pr.P. Rishikimi mund të bëhet në cdo kohë dhe duhet që të përmbushë kushtet e parashikuara nga neni 450 i K.Pr. P. Të drejtën për të bërë kërkesë për rishikimin e vendimeve e kanë i dënuari, përfaqësuesi i tij ose trashëgimtari dhe një i afërm i tij në rastet kur personi ka vdekur ose prokurori i çështjes kur ka zbuluar fakte të reja që mund të ndryshojnë pozitën e personit të denuar³¹. Bashkengjitur kërkeses për rishikimin e vendimit të

²⁹ Islami Halim, Hoxha Artan, Panda Ilir, Procedura Penale, fq 609, Botimet “Morava”, Tiranë 2012

³⁰ Kodi I Procedurës Penale, Neni 441, Vendimet e Gjykatës së Lartë.

³¹ Kodi I Procedurës Penale, Neni 451 , Kërkesa e rishikimit.

grykates vendosen edhe provat te cilat mund qe te ndikojne ne ndryshimin e vendimit te grykates. Nese kërkesa bëhet me qëllim rëndimin e pozitës së dënuarit, nuk lejohet që të rishikohet vendimi.³²

Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi I Procedurës Penale, i Republikës së Shqipërisë
- Procedura Penale Islami Halim, Hoxha Artan, Panda Ilir
- Avokati në procesin penal, Gjoleka Agim, Gjoleka Esmeralda

³² Kodi I Procedurës Penale, Neni 449, vendimet që rishikohen.

NDËRKOMBËTARIZIMI I TERRORIZMIT

Phd. EDLIR AJAZI

Msc. Av. ELTON KANAPARI

Abstrakt

Mund të themi se terrorizmi modern ka filluar më 1968, kur Fronti Popullor për Çlirimin e Palestinës, rrëmbeu një avion dhe i ndryshoi drejtimin për në Romë. Megjithëse avionë ishin rrëmbyer edhe më parë, ishte hera e parë që nacionaliteti i të rrëmbyerve (Izraelit), dhe vlera simbolike që ata përfaqsonin ishte qëllimi i objektivit. Gjithashtu ishte hera e parë që përdorimi i pasagjerëve si pengje bëhej për të fituar publicitet dhe njekohësisht përdorej si një armë kundër Qeverisë Izraelite. Kombinimi i të gjithë këtyre faktorëve çoi në ndërkombëtarizimin e kësaj çështje e cila fitoi një vëmendje të madhe në media. Themeluesi i FPCP, Dr. George Habash tha se niveli i mbulimit nga mediat i kësaj ngjarje ishte shumë herë më i madh se të gjitha betejat e bëra deri më sot me ushtarët Izraelit.

“Të paktën bota është duke folur për ne tani”³³

Është e ditur se strategjia e përbashkët e të gjithë terroristëve është të kryejnë akte dhune të cilat do të tërheqin vëmendjen e publikut, qeverive dhe botës ndaj aspiratave të tyre.

Publiciteti për hir të kauzës është ndoshta çështja kyçe dhe natyrisht media luan një rol të rëndësishëm në strategjinë e tyre. Shumica e njerëzve e shohin aktin e

³³ Gjate një koference per shtyp te Dr. George Habash

dhunshëm të terroristit si iracional dhe të paarsyeshëm. Nëse shqyrtohet nga afër cilido akt terrorist, do të shikoni se kjo nuk është zakonisht e vërtetë. Vetë akti nuk është i rëndësishëm, por rezultati dhe reagimi ndaj dhunës, terroristit pothuajse i garantohet publiciteti për kauzen e tij. Kjo është gati absolute në një demokraci dhe ndoshta më pak e vërtetë në një formë totalitare të qeverisjes. Në shumë vende të botës, terroristi duhet të bëhet me i dhunshëm dhe më spektakolar që të fitojë hapësirë në lajmet kryesore, gjë që fitohet me lehtësi në të kaluarën, por edhe në ditët tona. Megjithatë, duhet thënë se tani shtypi ndërkombëtar nuk raporton për shumë akte që ndodhin në çdo shtet të botës. Terroristi e kupton plotësisht situatën dhe mënyrën për të zënë hapësirën e dëshiruar. Një shembull i ekstremit të dhunës për të fituar lajmin kryesor demonstron më së miri duke kryer akte. Duhet të kuptohet qartë se viktima e një sulmi terrorist shpesh nuk është shënjestra e vërtetë. Shënjestra janë zakonisht spektatorët, shteti, bota. Sulmi mund t'i drejtohet një sektori të veçantë të shoqërisë. Duke kërcënuar dhe duke zbatuar akte të dhunës ekstreme kundër një viktime, terroristi përpiqet të krijojë frikë te viktima, por ç'është më e rëndësishmja tek ata që shikojnë. Të dy varen nga qeveria për mbrojtje, nga ajo që duket e pakuptimtë dhe nga aktet terroriste, të cilat duken të rastësishme. Kur qeveria nuk ofron këtë siguri, ajo mund të duket e paaftë. Terroristi do ta përdorë propagandën e organizatës së vet dhe do të përpiqet të shfrytëzojë këtë dobësi deri në fund. Terroristi mund t'ua tërheqë vërejtjen autoriteteve para një shpërthimi ose një krimi tjetër, nëse autoritetet dështojnë të veprojnë dhe të parandalojnë terrorin, atëherë propaganda e terroristëve për paaftësinë e qeverisë fiton terren. Nëse sulmet terroriste ndodhin për një periudhë të gjatë kohore, gjithnjë ekziston rreziku që qeveria ose publiku të lodhen. Pavarësisht nga nevojat strategjike ose humane për intervenim, sulmi mund të ndikojë në ndryshimin e axhendës botërore ndërsa në kursin e marrëdhënieve ndërkombëtare një individ mund të luajë rol qënësor.

SHTETET PËRBALLË TERRORIZMIT NDËRKOMBËTAR

Historikisht, terrorizmi është parë si një fenomen taktik, i cili luhet sipas gjeografisë dhe kulturës, si formë e luftës asimetrike bashkëkohore, por edhe si strategji.

Megjithëse ai sot paraqet një nga sfidat më të vështira për paqen dhe sigurinë globale, perceptimet rreth këtij fenomeni variojnë në varësi të rajoneve apo vendeve të ndryshme, duke bërë që akoma të mos kemi një përkufizim të unifikuar

ndërkombëtarisht e të pranuar nga të gjithë, se “*çfarë kuptojmë me terrorizëm*”. Kjo veprimtari e dhunshme ndonjëherë është perceptuar si vegël, ose mjet për revolucionarët dhe nacionalistët për të arritur objektiva të caktuara, por jo rallë kanë qenë të sponsorizuar apo edhe të ushtruar nga qeveri të ndryshme për ruajtjen e autoritetit të tyre shtetëror.

Nga ana tjetër, disa prej tyre që kanë aplikuar pjesëmarrjen në veprimtari terroriste, pretendojnë se janë duke luftuar në emër të lirisë, kur nga ana tjetër, duket qartë një motivacion kuptimplotë krejt i ndryshëm, i bazuar në motive politiko - ideologjike, nacional-etnike dhe fetare.

- Kështu, duke kërkuar origjinën e formave të shfaqjes së terrorizmit gjatë viteve të historisë moderne, mund të bëjmë një klasifikim teorik të ndarë në tre grupe:

1. *Terrorizmi me origjinë konfliktin nacional-etnik.*

Kjo formë është evidentuar më dukshëm në Irlandën e Veriut dhe Spanjë, nëpërmjet formacioneve të IRA-s dhe ETA-s.

2. *Terrorizmi me origjinë konfliktin politiko-ideologjik.*

Kjo formë është identifikuar kryesisht me lëvizjet anarkisto-komuniste të viteve 60-80 e më vonë. Subjekte të kësaj forme të terrorizmit kanë qenë organizata të tilla si "RAF" në ish-RFGJ, "Brigada Rossa" në Itali, "17 Nëntori" në Greqi, etj.

3. *Terrorizmi me origjinë konfliktin fetar.*

Është i identifikuar kryesisht në mesin e viteve 70 me lëvizjet integraliste në Lindjen e Mesme veçanërisht pas ardhjes në fuqi të disa qeverive sponsorizuese të këtij lloji terrorizmi.

- ✓ *Kemi edhe një klasifikim tjetër të terrorizmit:*

1. *Terrorizëm me bazë të brendshme.*

Ai mund të jetë i origjinave të ndryshme, por është i nxitur, i mbështetur dhe i organizuar nga elementë të brëndshëm.

2. *Terrorizëm me bazë nga jashtë.*

Ai mund të jetë i origjinave të ndryshme, mund të kryhet nga elementë të brëndshëm, por me mbështetje e drejtim nga jashtë vendit. Në mars të vitit 1995, gjashtë vjet përpara ngjarjeve tronditëse të 11 shtatorit 2001, ndodhi sulmi terrorist mbi metronë e Tokios. Kulti fetar japonez i Aum Shiirikyo vrau 12 njerëz dhe helmoi mbi 5000 të tjerë. Shtetet tani kishin përballë një epokë të re, të një terrorizmi të ri, quajtur ndryshe **“Superterrorizëm”**.

Ndonëse i ashtuquajtur “terrorizëm i vjetër” shfaqej në dukje “i dobësuar”, një numër domethënës i karakteristikave të tij dukeshin se po e meminin veten shpejt, duke gjetur shprehje në terrorizmin e ri dhe në vetë aktorët e këtyre ngjarjeve, terroristët. Kjo u qartësua më 11 shtator 2001, kur shteti më i fuqishëm dhe i sigurtë i botës, SHBA-ja u përball me “superterrorizmin”, shenjat e të cilit ishin dukur që gjatë vitit 1990.

“INFRASTRUKTURA” e terrorizmit ndërkombëtar.

Përballë shteteve dhe organizatave ndërkombëtare, sot në botë mendohet se ekzistojnë rreth 360 organizata terroriste, ose afërsisht sa dyfishi i shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara.

Shumica e këtyre organizatave ekzistojnë dhe veprojnë në Lindjen e Mesme, ose kanë qendrat e drejtimit e të financimit prej atje.

Në këtë mënyrë, mund të thuhet se Lindja e Mesme prodhoi terrorizmin ndërkombëtar si një prej sfidave më të mëdha të sigurisë globale për shekullin tonë.

Por, nisur nga shtrirja dhe veprimtaria e tyre, organizatat terroriste mund t'i klasifikojmë me shtrirje dhe gjeografi:

a: globale ndërkombëtare (AI Kaeda)

b: rajonale (Xhiahadi Islamik)

c: lokale (Hamasi)

Jo vetëm kaq, por këto organizata, (Al Kaeda, Hezbollahu, Hamasi, Xhiahadi ik, Talibanët etj.), janë mpleksje politiko-mafioze me shumë probleme dhe me veprimtari të pista, si ato të trafikimit të armëve, pastrimit të parave, trafikut ndërkombëtar të drogës etj.

Al Kaeda" përbën një rrjet me të cilin lidhen më tepër se 40 organizata dhe lëvizje terroriste ndërkombëtare. Ajo ka pranuar realizimin e goditjeve të konsiderueshme në vende të ndryshme të botës dhe vazhdon të mbetet e rrezikshme. Al Kaeda dhe lidhjet e saj mbeten një rrezik i madh jo vetëm për Perëndimin, por edhe për vetë vëndet arabe, edhe pse kundërveprimi ka qenë dërmues dhe se mbështetjet financiare po u ndërpriten çdo ditë, falë një bashkëpunimi të gjerë ndërkombëtar. Fshehtësia e organizimit dhe e funksionimit të një organizate terroriste është elementi më i rëndësishëm

Sipas disa studiuesve, grupet dhe organizatat terroriste përbehen nga këto kategori individësh:

- Udhëheqës të mirëfilltë që vendosin procedura, përpunojnë plane dhe drejtojnë aktivitetin.
- Individe aktivë-ekzekutorë që zbatojnë urdhërat e udhëheqësve dhe planet e tyre.
- Përkrahës aktive. Këta japin mbështetjen e duhur logjistike për të kryer veprimet.
- Përkrahës pasivë. Këta e simpatizojnë kauzën, por i tremben ndëshkimit për shkak të pjesëmarrjes aktive në veprimtarinë e grupit.. Ata mund të japin ndihma spontane.

GRUPET TERRORISTE, ELEMENTET, NDARJA E TYRE DHE MOTIVACIONI.

Ç'ka e nxit një qenie njerëzore me mendim racional të terrorizojë shoqërinë? Ndoshta është e vështirë të kuptohet arsyeja prapa asaj që duket si një shpërthim

ose atentat iracional. Një ekzaminim më i afërt do të tregojë se veprimi është kryer për arsye shumë racionale.

Tani për tani, pranojmë premisën që terroristët janë qenie përgjithësisht racionale. Faktor i rëndësishëm mund të jetë motivacioni i tyre individual. Motivacioni, megjithatë, nuk është një faktor që mund të prezantohet me lehtësi. Në të vërtetë, prezantimi i tij mund të jete gati i pamundshëm. Elementi i përbashkët i terroristëve të sotëm është urrejtja e tyre e përgjithshme ndaj demokracisë perëndimore, veçanërisht ndaj amerikaneve. Amerikani përfaqëson shumicën e gjërave, të cilat terroristet i kritikojnë haptazi, siç janë liria, kapitalizmi dhe demokracia. Ky raport antagonist është shumë i rëndësishëm. Nëse nxitet shkalla e duhur e urrejtjes, mund të dehumanizohet kundërshtari dhe të justifikohet pothuajse çdo vepër e dhunës që është kryer kundër tij. Ndërsa disa parapëlqejnë ta vënë terroristin në kategoritë e caktuara në bazë të ideologjive, bindjeve fetare ose gabimeve të ngjashme, Dr. Frederik Haeker, në librin e tij "Ithtarët, kriminelët dhe budallenjtë" i kategorizon terroristët. Ithtarë janë përgjithësisht ata që kanë një kauzë të vërtetë ose të paramenduar, për të cilën duhet luftuar. Ata përgjithësisht kanë një bindje të fortë në atë kauzë dhe zakonisht bazohen në ndonjë ideologji për të justifikuar veprimet e tyre. Të luftuarit për një çështje është njëra nga liritë e demokracisë, deri sa bëhet në mënyrë paqësore. Kur ithtari u kthehet veprimeve të dhunshme për të shprehur një qëndrim ose për të arritur një qëllim politik, atëherë është kryer akti i terrorizmit³⁴.

Ndërsa është e vërtetë që të gjithë terroristët mund të klasifikohen si kriminelë të shoqërisë sonë, terroristët që kanë motive vertetë kriminale janë të pakët.

Fatmirësisht, organet profesionale dhe të përkushtuara të zbatimit të ligjit e kanë trajtuar këtë grup në mënyrë të ashpër dhe kanë penguar seriozisht veprimet e tyre. Dikush mund të thotë se edhe mafia përdor taktika të llojit terrorist dhe këtë e bën me efikasitet. Elementi kryesor që mungon në aktivitetet e tyre është përdorimi i frikës për një qëllim politik; dhuna e mafias është e bazuar në përfitime personale.

³⁴ Dr. Frederik Haeker - Ithtarët, kriminelet dhe budallenjte

Por për veprimet e tyre duket se ka edhe arsye të tjera, sidoqoftë, asnjë nga këto kategori nuk mund të përjashtohet., Ithtari i vërtetë i levizjes i kthehet shpesh veprës penale për të financuar ithtarët. Ndërsa një vjedhje mund të mos ishte e pranueshme, përjashtimi është se terroristi zhvillon gjuhën e vet me qëllim që veprimet e tij të duken të fuqishme dhe të justifikueshme. Dallimi mes ithtarëve të lëvizjes dhe kriminelëve është në të vërtetë akademik. Në kushtet aktuale që jemi, është e dobishme të klasifikohen terroristët sipas vendit ku kryhet terrori. Në këtë kategori hyjnë terroristët që nuk kanë lidhje me shtetin, terroristët që mbështeten nga shteti ose ata që dirigjohen nga shteti. Shpesh mendoj se përgjithësisht një shtet sovran nuk do t'i kthehej terrorizmit në mënyrë të konsiderueshme.

Megjithatë shumë vënde kanë adhur në përfundimin se terrorizmi është element i rëndësishëm në arenën ndërkombëtare. Tani që vendet kanë treguar vullnet për të përdorur taktikën e terrorizmit, është me rëndësi që të shqyrtojmë implikacionet strategjike të kësaj taktike dhe si mund të shfrytëzohet ajo për të arritur rezultate "të lira". Vlen që terrorizmi të shqyrtohet për nga aspekti taktik, operacional dhe strategjik. Përdorimi i terrorizmit si anë taktike për të sulmuar shënjestrat e zgjedhura mund të jetë një anë e dobishme dhe efektive, nëse zbatohet si duhet. Zgjedhja e shënjestrës, metodologjia e sulmit dhe rreziku duhet të vlerësohen gjithmonë me kujdes.

Kërcënimi nga dhuna dhe mundësia për të shkaktuar dhunë është e zakonshme për terroristët , ku sulmi ndaj të pambrojturve nuk janë pasoja të padëshiruara por strategji e paramenduar mirë. Organizimi strukturor i grupit tregon dhe forcën apo dobësinë e tij. Një njohje e përgjithshme e modeleve të organizimit na çon në një njohje më të mirë të aftësive të tyre. Njohja e emërimit dhe sistemeve të klasifikimit që kanë grupet apo individët na ndihmon në eliminimin e termave të panjohur.

Kohët e fundit imazhi popullor për një grup terrorist është se ata veprojnë në bazë të një politike dhe motivimi ideologjik, nga dëshira për liri etnike ose kombëtare. Megjithatë është e vërtetë, për disa grupe ky imazh nuk është i plotë. Gjithashtu ndryshimi i Lidershipit në një organizatë sjell dhe ndryshime të mëdha brënda vetë grupit.

- Në përgjithësi ka dy lloj kategorish organizatash.

1. Organizata Hierarkike

2. Organizata në formë Rrjeti.

Mosha, koha e organizatës është një nga faktorët që përcakton nëse organizata do të adaptojë një strukturë Rrjeti apo Hierarkike. Në përgjithësi grupet e reja tentojnë drejt një strukture Rrjeti. Gjithashtu ideologjia ndikon shumë në strukturën e grupit, p.sh grupet komuniste, kanë tendencë drejt kontrollit të centralizuar dhe një strukturë hierarkike. Në pjesën më të madhe të grupeve përdorin organizimin në formë celulash, pasi paraqitet një formë më e sigurtë organizimi.

Grupet terroriste të cilat janë të lidhura ose kanë një krah politik në përgjithësi kërkojnë një strukturë hierarkike në mënyrë që të kordinojnë sa më mirë një akt terrorist me një qëndrim politik të caktuar. Gjithashtu mund të jetë e nevojshme politikisht për të bërë një armëpushim ose evitim të objektivave të caktuara për përfitime politike. Kjo gjë është shumë e vështirë në një strukturë Rrjeti. (Netëork).

Grupet Terroriste mund të jenë në fazën e ndryshme të zhvillimit në terma të kapaciteteve dhe sofistikimit. Grupet e reja me pak mbështetje janë më pak të afta dhe operojnë në zona të vogla ose nën tutelën e një grupi më të madh e të fuqishëm.

Grupet me motivim etnik ose nacionalist i kufizojnë operacionet e tyre në vende të caktuara ose në një rajon dhe përgjithsisht janë më pak të afta. Grupet mund të bashkohen në organizata ose të ndahen nga një organizatë më e madhe.

Terroristët i organizojnë celulat mbi baza familjare, shoqërie, gjeografike ose të funksionit.

Elementi më i vogël në një organizatë është celula. Një nga arsyt kryesore të organizimit në celula është siguria. Kompromentimi apo humbja e

një celule nuk mund të kompromentoj identitetin, vendodhjen apo aksionet e celulave të tjera.

Një strukturë e përbërë nga celula e bën më të vështirë depertimin në tërë organizatën. Personat përbërës të një celule shpesh janë të pa informuar për egzistencën e celulave të tjera kështu që nuk mund të japin informacion. Anëtarët e një celule qëndrojnë shumë afër duke mbështetur njeri tjetrin moralisht, në këtë mënyrë parandalojnë dezertimin dhe thyerjen e procedurave të sigurisë. Kryetari i celulës është normalisht i vetmi person që ka lidhje me persona të tjerë më të lartë se ai në pozicion, dhe me celulat e tjera.

Një grup terrorist mund të formojë një ose shumë celula të cilat veprojnë në nivel lokal ose ndërkombëtar. Numri i celulave dhe përbërja e tyre varet nga madhësia e grupit terrorist.

Një grup terrorist i cili operon në një vend të vetëm ka më pak celula dhe skuadra speciale sesa një grup terrorist ndërkombëtar i cili mund të veprojë në shumë shtete.

Terroristi nuk ka kontroll mbi implikacionet strategjike të terrorizmit. Rezultati përcaktohet nga faktorë të jashtëm, në të cilët terroristi nuk ka fare ose ka pak ndikim dhe nuk ka kontroll përveç atij sipërfaqësor. Faktorët e jashtëm përfshijnë median, shënjestrën e zgjedhur metodën e sulmit, aspektet ligjore, opinionin e përgjithshëm publik dhe ç'është ndoshta më e rëndësishmja nga të gjitha, reagimi i qeverisë ndaj një incidenti ose një vargu incidentesh.

Eshtë me rëndësi të ndërtojmë një mentalitet të duhur te sigurisë. Duhet të përgatitemi për mbrojtje kundër taktikës (armatimet, municionet që përdor) dhe jo personit që përdor taktikën.

KATEGORITE E GRUPEVE TERRORISTE.

Ka shumë kategori të terrorizmit dhe grupeve terroriste. Këto kategori shërbejnë për të diferencuar organizatat terroriste mbi bazën e disa kriterëve të

caktuara. Gjithashtu shpeshherë bëhen kategorizime arbitrare nga ana e medias, p.sh çdo grup terrorist duhet të jetë patjetër radikal.

Separatistët: Grupet separatiste janë ato të cilat kanë për qëllim të tyre, ndarjen nga “Shtete Ekzistuese” ndërmjet pavarësisë, autonomisë politike ose të lirive fetare. Ideologjia separatiste përfshin edhe nocione të tilla si drejtësi sociale, barazi, anti-imperializem etj.

Etnocentrik: Grupe të tilla e shohin Racën si karakteristikën dalluese në shoqëri dhe se një grup i caktuar është superior ndaj të tjerëve vetëm për shkak të prejardhjes së tyre Racore.

Nacionalistët: Grupe të tilla besojnë në besnikërinë dhe devotshmerinë, si dhe vendosjen e kulturës dhe interesave të një kombi mbi kulturën dhe interesat e kombeve të tjera. Kjo karakteristikë mund të gjej formë në momentin e krijimit të shteteve të reja apo gjatë shkëputjeve të pjesës së një shteti për t’u bashkuar me një shtet tjetër me të cilin ka të njëjtin identitet kombëtar.

Revolucionarët: Gjithë dedikimi i tyre është në rrëzimin e një pushteti egzistues dhe zëvendësimin e tij me një strukturë të re politike dhe sociale. Në përgjithësi kjo ka lidhje me politikën ideologjike komuniste. Gjithsesi kjo nuk do të thotë se grupe të tjera nuk do të përdorin revolucionin për arritjen e qëllimeve politike.

Fetare: Terrorizmi me baza fetare është në rritje, ndërkohë që terroristet Islamik kanë qënë dhe janë më aktivet duke qënë dhe kërcënimi më i madh për momentin. Të gjitha fetë e botës kanë ekstremistët e tyre të cilët përdorin dhunën për arritjen e objektivave të tyre fetare. Terroristët me motivim fetar i shohin objektivat e tyre si të shenjta dhe detyruesisht të panegociueshme.

Sociale: Shpesh disa politika sociale mund të jene kaq të kontestuara sa ato mund të çojnë në sjellje ekstremiste dhe terroriste. Zakonisht këto etiketohen si terrorizëm me “interes special”. Disa nga shkaqet të cilat kanë prodhuar aktivitet terrorist në SHBA dhe vende të tjera përfshijnë, të drejtat e njeriut, minoriteteve, aborti, ekologjia etj.

Lokal: Këta terrorista janë “të rritur në shtëpi” dhe operojnë brenda dhe kundër vendit të tyre. Ata janë pjesa ekstreme social politike brenda një shoqërie të caktuar, dhe e fokusojnë aktivitetin e tyre vetëm në arenën social-politike të vendit të tyre.

Ndërkombëtar: Grupet ndërkombëtare mund të klasifikohen në dy grupe:

A. Në grupin e parë hyjnë ato grupe ndërkombëtare të cilat veprojnë në shumë vende por mbajnë një fokus gjeografik të aktivitetit të tyre. Psh, grupi Hezbollah ka celula në të gjithë botën por është i fokusuar parësisht në ngjarjet Izrael-Liban.

B. Në grupin e dytë futen grupet të cilat janë të angazhuar në të gjithë botën dhe nuk janë të fokusuar në një vend të caktuar apo rajon. Psh, Al Qaeda është një grup i tillë, ka përbërje me kombësi të ndryshme, ka baza në të gjithë botën. Objektivi i tyre kanë qenë shumë shtete me sisteme të ndryshme politike, fetare, etnike dhe interesa. Gjithsesi me gjithë ndarjen e mësipërme nuk mund të themi se s’ka grupe që të mos përfshijnë karakteristika të 2 apo më shumë ndarjeve të mësipërme.

DEFINICIONE

Në vitet e fundit është shkruar shumë për terrorizmin: individë nga komuniteti, akademike si dhe të tjerë me përvojë praktike kanë dhënë definicionet e tyre për terrorizmin. Padyshim, në bazë të shumëllojshmërisë së këtyre definicioneve, terrorizmi ka domethënie të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Këtu kemi parashtruar disa definicione të zgjedhura, të cilat përfshijnë këto pikëpamje të ndryshme. Duket se ato kanë ngjashmëri dhe ndonjëherë vërehet ndonjë element i përbashket. Amerikanet Brian Jenkins, Rand Corp³⁵: "Terrorizmi është dhunë që ka për qëllim të arrijë një qëllim, jo në radhë të parë dhe ndonjëherë aspak një efekt fizik në një shënjestër të caktuar, por më shumë një ndikim dramatik dhe publik."

³⁵ Definicione mbi terrorizmin ndërkombëtar

“Terrorizmi është përdorim i kalkuluar i dhunës ose kërcënimit me dhunë për të arritur qëllime shpesh të natyrës politike, fetare ose ideologjike përmes frikës, frikësimit ose detyrimit. Ka të bëjë me një vepër penale - shpesh simbolike për nga natyra dhe ka për qëllim të ndikojë në një publik që tejkalon suazat e viktimes së rastit.”

- Terrorizmi politik: (L. A. Sobel etj., Nju Jork; Fakte në dosje, inc. 1975): "Në përgjithësi, fjala terrorizem përdoret sot për të dëftuar të gjitha veprimet e paligjshme të dhunës, të kryera nga grupe klandestine për qëllime politike."
- Terrorizmi nacional: Një terrorist që vepron ose aspiron fuqi politike kryesisht brenda një vendi.
- Terrorizem ndërnacional: Një terrorist i cili vepron përtej kufijve kombëtare, veprimet dhe aspiratat politike të të cilit mund të atakojnë individët e më shumë nacionaliteteve.
- Terroristi ndërkombëtar: Një terrorist i cili është i kontrolluar dhe veprimet e të cilit përfaqësojnë interesat kombëtare të një shteti sovran.
- Terrorizmi i sponsorizuar nga shteti: Terrorizmi i cili ka mbështetje aktive ose pasive nga një shtet sovran.
- Terrorizmi i drejtuar nga shteti: Terrorizmi i drejtuar nga një shtet sovran, ku shteti është drejtperdrejt i përfshirë në zgjidhjen e shenjestres dhe kryerjen e misionit.
- Terrorizmi që nuk ka të bëjë me shtetin: Grupi nuk ka mbështetje të identifikueshme të një shteti sovran.

Përgjithësisht, terrorizmi është një vepër e paligjshme dhe e dhunshme ose kërcënim për përdorimin e dhunës. Vepra kryhet duke pasur parasysh qëllimin politik dhe ka për qëllim të ndikojë në sjelljen e të tjerëve. Thënë thjeshtë, terrorizmi është përdorimi sistematik i frikës për të ndryshuar sjelljen e të tjerëve për qëllime politike. Të gjitha llojet e terrorizmit kanë vepra penale. Por të gjitha veprat penale nuk janë terrorizëm; në fakt një pjesë e madhe e veprave penale nuk janë terroriste për nga natyra. Konkludimi është mjaft i qartë: që një veper penale të vlerësohet si terroriste, duhet të jetë kryer nga një terrorist.

MËNYRA E VEPRIMIT TË TERRORISTËVE

Grupet terroriste bashkekohore kanë përdorur një shumëllojshmëri taktikash për të arritur qëllimet e tyre politike, shoqërore ose ekonomike. Metodatat më të përdorura kanë qenë vënia e zjarrit ndërtesave, vënia e bombave, rrëmbimet e njerezve dhe e mjeteve levizëse, sulmet kundër mjediseve në përdorim publik, shkatërrimi i pronave, vrasjet e njerëzve të zakonshëm dhe vrasjet e figurave politike. Arsenali i terroristeve përfshin jo vetëm lëndët plasëse dhe armët e zjarrit, por edhe mjete më të sofistikuar, si raketat antitank dhe raketat tokë-ajër.

Megjithëse të gjithë terroristët karakterizohen nga e njëjta skemë e përgjithshme e veprimtarisë kriminale, mënyrat e veprimit të grupeve terroriste të veçanta ndryshojnë dukshëm në varesi të motivit dhe të aftësive të çdo grupi. Grupet e vogla dhe jo të sofistikuar priren kryesisht për vënie bombash. Ato që gëzojnë mbështetjen e një shteti dhe pjesetarët e të cilave zotërojnë aftësi me të mëdha përgjithësisht orvaten të kryejnë operacione më të nderlikuara, si rrëmbime personash, vrasje figurash politike, sulme kundër mjediseve publike dhe rrëmbime mjedesh të lëvizshme.

Ajo çka është veçanërisht shqetësuese, ka të bëjë me faktin se në arenën e veprimeve terroriste po fillojnë të shfaqen "super armët". Me një fjalë, ndërkohë që zhvillimet teknologjike u ofrojnë grupeve terroriste aftësi të reja, edhe menyrat e tyre të veprimit mund të ndryshojnë. Sipas raporteve të ndryshme të zbulimit, të paktën mbi dhjetë grupe terroriste kanë treguar interes për të shtënë në dorë armët biologjike, kimike ose bërthamore. Në vitin 1995, kur kulti japonez i "Ditës së Gjyqit të Madh" Aum Shinrikio sulmoi me gaz sarin një zonë të metrose së Tokios, nga i cili vdiqën dymbëdhjete vetë dhe u lënduan mbi pesë mijë të tjerë, udhëheqësit e tij të arrestuar thanë se po kërkonin armë më vdekjeprurëse se gazi sarin.

Megjithatë, edhe pse gjatë katër dhjetëvjeçarëve të kaluar terroristët kanë arritur suksese taktike të ndjeshme, nganjëherë ata e shikojnë si politikisht më të leverdisshme që ta ulin nivelin e dhunës politike. Por është e rëndësishme të kuptohet se këto kufizime të vullnetshme nuk do të vazhdojnë përgjithmonë dhe në të ardhmen incidentet do të vazhdojnë të shkaktojnë qoftë viktima në njerëz qoftë shkatërrime të pasurisë materiale.

Disa kushte të caktuara, si ekstremizmi fetar ose pikepamjet se "kauza" e tyre ka pësuar humbje mund t'i nxitin terroristet t'i përshkallezojnë në mënyrë dramatike sulmet e tyre.

Madje, incidentet terroriste në të ardhmen mund të jenë më shkatërrimtare në viktima njerëzore dhe në shkatërrime të pasurisë se në të kaluarën. Përdorimi i armëve të shkatërrimit në masë (biologjike, kimike ose bërthamore) si instrumente të terrorizmit mund të shkaktojë dëme të përmasave jashtëzakonisht të mëdha në njerez e pasuri. Përshembull, megjithese mundësia e terrorizmit bërthamor mbetet ende e vogël në krahasim me terrorizmin biologjik e kimik, pasojat e shkatërrimit në masë mund të jenë të pallogaritshme. Kështu, nëse një bombë me fuqi një kiloton (një e njëzeta e fuqisë së bombës që u hodh mbi Hiroshimë) vidhet (ose ndërtohet nga një grup me burime e aftësi të mjaftueshme) dhe shpërthen mbi një qytet të madh, ajo do të shkaktoje më shumë se njëqind mijë viktima si dhe dëmtime materiale që do të shkonin në miliarda dollarë. Pasojat njerëzore, fizike e psikologjike të një incidenti të tillë do të ishin shumë më katastrofike se ato të aksidenteve që ndodhën në Cernobil dhe që u shkakjuan nga operatorët që, pa dashje, nuk zbatuan kërkesat e sigurimit teknik në sistemet e reaktorëve bërthamorë

Terroristët dhe rendi botëror

Qëllimi i terrorizmit është që të ndikojë në një pjesë të shoqërisë, përmes përdorimit sistematik të frikës. Siç u diskutua më heret, lojtari kryesor mund të jete aktualisht shtypi. Përmes shtypit filtrohen ngjarjet e ditës. Në të shumtën e rasteve ne kemi këndvështrimin e medias për ngjarjet. Shume grupe terroriste janë bërë mjeshtër të manipulimit të shtypit. Ata e dinë se shtypi do të sillet në një mënyrë pothuajse të parashikueshme ndaj një ngjarjeje që ka potencial të bëhet lajmi kryesor. Për shumë arsye qeveria është relativisht e paefektshme në përdorimin e shtypit.

Shpesh shtypi shërben që grupi terrorist të duket edhe më i madh dhe tejet efektiv, ndërsa qeverinë e bën të duket e paarsyeshme dhe e paaftë për t'u ballafaquar me terrorizmin.

Fazat e sulmit terrorist

Diagrami që vijon tregon fazat e dallueshme të një sulmi tipik terrorist. Është me rëndësi të kuptohen metodat e punës të armiqve tanë. Kjo me shpresë do të na ndihmojë të zhvillojmë procedura për të penguar informacionet, të cilat terroristët mund ti përdorin kundër nesh.

Gjatë fazës së parë ose fazës para incidentit, terroristi planifikon sulmin. Zgjedhja e shënjestrës bëhet zakonisht në bazë të objektivave afatshkurtëra dhe afatgjata, dobësive të njohura informacioneve dhe përvojës së fituar nga operacionet e kaluara. Faza e planifikimit është pa dyshim më e rëndësishmja dhe terroristi do të angazhohet në grumbullimin e të dhënave të ndryshme. Kjo mund të përfshijëurvejimin, hyrjen në objektin - shënjestër, përdorimin e informatorëve dhe çdo të dhënë tjetër që do të sigurojë një sulm të suksesshem. Përgatitja logjistike është zakonisht e gjërë dhe përfshin gjetjen e transportit, radios, dokumentave, maskave, mbulesave armëve, municionit dhe eksplozivëve. Ndoshta pjesa më e rëndësishme e kësaj faze është përseritja në hollësi për të siguruar që çdo aktor e kupton plotësisht rolin e tij dhe rolin e të tjerëve. Gjatë kësaj faze për një sulm të suksesshem janë tejet të rëndësishme fshehtësia absolute dhe e ashtuquajtura siguria e operacionit (OPSEC).

Rrjeti ndërkombëtar

Grupet terroriste nuk operojnë të izoluar dhe pa njohur njëri-tjetrin. Mbështetja reciproke është shumë e dobishme. Ndërsa mund të jetë e vështirë të kuptojmë nëse ka ndonjë seli ndërkombëtare, e cila dirigjon kur është fjala për shenjestrat operative, është dëshmuar disa herë se ekziston një kualicion i lirë. Nuk është e vështirë të kuptohet që terroristët e botes t'i referohen njëri-tjetrit nga shok i përbashkët - individ që ata kanë njohur gjatë stërvitjes ose në ndonjë shtepi të sigurtë. Lista e gjërave, të cilat janë në dispozicion për anëtarët e këtij rrjeti joformal përfshin armët, municionin, përvojën, stërvitjen dhe doktrinën, zbulimin, eksplozivët, shtëpi të sigurta, dokumentet dhe shumë të tjera, meqë lista është e pafund. Të fitosh përkrahje nga një vend, është ndoshta përkrahja më e vlefshme që mund të arrihet. Kjo i jep terroristit një mundësi që të kthehet në një vend relativisht të sigurtë, për të rimbushur bateritë, si të thuash. Shumë vende janë akuzuar për lloje të ndryshme të mbështetjes që u kanë dhënë terroristeve të botës. Këtu përfshihen jo vetëm Libia,

Koreja e Veriut, Vietnami, Siria dhe Kuba, por edhe vende të tjera. Ka raporte që këto vende kanë objekte të gjera stërvitore dhe një kuadër profesional, që ofron stërvitje të hollësishme.

Një shembull i përdorimit të këtij rrjeti ishte masakra në aeroportin e Lodit. Anëtarë të Armatës së Kuqe Japoneze (JRA) i kryen një shërbim Frontit Popullor për Çlirimin e Palestinës në 30 Maj të vitit 1972. Përgatitjet dhe planet e tyre pëfshinë udhëtimin në Shtetet e Bashkuara, Kanada, Francë dhe pastaj në Liban, ku u stërvitën me taktika guerile në një kamp stërvitor në Fedayeen³⁶. Prej aty ata udhëtuan në Romë, ku u fumizuan me armë çeke dhe municion dhe u strehuan në një shtepi të sigurve, ku priten kohën e përshtatshme për të udhëtuar në Tel Aviv për të kryer veprat finale.

Bibliografia

- Dr. Frederik Haeker - Ithtarët, kriminelët dhe budallenjtë
- Definicione mbi terrorizmin ndërkombëtar
- Claire Sterling – Rrjeti i Tmerrit
- George Kassimeris, Terrorism and Political Violence

³⁶ Claire Sterling – Rrjeti i Tmerrit

KONTIBUTI I ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR RUAJTJEN DHE ZHVILLIMIN E PAQES DHE SIGURISË GLOBALE

PhD. Gezim Rushiti

(ge-zim1990@hotmail.com)

ABSTRAKT

Problemi i paqes dhe i luftës është një nga problemet më thelbësore që i shtrohen njerëzimit. Trajtimi shkencor i luftës dhe paqes është po aq i vjetër sa edhe vetë shkenca. Paqaja paraqet marrëdhënie të mira ndërmjet njerëzve, pa grindje e pa armiqësi. Gjendje pa shqetësime e një njeriu a e një mjedisi, qetësi, gjendje e qetë në një vend a ndërmjet dy a më shumë shteteve, pa luftëra e pa ndeshje. Marrëveshje ndërmjet dy a më shumë shteteve për të pushuar luftën. Siguria është nevojë dhe gjendje të cilën në mënyrë të drejtpërdrejtë e kanë ndier shumë popuj dhe kombe të botës. Fuqia dhe rëndësia e saj për qytetarin e zakonshëm dhe për shtetin i motivon njerëzit për gjetjen e korrelacionit të sigurisë me ekzistencën e njeriut dhe me mbijetesën e shtetit.

Çdoherë kur gjendja e sigurisë ka të bëjë me bashkësinë globale ndërkombëtare, ne këtë e emërtojmë si siguri ndërkombëtare, globale ose universale. Siguria ndërkombëtare, jo vetëm që e përcakton sigurinë kombëtare individuale të përgjithshme por, gjithashtu, është edhe opsion i vlerave të marrëdhënieve ndërkombëtare në kornizat e kombeve-shtete. Organizata e Kombeve të Bashkuara mbijetoi në kohërat e vështira dhe u afirmua si qendër e politikës botërore, institucion i cili ka dhënë kontribut për paqen dhe sigurinë si

dhe për zgjidhjen e çështjeve globale të planetit tonë. Qëllimi kryesorë i OKB – së dhe institucioneve të saj është që të ruaj dhe zhvillojë paqen dhe sigurinë globale.

Fjalët kyçe : *Paqja dhe siguria globale, Organizata e Kombeve të Bashkuara, Kontributi i OKB –së për ruajtjen dhe zhvillimin e paqes dhe sigurisë globale, Paqeruajtja, Misionet paqësore të OKB –së.*

HYRJE

Problemi i paqes dhe i luftës është një nga problemet më thelbësore që i shtrohen njerëzimit³⁷. Trajtimi shkencor i luftës dhe paqes është po aq i vjetër sa edhe vetë shkenca. Tronditja e re politike dhe morale e sistemit të shteteve përmes Luftës së dytë Botërore si dhe përmes asgjësimit masiv të organizuar politikisht në stalinizëm dhe fashizëm, por, para së gjithash, gjasat e kërcënimit të një lufte bërthamore bënë që në fund të viteve 50, si reagim ndaj ideologjisë dominuese të Luftës së Ftohtë, të lindnin kërkimet shkencore mbi paqen. Kështu, u krijuan institute që merren me studimin e tyre, me marrëdhëniet ndërkombëtare, si në Britaninë e Madhe, SHBA Kanada, etj. Këto institute kishin si detyrë realizimin e kërkimeve shkencore rreth luftërave dhe konflikteve ndërkombëtare, por edhe rreth revolucioneve dhe luftërave civile si dhe kushteve për një paqe të qëndrueshme botërore. Nga pikëpamja e kërkimeve shkencore të sjelljes, lufta dhe paqja janë koncepte metaforike për dy gjendje të ndara jo krejtësisht qartë nga njëra-tjetra në një vazhdim agresioni, që kërkon të sigurojë mbijetesën dhe ecjen përpara të llojit, ku zhvillimi i teknikës së armëve bëri që, skrupujt instiktivë të pakësoheshin dhe që lufta të shndërrohej në një formë jo-instiktive të zhvillimit të një konflikti brenda llojit³⁸. Shteti dhe aktorët e ndryshëm politikë përplasen përherë mes tyre për çështje interesash që mund të jenë të fshehura ose jo nën petkun e grindjeve ideologjike apo të debatit rreth vlerave. Armën e konflikteve të sotme e të

³⁷ Pascal Boniface, Si ta kuptojmë botën, Tiranë, 2012, f, 251

³⁸ Pajtim Ribaj, Shpëtim Cami, Lufta, Paqja, Siguria – Realitete Ballkanike, Tiranë, 2015, f, 49

ardhme e mbajnë gjallë synimet territoriale, perceptimet e frikës, siguria e furnizimeve, kontrolli i rrugëve strategjike, trashëgimitë e helmatisura të kolonizimit e të shkolonizimit, shembja e perandorive.³⁹ Paqëja paraqet marrëdhënie të mira ndërmjet njerëzve, pa grindje e pa armiqësi. Gjendje pa shqetësime e një njeriu a e një mjedisi, qetësi, gjendje e qetë në një vend a ndërmjet dy a më shumë shteteve, pa luftëra e pa ndeshje. Marrëveshje ndërmjet dy a më shumë shteteve për të pushuar luftën.⁴⁰ Pacifizmi paraqet mospranimin e luftës si mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.⁴¹ Ndërtimi i paqes përfshin të gjithë hapat dhe veprimet individuale që kontribuojnë në ndërtimin e urave të komunikimit, bashkëpunimit, mirëkuptimit dhe besimit, përtej kufirit të armiqësisë, dhe kështu kontribuon për një sens të përgjithshëm dhe të ndërsjellë të sigurisë dhe vetëdijes për lidhshmërinë e ndërsjellë. Ekzistenca e qëllimit nuk mund të jetë kriteri i vetëm për të vlerësuar nëse një veprim kontribuon për ndërtimin e paqes, nuk kontribuon për të, ose ndoshta përmban aspekte të veprimit të vet të cilat e shkatërrojnë paqen dhe nuk e ndërtojnë. Siç procesi shoqëror i ndërtimit të paqes nuk është proces linear i përparimit të përhershëm, por proces me ngritje dhe rënie, ashtu edhe aksionet të cilat e kanë për qëllim ndërtimin e paqes mund të kenë ndikim afatshkurtër të cilin mund ta përshkruajmë si shkatërrim të paqes, ndërsa në afat të gjatë si ndërtim të paqes.⁴²

Siguria është nevojë dhe gjendje të cilën në mënyrë të drejtpërdrejtë e kanë ndier shumë popuj dhe kombe të botës. Fuqia dhe rëndësia e saj për qytetarin e zakonshëm dhe për shtetin I motivon njerëzit për gjetjen e korrelacionit të sigurisë me ekzistencën e njeriut dhe me mbijetesën e shtetit.⁴³ Gjendja e sigurisë paraqet fenomen kompleks, i cili jep pasqyrë të vëllimit dhe intensitetit të më shumë elementeve

³⁹ Pascal Boniface, Si ta kuptojmë botën, Tiranë, 2012, f, 257

⁴⁰ Fjalor i shqipes së sotme, Botim i dytë i ripunuar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f, 925

⁴¹ Abdulla Azizi, Etem Aziri, Zemri Elezi, Fjalor – shumëdimensional i termave dhe shprehjeve administrative, politike, sociale dhe të diplomacisë, Shkup, 2009, f, 136

⁴² Ivana Franoviq, Nenad Vukosavljeviq, Padhunshmëria, Doracak trajnimesh për ndërtimin e paqes, Qendra për Aksion të Padhunshëm Aksioni Paqësor, f, 40

⁴³ Rade Rajkovçevski, Ndërtimi i politikës së sigurisë : rasti I Republikës së Maqedonisë, Shkup, f, 12

të kërcënimit të sigurisë kombëtare, të cilat në një kohë të caktuar veç e veç ose të kombinuara ndikojnë mbi sigurinë e qytetarëve, komunitetit ose mbi një çështje konkrete të rrezikimit dhe mbi shtetin. Gjendjen e sigurisë e përbëjnë më shumë faktorë ose indikatorë. Ata tregojnë se si është gjendja e sigurisë sa u përket pyetjeve në lidhje me rendin dhe qetësinë publike, ndikimin e elementit të huaj mbi sigurinë e brendshme, kërcënimet të cilat rezultojnë nga organizata ekstremiste, zhvillimin e ngjarjeve të sigurisë në rajon dhe në botë, marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit e të tjera.⁴⁴ Çdoherë kur gjendja e sigurisë ka të bëjë me bashkësinë globale ndërkombëtare, ne këtë e emërtojmë si siguri ndërkombëtare, globale ose universale. Siguria ndërkombëtare, jo vetëm që e përcakton sigurinë kombëtare individuale të përgjithshme por, gjithashtu, është edhe opsion i vlerave të marrëdhënieve ndërkombëtare në kornizat e kombeve-shtete. Ekzistenca kombëtare, në një botë të ndërvlarur progresive, kërkon kornizë permanente ndërkombëtare për vlera përgjithësisht të pranuar, si bazë për rregullimin e marrëdhënieve midis subjekteve ndërkombëtare. Duke e pasur parasysh kompleksitetin dhe shtresimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, nivelet e proceseve të integritit dhe globalizimit, efikasitetin ose joefikasitetin e mekanizmave për sigurimin e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare, gjendjen e punëve në marrëdhëniet ushtarake, politike, ekonomike dhe në marrëdhëniet e tjera mes shteteve, me sa duket siguria ndërkombëtare duhet të jetë një shumë masash të cilat do ta sigurojnë ekzistimin e të gjitha shteteve dhe është kushti sin equa non për ekzistimin dhe zhvillimin e sigurisë ndërkombëtare.⁴⁵

⁴⁴ Rade Rajkovčevski, Ndërtimi i politikës së sigurisë : rasti I Republikës së Maqedonisë, Shkup, f, 25

⁴⁵ Marina Mitrevska, Anton Grizold, Vllado Buçkovski, Entoni Vanis, Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve – Rasti i Maqedonisë (Paradigma e re e sigurisë), Bomat grafiks, Shkup, 2009, f, 33

RUAJTJA DHE ZHVILLIMI I PAQES DHE I SIGURISË GLOBALE SI QËLLIM I ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA

Kjo Organizatë mbijetoi në kohërat e vështira dhe u afirmua si qendër e politikës botërore, institucion i cili ka dhënë kontribut për paqen dhe sigurinë si dhe për zgjidhjen e çështjeve globale të planetit tonë.⁴⁶

➤ Qëllimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara janë:

- 1) Të ruajë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare dhe për këtë qëllim : të marrë masa kolektive efektive për parandalimin dhe zhdukjen e kërcënimeve të tjera ndaj paqes dhe me mjete paqësore e në përputhje me parimet e drejtësisë dhe të drejtës ndërkombëtare, të çojë në rregullimin ose zgjidhjen e situatave ose konflikteve ndërkombëtare, të cilat mund të çojnë në prishjen e paqes.

Të zhvillojë marrëdhënie miqësore midis kombeve bazuar mbi respektin për parimet e të drejtave të barabarta dhe vetëvendosjes së kombeve dhe të marrë masa të tjera

të përshtatshme për të forcuar paqen botërore.

- 2) Të arrijë bashkëpunim ndërkombëtar në zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare me karakter ekonomik, social, kulturor ose humanitar dhe të tregojë e të inkurajojë respekt për të drejtat e njeriut dhe për liritë themelore për të gjithë pa dallim race, gjinie, gjuhe apo feje, dhe
- 3) Të jetë një qendër për të harmonizuar veprimet e kombeve në arritjen e këtyre parimeve të përbashkëta.⁴⁷

Siç shikohet, objektivat kryesorë të Kombeve të Bashkuara përmbajnë vlera universale, njëkohësisht të gjera nga përmasat dhe të përgjithshme nga formulimet. Objektivi i parë, që ka të bëjë me paqen dhe sigurinë

⁴⁶ Drita M. Fazlia, Organizatat ndërkombëtare, Arbëria Design, Tetovë, 2014, f, 42

⁴⁷ Ralph G. Feltham, Diplomacia, Tirana Times, 2010, f, 72

ndërkombëtare është themelori i Organizatës. Realizimin e këtij objekti Organizata e Kombeve të Bashkuara e ka paraparë gjithnjë në dy aspekte :

- 1) Në ruajtjen e paqes e sigurisë:
- 2) Në zgjidhjen e konflikteve dhe krizave.

Rrugë kryesore për realizimin e këtyre dy aspekteve ka qenë me mjete paqësore, me masa parandaluese dhe me ndërhyrje ushtarake paqe-ruajtëse.⁴⁸ Kombet e Bashkuara janë përpjekur që pas krijimit të tyre që të kombinojnë qëllimet e dyfishta të mbrojtjes së paqes dhe të përmisit të cilësisë së jetesës për të gjithë njerëzimin. Këto dy misione i kanë shtyrë KB që të jenë të pranishëm në trajtimin e problemeve në çdo cep të rrjetit kompleks të marrëdhënieve ndërkombëtare.⁴⁹

Por, arritja e qëllimit madhor për ruajtjen e paqes dhe sigurisë do të bënte Organizatën të zgjeronte rrugët e mjetet për arritjen e saj. Ndër to ishin edhe masta e presioneve ku bëjnë pjesë sanksionet e pjesshme dhe të përgjithshme kundër atyre subjekteve ndërkombëtare apo grup subjektsh ndërkombëtare, të cilat nuk përfillin rrugët dhe mjetet politico-diplomatike për parandalimin dhe zgjidhjen e problemeve të sigurisë. Instrumentat nga më efikasët e Kombeve të Bashkuara për arritjen e qëllimit kryesor të paqes e sigurisë ndërkombëtare ishin ***Forcat Paqe-Ruajtëse të Kombeve të Bashkuara***, të njohura ndërkombëtarisht si ***Helmetat Blu***.⁵⁰

Paqeruajtja si koncept nuk është i përcaktuar hollësisht në Kartën e OKB –së, por është zhvilluar dhe përpunuar në vite si një mënyrë e pranueshme në rang ndërkombëtar për të kontrolluar konfliktet dhe për të përkrahur zgjidhjen paqësore të tyre. Për herë të parë në histori, forcat ushtarake janë përdorur botërisht jo për të zhvilluar luftë, por për të kontrolluar dhe për t'i dhënë fund konflikteve midis njerëzve dhe komuniteteve. Nga forcat paqeruajtëse të OKB –

⁴⁸ Lisen Bashkurti. Mbi të Drejtën Ndërkombëtare dhe Organizatat Ndërkombëtare, Akademia Diplomatike Shqiptare, GEER, Tiranë, 2006, f, 95

⁴⁹ Charles W. Kegley, JR. Politikat botërore – tendecna dhe transformimi, Ufo University Press, f, 159

⁵⁰ Lisen Bashkurti. Mbi të Drejtën Ndërkombëtare dhe Organizatat Ndërkombëtare, Akademia Diplomatike Shqiptare, GEER, Tiranë, 2006, f, 97

së një operacion i tillë është ndërmarrë për herë të parë në Lindjen e Mesme në vitin 1956.⁵¹

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME PËR RUAJTJEN DHE ZHVILLIMIN E PAQES DHE SIGURISË GLOBALE

Historia Turqi-BE, për më shumë se 50 vjet, nuk është ndërtuar vetëm nga problemet e brëndshme të Turqisë si shtet, por edhe nga nga faktorët e jashtëm, ngjarjet e ndryshme dhe pozita e Turqisë kundrejt Evropës, sepse sic e përmendem më lart, Turqia pozicionet në pjesën aziatike dhe atë evropiane. Disa nga problemet aktuale të Turqisë, që kanë penguar gjithmonë anëtarësimin e saj në BE dhe vazhdojnë të jenë problem i pazgjidhur janë: çështja e Qipros, konflikti për detin Egje, konflikti me Sirinë, pozita gjeografike, numri i madh i popullsisë, besimi muslyman, qeverisja autokratike dhe sistemi ligjor, demokracia e pazhvilluar dhe liritë sociale.

- I. Konflikti me Qipron-** çështja e Qipros mbetet problem aktual për Turqinë. Ky konflikt mjaft i ndjeshëm, nuk gjeti një zgjidhje, madje debatet u shtuan kur Qipro anëtarësohet në Bashkimin Evropian. Qipro është i ndarë prej vitit 1974, kur veriu i tij u pushtua nga Turqia, e cila gjithmonë ka ushtruar ndikim në Qipron turqishtfolëse. Duke mos i përmbushur kriteret e Kopenhagës, Turqia jo vetëm tërhiqet gjithnjë e më shumë nga BE, por rrit dhe tensionet në konfliktin me Qipron. Popullsia turke në Qipro shihet si një forcë pushtuese, cka sjell një

⁸⁸ Donjeta Elshani “Bashkimi Europian dhe Turqia”, UBT Knowledge Center, 2019, faqja 15

marrëdhënie të ngushtë midis tuqve qipriotë dhe Turqisë, e cila është një mbrojtëse në marrëdhëniet ne probleme të ndryshme. Rritja ekonomike e Turqisë ka krijuar frikë tek turqit qipriotë për një rrezik demografik. Për Qipron Veriore, Turqia është e vetmja mënyrë komunikimi me tregun e jashtëm, ndersa rritja e emigrantëve turkë do të rrezikonte popullsinë turke qipriote, e cila nuk kishte mbrojtjen e duhur dhe të drejtat e plota. Pas vitit 1974, turqit qipriotë hynë në negociata për të krijuar një strukturë federale me grekët qipriotë, por kjo përpjekje dështoi. Mosmarrëveshjet midis Turqisë dhe Qipros prekin çështjet kryesore si kthimin e qipriotëve të zhvendur, kufinj të pretenduar, cmilitarizimin e ishullit, kontrollin mbi Qipron Veriore. Popullsia turkë qipriote zë 36% të territorit dhe në rast të një mosmarrëveshje të qëndrueshme, ajo do të ndryshonte dhe kjo e vë në diskutim sërish vendosjen e kufinjve.⁸⁹

II. Çështja e Egjeut- Turqia dhe Greqia kanë pasur tensione dhe konflikte të shpeshta, të cilat jo pak here i janë afruar luftës. Në konfliktin e tyre, problemi i Qipros, prej vitit 1955 e deri më sot, mbetet çështja më e prekshme dhe më delicate për këto dy vende.

Përvec kësaj çështja e Egjeut është problem i shtuar sepse përfshin 4 probleme të tjera që kanë të bëjnë me:

- Përcaktimi i kufinjve detarë dhe platformës kontinentale
- Gjërësia e ujrave territorial
- Kontrolli i hapësirës ajrore
- Armatosja e ishujve që ka Greqia në Egje

Përpjekjet për përmirësimin e raporteve kanë qënë të shumta, por për shkak të paragjyqimeve dhe opinioneve skeptikë që ekzistojnë për një kohë të gjatë në Greqi, e quajtur ndryshe “sindroma qipriote”, nuk ka pasur rezultat. Për më tepër, për shkak të perceptimit të Turqisë si kërcënim, Greqia ka investuar ndër vite në fushën ushtarake, edhe pse ato u zvogëluar në vitin 2016 për shkak të krizës ekonomike. Nga ana tjetër edhe në Turqi ekzistojnë paragjyqime ndaj

⁸⁹ Rebecca Bryant, Christalla Yakinthou “Cypriot Perceptions of Turkey”, Stamboll, 2012, faqja 15

marrëdhënies me Greqinë. Turqia bëson se Greqia përpiqët të zgjidhë problemet e Egjeut dhe Qipros sipas interesave të vëta, dukë përdorur Bashkimin Evropian. Në vitin 2010, kryeministri në atë kohë Rexhep Tajip Erdogan, realizoi një vizitë në Greqi për të bërë një hap para në afrimin e marrëdhënieve të tyre, por ende sot, kjo ceshtje , mbetet e hapur.⁹⁰

I. **Problemi i refugjatëve sirianë-** konflikti më Sirinë dhe ceshtja e refugjatëve sirianë, është një tjtër temë kyce për Turqinë, që e ka penalizuar atë në marrëdhënien me BE duke marrë vëmendje më të madhe sesa vetë qëllimi që ka Turqia ndaj Bashkimit Evropian. Në vitin 1997, Turqia dhe Siria ishin në prag lufte, në një kohë kur Turqia ishin përkrahje për armikun kryesor të Sirisë, Izraelin. Ky konflikt kishte të bënte me çështjen e kufinjve dhe lëvizjen e refugjatëve sirianë drejt Evropës. Në vitet e mëvonshme, ky konflikt erdhi drejt rënies, pasi Turqia ndërmjetësoi në konfliktin Siriano-Izrael, por sërish tensionet nuk janë sosur. Turqia dhe Siria janë dy shtete të rëndësishme në Lindjen e Mesme dhe qëndrimet e ndryshme që ka mbajtur Turqia, kanë ndikuar si në politikën e brëndshme dhe në të jashtme. Tensioni midis Turqisë dhe Sirisë u normalizua pas Marrëveshjes së Adanës në vitin 1998, kur Bashar Al-Asad erdhi në pushtet në Siri dhe u përmirësuan me tepër në vitin 2009 me heqjen e vizave.⁹¹

IV. **Pozita gjeografike-** Turqia ka një pozitë unike gjeografike, e cila e ka lejuar atë të ketë lidhje të jashtme nga të gjitha anët. Ajo shtrihet kryesisht në Azinë e Vogel dhe një pjesë e vogël në Gadishullin Ballkanik të Evropës. Kufizohet me Greqinë në perëndim dhe me Bullgarinë në veriperëndim, me Gjeorgjinë në verilindje, me Armeninë, Azërbaixhanin dhe Iranin në lindje, me Irakun në juglindje dhe Sirinë në jug. Në perëndim lagët nga deti Egje, në veri nga deti i Zi, në jug në detin Mesdhe, ndërsa Bosfori, deti Marmara dhe Dardanelët ndajnë Evropën dhe Azinë. Ky pozicion e ka bërë Turqinë të jetë në qëndër të zhvillimeve historikë. Kjo pozitë

⁹⁰ <https://www.dw.com/sq/athin%C3%AB-ankara-bisedime-n%C3%AB-stamboll-p%C3%AB-konfliktin-n%C3%AB-egje/a-56331983> (10.02.2022)

⁹¹ <https://www.crisisgroup.org/europe-central-asia/western-europemediterranean/turkey/248-turkeys-syrian-refugees-defusing-metropolitan-tensions> (18.02.2022)

gjeografike është një arsye shumë e fortë sipas studiuesve të marrëdhënies Turqi-BE, që Bashkimi Evropian të përdorë anëtarësimin e privilegjuar ndaj saj dhe jo anëtarësimin e plotë. Me anë të tij Bashkimi Evropian siguron shkëmbimin e ekonomisë, marrëdhënie diplomatike të ndërsjella dhe shmang problemet e Lindjes së Mesme në Evropë. Anëtarësimi i Turqisë në BE, do të sillte pranë BE konfliktet e Iranit, Irakut dhe Sirisë, evropa do të zgjerohej në Azi dhe problemet e Azisë do ishin të kushtueshme për shtetet evropiane.

V. Numri i lartë i popullsisë dhe besimi muslyman- studiuesit e marrëdhënies Turqi-BE kanë dhënë si arsye për mosanëtarësimin e Turqisë faktin që Turqia karakterizohet nga një popullsi shumë e madhe, pjesa me e madhe e të cilës është e besimit muslyman. Shumicën e rasteve shtetet katolike evropiane kanë votuar kundër anëtarësimit të saj dhe kjo hedh pikëpyetje nëse evropa e dëshiron vërtet anëtarësimin e një shteti muslyman. Numri i lartë i popullsisë së Turqisë ka ngjallur frikë të shtetet evropiane anëtarë në BE, si Franca, Gjermania, Italia etj, të cilat Turqinë e shohin si një kërcënim për pozicionin e tyre në Bashkimin Evropian. Gjithashtu shtetet evropiane e shohin Turqinë si një vënd me kulturë jo të ngjashme evropiane, cka e bën të papërshtatshme anëtarësimin e një vëndi që nuk i përket kulturës evropiane. Nga ana tjetër, duke parë që tashmë edhe vendet e mëdha të BE, përfshijnë një numër të lartë të popullsisë muslymane, ky mendim mbi besimin mund të mos zërë një vënd të rëndësishëm në anëtarësimin e Turqisë.

VI. Qeverisja autokratike dhe sistemi ligjor- Për sa kohë BE ka përballë një shtet autoritar, negociatat për anëtarësim janë thjesht të panevojshme për tu menduar. Me ardhjen në pushtet të Erdogan, u besua së kauza me të cilën ai kishte ardhur, pra krijimi i një Turqie më të hapur, për të siguruar plotësimin e kriterëve të Kopenhagës. Në fakt, mënyra e qeverisjes autoritare nuk ndryshoi. Me disa ndryshime të vogla në kodin ligjor dhe administratë, mënyra e udhëheqjes mbetet e njëjtë. Një qeverisje e tillë, ku kundërshtarët politikë përndiqen, kontrollohet cdo institucion nga një udhëheqës, duke shkelur në këtë mënyrë kriterin e demokracisë.

VII. Demokracia e pakonsoliduar dhe liria e medias- Demokracia e Turqisë është në krizë prej shumë vitesh dhe vazhdon të jetë akoma. Shumë njerëz të punësuar në institucione të shtetit dhe policë janë akuzuar për korrupsion, ndërsa gazetarët përndiqen penalisht për raportime kundër shtetit. Gjithashtu janë marrë disa masa që ndalon lirinë e shtypit dhe tubimet, një nga ato është vendimi që mori Erdogan për pezullim nga puna dhe përndjekje penale ndaj Hasan Cemal dhe Nuray Mert, të cilët komentuan negativisht për qeverinë Erdogan. Media në Turqi kontrollohet nga qeverisja aktualë, e cila fsheh ngjarjet e vërteta dhe publikon lajme false në publik. Kjo teknikë e përdorur është krejtësisht e kundërt me parimet e demokracisë, e cila është baza për Bashkimin Evropian dhe në një vënd ku nuk mund të flitet për demokraci, nuk mund të diskutohet për një anëtarësim.⁹²

KONKLUZIONE

Turqia është i vetmi shtet, që qëndron mbi 50 vjet në dyert e Unionit, në pritje për anëtarësim. Kjo pritje kaq e gjatë e Turqisë, si asnjë vënd tjetër, u shoqërua me një histori dinamike dhe të ftohtë njekohësisht. Anëtarësimi i Turqisë në Bashkimin Evropian ka avantazhet dhe disavantazhet e saj edhe pse studiuesit politikë e kanë parë gjithmonë me dyshim një antarësim të Turqisë. Turqia karakterizohet nga një sipërfaqe e madhe territoriale duke u shtrirë në pjesën Evropiane dhe asaj Aziatike, por ky pozicion e bën Turqinë, qendër konfliktesh mes Evropës dhe Azisë.

Marrëdhënia Turqi-BE, është mjaft komplekse, herë e distancuar dhe herë bashkëpunuese. Në disa momente të historisë së tyre, Turqia ka treguar gadishmëri për të ndërmarrë përgjegjësinë e anëtarësimit dhe herë është

⁹² https://freedomhouse.org/sites/default/files/2020-02/SR_Corruption_Media_Power_Turkey_PDF.pdf (18.02.2022)

tërhequr për të vepruar sipas politikës së saj. Anëtarësimi i privilegjuar, i përdorur nga Bashkimi Evropian ndaj Turqisë, do ishte zgjidhja e vetmm për të ruajtur raporte të qëndrueshme, duke analizuar problemet që e rrethojnë Turqinë. Në fund të fundit, Turqia karakterizohet nga një ekonomi shumë ë zhvilluar dhe në këtë aspekt, ajo nuk ka nevojë për mbështetjen e BE-së. Anëtarësimi i Turqisë në BE do të nënkuptonte probleme të tjera për Unionin, do të trazonte institucionet e tij dhe do të rrezikonte ndoshta të ardhmen e shteteve eksistuese në Union sepse konfliktet e Iranit, Irakut, Sirisë, do të ishin kërcënim për sigurinë e popujve evropianë.

Problem në kohëzgjatjen e marrëdhënies së tyre, ka qënë qëndrimi i të dyjave ndaj njëra-tjetrës. BE duhet të kuptojë rëndësinë e partneritetit me Turqinë, ndërsa Turqia duhet të kuptojë dhe të pranojë qellimet e BE-së, ku përfshihen siguria, stabiliteti dhe partneriteti me vendët anëtare. Rruga drejt Brukselit kalon nëpër Berlin, Paris dhe në të gjitha kryeqytetet e vëndëve anëtare të BE.⁹³

BIBLIOGRAFIA

- Alanur Cavlin “Syrian Rëfugëes in Turkëy”, London, 2020
- Donjeta Elshani “Bashkimi Evropian dhe Turqia”, UBT Knowledge Center, 2019
- Rebecca Bryant, Christalla Yakinthou “Cypriot Perceptions of Turkey”, Stamboll, 2012
- Susan Corke, Andrew Finkel, David J. Kramer, Carla Robbins, Nate Schenkan “Democracy in Crisis: Corruption, Media and Power in Turkey” Freedom House, New York, 2019
- <http://turkiyeavrupavakfi.org/history-of-turkey-eu-relations/?lang=en>
- <https://eu.boell.org/en/2017/05/02/turkey-eu-relations-past-present-and-future>

⁹³ <https://eu.boell.org/en/2017/05/02/turkey-eu-relations-past-present-and-future> (25.02.2022)

- <https://www.dw.com/sq/athin%C3%AB-ankara-bisedime-n%C3%AB-stamboll-p%C3%ABr-konfliktin-n%C3%AB-egje/a-56331983>
- <https://www.crisisgroup.org/europe-central-asia/western-europemediterranean/turkey/248-turkeys-syrian-refugees-defusing-metropolitan-tensions>
- https://parstoday.com/sq/news/uncategorised-i7507-arrihet_marr%C3%ABveshja_be_turqi_n%C3%AB_lidhje_me_refugjat%C3%ABt
- https://eur-lex.europa.eu/summary/glossary/accession_criteria_copenhagen.html
- <https://carnegieeurope.eu/2022/01/26/new-way-forward-for-eu-turkey-relations-pub-86264>

COMMUNICATION TECHNIQUES IN THE RECOGNITION AND REASSESSMENT OF CULTURAL HERITAGE

PhD. Dhurata LAMÇJA

Abstract

A culturally sensitive curriculum is best suited to a multicultural society. Schools that recognize the variety of their student body appreciate the value of developing cultural understanding. Teachers who want to create cultural awareness in their classrooms should actively show their pupils that they care about their cultural, emotional, and intellectual requirements. To that end, there are various tactics you may employ in order to develop trusted connections with different kids. Anthropologists and biologists define culture as the combination of characteristics that distinguishes one group from another. There are two options: either fierce competition between distinct cultures or an evolutionary growth spiral in which traits and innovative impulses are readily shared between otherwise distinctly different cultures. As a result, new knowledge would be accumulated. Education is defined as "the tool for both the whole development of the human individual and that person's engagement in social life."⁶ It may happen at any age, thanks to the acts of multiple institutions such as family, community, and the workplace. It can also happen through engagement with nature, especially when that interaction is socially and culturally defined. Despite these numerous influences, the school remains the most visible educational institution, and its role is critical to the evolution of society. It strives to enhance learners' potential through knowledge transfer and the development of competencies, attitudes, and values that will prepare them for

life in society. As a result of this paper there have historically been two ways of understanding human culture, cultural creation, and cultural heritage: as an indivisible complementing whole, the outcome of social actions, or merely as a matter for the individual, ultimately bound by human nature. The aim of the paper is to examine the importance of cultural heritage and its adoption in the curriculum of education.

Keywords: *cultural, heritage, education, teachers, communication, techniques*

1. Introduction

A culturally sensitive curriculum is best suited to a multicultural society. Schools that recognize the variety of their student body appreciate the value of developing cultural understanding. Teachers who want to create cultural awareness in their classrooms should actively show their pupils that they care about their cultural, emotional, and intellectual requirements. To that end, there are various tactics you may employ in order to develop trusted connections with different kids. The definition of culture is and has always been a contentious issue. Sociologists have been busy in recent decades distinguishing between culture, the unruly wild creative brilliance, and civilization, the ordered predictable often smart mediocrity. Historians of all stripes have been less inclined to distinguish culture and civilization, instead emphasizing their fundamental interconnectedness.

Furthermore, we have seen an offensive by evolutionary biologists and evolutionary psychologists in recent decades, who appear to claim that cultural production and, by extension, cultural heritage are limited by the capacity of what human genes, cells, and brains may allow (Rose & Rose, 2013). Anthropologists and biologists define culture as the combination of characteristics that distinguishes one group from another. There are two options: either fierce competition between distinct cultures or an evolutionary growth spiral in which traits and innovative impulses are readily shared between otherwise distinctly different cultures. As a result, new knowledge would be accumulated. In recent years, there has been a substantial increase in the inclination to regard people as having culturally defined identities rather than

identities that are the result of individual accomplishments. Individual identity is permitted because of collective commitment rather than individual views and deeds. The emergence of nationalism and the nation-state is commonly associated with modern identity. Toward the close of the nineteenth century, the new desire to execute unified policies meant that kings stopped intervening in politics and focused entirely on erecting national monuments to themselves. The legal culture was brought into focus by enlightenment philosophy, and legal reforms of the twentieth century were inspired by the enlightenment and the legal, political, and economic visions of the 21st century (Hajjaj, 2022).

1. Incorporating cultural awareness into classroom instruction

Show an interest in your students' ethnic backgrounds. Encourage your pupils to explore and share facts about their cultural heritage in order to build trust with their classmates. Distinctions in traditions, beliefs, and social practices should be examined and celebrated. It is worth noting that this task assists students in realizing that their beliefs and traditions are part of a culture as well, which is a necessary step toward developing a truly culturally responsive classroom. Take the time to learn how to pronounce student names correctly and express interest in the etymology of interesting and diverse names (Coggins & Campbell, 2008).

Switch from instructor to facilitator in the classroom. Another crucial prerequisite for developing a caring atmosphere for students is to narrow the power gap between the instructor and the pupils. Students in an authoritarian classroom may occasionally engage in bad conduct as a consequence of a perceived feeling of social injustice; in a culturally diverse classroom, the teacher, therefore, works more as a facilitator than an educator. Giving students surveys about what they find interesting or significant gives them a degree of control over what they study and increases their intrinsic motivation and connection to the topic. Allowing pupils to bring their own reading material into class and present it to the class gives them a chance to interact with and share stories, thoughts, and ideas that are important to their cultural and social perspectives (Frank, 2013).

Maintain a high level of attention to linguistic issues. Students who are not natural English speakers frequently feel ostracized, disoriented, and forced to abandon their native language in favor of English in traditional courses. Diversity of language is celebrated in a culturally responsive classroom, and instructional materials provided to non-native speakers are tailored to their level of English fluency. Accompanying materials in the student's primary language should be provided, and the student should be encouraged to master English (Shemshadsara, 2012).

Maintain high standards for student achievement. Given that culturally responsive education is a student-centered concept, it should come as no surprise that achievement standards are set and allocated to each student individually. Students are not lavishly praised for minor efforts, but they are praised in proportion to their achievements. If a student is not completing her work, one should engage her positively and help guide her toward explaining how to complete the initial steps that need to be completed to complete a given assignment or task (Dema & Moeller, 2012).

Incorporate self-testing procedures. Reframing the notion of testing is another effective way for encouraging students to become active participants in their learning. While traditional classrooms typically associate testing with grades (and thus stress), in a culturally responsive classroom, frequent non-graded tests can be used to provide progress checks and ensure that students do not fall behind on required material. Teaching students to self-test while learning new information will help them remember and apply what they've learned in class, as well as recognize when they need to study a topic in greater depth on their own (Walters, Garii & Walters, 2009).

Maintain an "inclusive" curriculum that is sensitive to variances. A culturally responsive curriculum is both inclusive and recognizes students' individual differences. It guarantees that all students are included in all elements of the school. A culturally responsive curriculum also encourages instructors to learn and recognize each student's non-school cultural life and history, and it provides a way for them to incorporate this knowledge into the curriculum, fostering inclusiveness. Schools must educate all students on how to integrate cultural diversity into their knowledge base in order to help them achieve

personal and professional success in a varied society. A culturally responsive curriculum assists children from diverse ethnic/racial backgrounds in developing a sense of self as individuals who proudly identify with their particular cultural group. as proudly identify with their specific cultural group (Arbour, Kaspar & Teall, 2015).

2. Connection of Culture and Education

Education is often defined as the tool for both the whole development of the human individual and that person's engagement in social life. It may happen at any age, thanks to the acts of multiple institutions such as family, community, and the workplace. It can also happen through engagement with nature, especially when that interaction is socially and culturally defined. Despite these numerous influences, the school remains the most visible educational institution, and its role is critical to the evolution of society. It strives to enhance learners' potential through knowledge transfer and the development of competencies, attitudes, and values that will prepare them for life in society (UNESCO, 1992).

Culture and education are fundamentally connected. Culture influences our frames of reference, our methods of thinking and behaving, our beliefs, and even our moods, hence it shapes educational material, operational modes, and situations. All educational actors - teachers and students, curriculum creators, policymakers, and community members - incorporate their cultural ideas and goals into what is taught and how it is communicated. Education, on the other hand, is critical to cultural survival. Culture, as a collective and historical phenomenon, cannot exist without continuous transmission and enrichment through education, and organized education frequently aims to achieve this very goal. Intercultural education must be an afterthought to the usual curriculum (UNESCO, 2003). It must address the whole learning environment, as well as other aspects of educational processes such as school life and decision-making, teacher education and training, curriculum, instructional languages, teaching techniques and student interactions, and learning materials. This may be accomplished by including diverse viewpoints and voices. One major example is the establishment of an inclusive curriculum that includes learning about the languages, history, and cultures of non-dominant groups in society. Another

critical component of effective Intercultural Education is the question of language(s) of instruction and language teaching, which is discussed in the UNESCO Education Position Paper "*Education in a Multilingual World.*" (Mortimore, 1998:23).

Intercultural Education's distinct goals can be described under the categories of the four pillars of education, as identified by the International Commission on Education for the Twenty-First Century. According to the Commission's conclusions, education should be largely founded on the pillars of (Delors, 1998).

1. Gaining knowledge by combining sufficiently wide general knowledge with the chance to study in-depth on a small number of tasks. A general education brings a person into contact with other languages and areas of knowledge, and... makes communication possible; these general education outcomes represent some of the fundamental skills to be transmitted through intercultural education.
2. Learning to do in order to acquire not only an occupational skill but, more broadly, the competence to deal with a wide range of situations and work in teams. Learning to do also includes the acquisition of necessary competencies that allow an individual to find a place in society on a national and international scale.
3. Learning to coexist by developing an understanding of other people and an appreciation of interdependence - carrying out joint projects and learning to manage conflicts - in a spirit of respect for the values of pluralism, mutual understanding, peace and cultural diversity.
4. Learning to be, in order to better develop one's personality and be able to act with more autonomy, judgment, and personal responsibility. In that way, education must not overlook any component of a person's potential, such as cultural potential, and it must be built on the right to disagree. These values enhance the learner's feeling of identity and personal purpose while also benefiting their cognitive capacity. In summary, the learner must gain information, skills, and attitudes that foster a sense of solidarity and cooperation among various individuals and groups in society.

Conclusion

To summarize, there have historically been two ways of understanding human culture, cultural creation, and cultural heritage: as an indivisible complementing whole, the outcome of social actions, or merely as a matter for the individual, ultimately bound by human nature. This duality is also given to what determines identity: whether identities are culturally established or the result of individual efforts has been contested throughout history. However, as previously said, culture and cultural heritage can vary and have quite distinct consequences and effects on identity formation. Cultural markers are depicted in paintings, literature, and cinema, and they help to solidify notions of the past as present, which may remain controversial. Through the utilization of cultural legacy, ideologies such as nationalism form and distort identities.

References

1. Walters, L. M., Garii, B., & Walters, T. (2009). Learning globally, teaching locally: incorporating international exchange and intercultural learning into pre-service teacher training. *Intercultural Education*, 20(sup1), S151-S158.
2. Delors, J. (1998). *Learning: The treasure within*. Unesco.
3. Mortimore, P. (1998). Learning: the treasure within report to UNESCO of the international commission on education for the twenty-first century. Jacques Delors, chairman: UNESCO Publishing, Paris, 1996.
4. UNESCO (1992) : International Conference on Education, 43rd Session, The Contribution of Education to Cultural Development, p.4, §8
5. UNESCO (2003) : Education in a Multilingual World, UNESCO Education Position Paper. It discusses the use of mother tongue (or first language) as language of instruction for initial instruction and literacy, the importance of bilingual or multilingual education (i.e. the use of more than one language of instruction), and language teaching with a strong cultural component.

6. Coggins, P., & Campbell, S. D. (2008). Using cultural competence to close the achievement gap. *The Journal of Pan African Studies*, 2(4), 44-59.
7. Dema, O., & Moeller, A. K. (2012). Teaching culture in the 21st century language classroom.
8. Frank, J. (2013). Raising Cultural Awareness in the English Language Classroom. In *English teaching forum* (Vol. 51, No. 4, p. 2). US Department of State. Bureau of Educational and Cultural Affairs, Office of English Language Programs, SA-5, 2200 C Street NW 4th Floor, Washington, DC 20037.
9. Arbour, M., Kaspar, R. W., & Teall, A. M. (2015). Strategies to promote cultural competence in distance education. *Journal of Transcultural Nursing*, 26(4), 436-440.
10. Shemshadsara, Z. G. (2012). Developing cultural awareness in foreign language teaching. *English Language Teaching*, 5(3), 95-99.
11. Rose, N. (2013). The human sciences in a biological age. *Theory, culture & society*, 30(1), 3-34.
12. Hajjaj, B. (2022). Nationalism and national identity formation in Bangladesh: A colonial legacy behind the clash of language and religion. *Asian Journal of Comparative Politics*, 7(3), 435-448.

SFIDAT E MAQEDONISË TË VERIUT NË POLITIKËN E JASHTME (A është gati RMV për një “*Marrëveshje të dytë të Prespës*” me Bullgarinë?)

PhD. Senada Laçka

International University of Struga (s.lacka@eust.edu.mk)

Abstrakt

Duke pasur parasysh faktin që Republika e Maqedonisë të Veriut sapo ka përfunduar një konflikt diplomatik 27 vjeçar me Greqinë duke e përmbyllur me sukses kontestin nëpërmjet Marrëveshjes të Prespës, sfida e rradhës me Bullgarinë në pragun e realizimit të procesit e Berlinit, konsiderohet një sfidë e vështirë për të cilën Maqedonia e Veriut do të duhet të deklarohej nëse do të jetë gati për një “*Marrëveshje të re të Prespës*” me Bullgarinë ose palët do të mbështeten në Marrëveshjen për miqësi të mirë me shtetin Bullgar, të lidhur në 1 gusht 2017. Me përfundimin e Samitit të Sofijas në 10 dhjetor të vitit 2020 , i realizuar për herë të parë nga një shtet anëtar i BE-së, Bullgaria dhe një shtet kandidat për antarësim në BE- Maqedonia e Veriut, si një moment historik dhe për vetë faktin që dy shtetet fqinje ndodhen para një sfide të rëndësishme politike, historike dhe diplomatike që mund të bllokojë më tej rrugën e integritetit të Maqedonisë të Veriut në BE.

Duke analizuar vështrimin historik të marrëdhëneve bilaterale mes palëve, ky punim shkencor do të vendos theksin mbi çështjet e pazgjidhura dhe sfidat dy shteteve si pengesë serioze në hapjen e negociatave për antarësim të Maqedonisë të Veriut në BE duke u mbështetur në Marrëveshjen për Fqinjësi të mirë mes palës bullgare dhe asaj maqedonase.

Fjalë Kyçe- Marrëdhënie bilaterale, Maqedonia e Veriut, Bullgaria, BE, Marrëveshja për fqinjësi të mirë.

Hyrje

“Vetëm një shoqëri që mban mend të kaluarën, është një shoqëri e aftë për të ndryshuar”

Jann Assmann

Matja e nivelit të civilizimit të një shteti nacional është marrëdhënja e të njëjtit në raport me pakicat. Shtetet ballkanike janë krijuar si trashëgimtare në një historie të komplikuar. Pikërisht, pjesa e historisë për të cilën shumë shtete ballkanike janë krenare, është një histori e mbretërve që në vetëvete kanë gërshetuar shumë popuj, kultura dhe religjione. Këto mbretër kanë lënë trashëgimi një multikulturalizëm të vërtetë të popujve dhe kulturave, që në kontestin modern, në shtetet e sotme, duhet të ishte një pasuri dhe jo një rrezik. Dëshmi e një natyre të tillë është multietniciteti në rajonin e Maqedonisë të Veriut. Por, shtrohet pyetja, a është e mundur, duke pasur parasysh historinë e përbashkët të shteteve ballkanike, shtetet e saj fqinje të konsiderohen etnikisht të pastra? Si mund të ketë pakica kombëtare që jetojnë dhe veprojnë në RMV, kurse në shtetet fqinje të mos njihen dhe “ekzistojnë” pakicat?!

Themelet e Evropës si një project paqësor në BE ndërtohen mbi një kujtesë kulturore të Luftës të Dytë botërore që në kontekstin evropian do të thotë përballje kritike të çdo populli lidhur me pjesëmarrjen e vet në të. Matja e identitetit evropian të çdo populli lidhet me mënyrën se si ballafaqohen ato me të kaluarën.

Shtetet ballkanike që deklarohen si proevropiane ende konsiderohen si “geto nazionale” duke qënë të autohipnotizuar më narativin nacional personal.

Ato nuk janë ende në gjendje të futen në një dialog të emancipuar evropian me fqinjët e tyre lidhur me të kaluarën, në të cilën, në periudha të ndryshme kohore, historitë e tyre janë gërshetuar.

Duke pasur parasysh faktin se shtetet ballkanike kanë një identitet jo të sigurtë dhe jostabil që vjen si rezultat i mbështetjes të narativit nacional në mitologjitë historike, një pjesë e konsiderueshme e tyre me një revizionizëm historic po tentojnë të kultivohen si viktimë të përhershme të historisë duke shprehur një kompleks inferioriteti në raport me kulturat e mëdha evropiane dhe këtë e kompenzojnë me mitologjinë historike. Ballkani vazhdon të mbetet një garë e pamëshirshme e narrativit historik.

Të dyja shtetet ballkanike me qasje evropiane, në njërën anë Bullgaria si anëtare në BE dhe në anën tjetër Maqedonia e Veriut, si një shtet kandidat që në vitin 2005⁹⁴, duke qënë të vetëdijshëm për rëndësinë që ka perspektiva evropiane si garantues për stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit zotohen në deklaratat e tyre politike për tu angazhuar në zbatimin e kornizës juridike për bashkëpunim në më shumë fusha të interesit të ndërsjelltë por pengesat e hasura në punën e Komisionit të përbashkët multidiciplinor të ekspertëve për çështjet historike dhe arsimore pa rezultate serioze me dy palëve shtetërore.

Sipas mediave tradicionale maqedonase, shteti bullgar paraqitet si “*fqiu i keq*” dhe një armir tradicional i Maqedonisë dhe popullit maqedonas që në një moment vendimtar për RMV sa i përket eurointegritet, ndoqi shembullin e Greqisë. Temat të cilat shërbejnë për të diskredituar dhe demonizuar Bullgarinë janë nga më të ndryshmet, nga ato historike deri te ato politike, por edhe të natyrës pragmatike. Një ndër temat që prekin diskursin publik, janë të natyrës simbolike dhe emotive, lidhur me përvetësimin nga Bullgaria e personaliteteve të rëndësishme historike siç janë Kiril i Metodij ose Goce Delçevi.

Gjithsesi, duhet të kemi parasysh që dhe nga ana bullgare, ka një numër të konsiderueshëm intelektualësh, gazetarë dhe politikanë, e sidomos në vendet

⁹⁴ Maqedonia e Veriut është shteti i parë ballkanik që ka nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim Asocim në vitin 2005

e tjera evropiane, që ky qëndrim bullgar kundrejt Maqedonisë shihet si një keqpërdorim i antarësimit në BE, veprim iracional por dhe në kundërshtim të plotë me angazhimin për respektim të vlerave dhe procedurave evropiane.

Disa parti të tjera djathtiste në BE mund dhe të jenë treguar të kuptueshëm lidhur me këtë “*heroizëm*” bullgar para zgjedhjeve në Bullgari. Tani për tani, për fat të keq, duket se kërkesa për të detyruar vendin të njohë “*të vërtetën historike në lidhje me rrënjët bullgare të kombit maqedonas*” është e vetmja gjë rreth së cilës ekziston marrëveshja kombëtare në Bullgari dhe rreth së cilës ndërtohet uniteti kombëtar bullgar në kushtet e një konflikti të fortë politik.

1. Vështrim historik në marrëdhënjet bilaterale mes Maqedonisë dhe Bullgarisë (1941 e deri më sot)

*“Për fat të keq, gjysëm shekulli më vonë, edhe më tej gati askush nuk është duke qeshur”*⁹⁵ do ishte në thënje që më së miri përshkruan gjendjen politike dhe diplomatike mes dy shteteve fqinje, Maqedonisë dhe Bullgarisë, pas gjysëm shekulli.

Megjithëse shumë qytetarë në Maqedoninë e Veriut, përfshirë edhe qytetarët bullgarë, mund të befasohen këto ditë nga intensiteti dhe përmbajtja e pikëpamjeve të politikanëve dhe historianëve bullgarë për çështje të hapura historike, ata nuk janë deklarata dhe aq të panjohura për historianët dhe as nuk devijojnë nga mesazhet që vijnë nga Sofja zyrtare në Shkup në 60 vitet e kaluara.

Pas disa trazirave në gjysmën e dytë të viteve 1940 dhe 1950, politika “*e re*” bullgare ndaj Maqedonisë mori rrjedhën e tanishme me ardhjen në pushtet të Todor Zhivkov në gjysmën e dytë të viteve 1950. Pas takimit zyrtar mes Josip Broz Tito dhe Todor Zhivkov, Kryetari Zhivkov ka deklaruar qëndrimin e tij në lidhje me çështjen maqedonase: “Partia Komuniste Bullgare (BKP) njeh” krijimin “e” *ndërgjegjes kombëtare maqedonase* “si një” *realitet objektiv*”, por i

⁹⁵ Çavdar Marinov, „*Македонското прашање од 1944 до денес*“, 2014.

kufizuar në Maqedoninë Jugosllave. Shfaqja e kësaj vetëdije ishte gjithashtu "e datuar": ajo u shfaq pas Luftës së Dytë Botërore ".⁹⁶ Këto qëndrime janë pranuar si drejtime të reja të politikave shtetërore bullgare lidhur me çështjen maqedonase. "*Nuk do të ishte marksiste nga ana e Bullgarëve,*" ka deklaruar, në mes të tjerash Zhivkov, "*të hiqnin dorë nga historia e tyre*", lidhur me figura si Kirili dhe Metodij, dhe vëllezërit Dimitar dhe Konstandin Miladinov. " Sipas Zhivkov, gjuha maqedonase është vetëm "*një fjalim që i përket fjalimeve tona perëndimore, një dialekt*". Kjo do të ishte një formulë kompromisi me Jugosllavinë duke pranuar ekzistencën e republikës maqedonase në kuadër të Jugosllavisë.

Në maj 1967, u zhvillua një takim i ri midis dy udhëheqësve dhe këtë herë, Zhivkov, sulmoi botimet historiografike të Shkupit duke iu referuar "*skllavërisë Bullgare*" të pësuar nga Maqedonasit gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai sugjeroi që në atë kohë, "*fashistët bullgarë*" të vrisnin shumë më pak njerëz në Maqedoni sesa në brendësi të vetë Bullgarisë. "*Ndërgjegjja kombëtare*" maqedonase po zhvillohet mbi një bazë "false" dhe "anti-bullgare", ka deklaruar Zhivkov. Crvenkovski, si përfaqësues i shtetit maqedonas, u përgjigjet tezave të tilla duke mbrojtur identitetin maqedonas: "*Udhëheqja jonë nuk mund t'u thotë njerëzve të saj se para vitit 1945 ne ishim bullgarë dhe se pastaj u bëmë maqedonas*". "Kjo ndjenjë filloi të zhvillohej në mes të shekullit të kaluar," tha Crvenkovski, duke ofruar një kompromis: "*Ndoshta disa gjëra nuk kanë nevojë të zgjidhen plotësisht. Unë nuk jam kundër përfshirjes së Samuelit dhe Paisius në historinë tuaj, por ne duhet të përfshijmë disa personalitete në historinë tonë*". Ata ndahen "në mënyrë miqësore". Zhivkov i sugjeroi Crvenkovskit të shkonte në zonën e Pirinit për t'u siguruar që nuk kishte maqedonas. Nga ana tjetër, Crvenkovski e ftoi Zhivkovin të kërkonte bullgarë në Republikën Socialiste të Maqedonisë.

Është e rëndësishme të theksohet se në prag të këtij takimi, në Prill 1967, Byroja Politike e Komitetit Qendror të BKP-së formuloi një qëndrim "*Marksist-Leninist*" për çështjen e Maqedonisë që synonte një pozicion më të fortë për mungesën e legjitimitetit historik dhe, në përgjithësi, për

⁹⁶ Po aty

“mosekzistencën” e identitetit kombëtar maqedonas, për të kthyer në favor të saj tendencat e identitetit në Maqedoninë Jugosllave. Një vit më vonë, Instituti për histori në kuadër të Akademisë të shkencave në Sofia, në një broshurë i ka formuluar qëndrimet e saj, të cilat, edhe sot e kësaj dite konsiderohen si interpretim kanonik historiografik në Bullgari.⁹⁷

Në 9 nëntor 1970, në Sofija u realizua takimi i radhës mes përfaqësuesve jugoslloven dhe atyre bullgarë ku tema kryesore vazhdonte të mbetej “*çështja maqedonase*”. Me argumente të historisë mesjetare, ana bullgare vazhdonte me mbrojtjen e tezës se në fakt, maqedonasit janë realisht bullgarë, për çka, përfaqësuesit jugoslloven kishin qëndrimin që pas 50 vitesh, ky diskutim do të tingëllonte qesharak.

Pas shpërbërjes të Jugosllavisë, Bullgaria ka qënë vazhdimisht në përpjekje për të ndikuar në kulturën dhe narativin nacional në RMV që me njohjen e pavarësisë të ish shtetit jugosllav, që Bullgaria e bëri e para dhe vazhdimisht e potencon këtë fakt. Në atë kuptim, kredia fillestare dhënë nga Bullgaria për njohje të pakushtëzuar të shtetit të pavarur maqedonas në vitin 1992 ishte një investim në favor të marrëdhënieve të mira midis dy vendeve, por e cila, për fat të keq, nuk kishte reciprocitetin e duhur.

Por qëllimi kryesor i politikës bullgare ishte të ndante Maqedoninë nga Serbia: elitat e reja politike në Maqedoni pritej të kuptonin “*falsifikimin*” e kombit dhe gjuhës së tyre, dhe kështu Maqedonia të “*ribullgarizohej*”.

Ish Presidenti Bullgar dhe udhëheqësi i Partisë Socialiste Bullgare Georgi Parvanov në fund të viteve 1990, i cili, riafirmoi këto qëndrime duke u propozuar maqedonasve që të pranojnë faktin se ata kanë një “*histori të përbashkët*” me bullgarët, ndërsa Bullgaria nga ana tjetër do ta njihte “*realitetit aktual*” dhe do të pranonte ekzistencën e shtetit të pavarur të Republikës së Maqedonisë. Marrëdhëniet bilaterale mes Republikës të Maqedonisë (të Veriut) dhe Republikës të Bullgarisë janë vendosur në datë 31 dhjetor 1993.

⁹⁷ Алфа TV, 21.05.2013

Prej atëherë, një Deklaratë e Fqinjësisë së Mirë, Miqësisë dhe Bashkëpunimit u nënshkrua midis Maqedonisë dhe Bullgarisë në vitin 1999, mbështetur nga nënshkrimi i dy memorandumëve, në vitin 2008 dhe 2011. Këto dokumente bilaterale kishin rëndësinë dhe rolin e tyre për anëtarësimin e Bullgarisë në NATO dhe BE. Ky kushtëzim me nënshkrimin e një marrëveshjeje të tillë Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës midis Maqedonisë dhe Greqisë më 17 qershor 2018, u hap mundësia, në një kontekst të ri historik, për të parë thelbin dhe domethënien e një marrëveshjeje të tillë midis Maqedonisë dhe Bullgarisë, por edhe për të identifikuar dhe kapërcyer të gjitha të mundshme kurthet historike që mund të shkaktojë kjo marrëveshje. Pas disa "tensioneve" dhe marrëveshjeve, marrëveshja u nënshkrua në Shkup më 1 gusht 2017, dhe më vonë, pas debatit dhe mbështetjes së sa më shumë tre qeverive bullgare (Bojko Borisov, Marin Rajkov dhe Plamen Oresharski) dhe pas ratifikimit në maqedonisht në parlamentin bullgar, marrëveshja hyri në fuqi në 15 janar 2018.

Mungesa e gatishmërisë së Bullgarisë për të adresuar në mënyrë kritike të kaluarën e saj në lidhje me marrëdhëniet me Maqedoninë ka ngarkuar marrëdhëniet midis dy kombeve dhe shteteve fqinje për dekada. Edhe më e pakuptueshme dhe konfuze është këmbëngulja që ato të përfshihen në agjendën e realitetit të ri politik maqedonas. Hyrja në thelbin e vetëvendosjes, identitetit, origjinalitetit, mohimit të gjuhës dhe trashëgimisë kulturore, janë shumë të dyshimta, të rrezikshme dhe tregojnë për synime dhe supozime të tjera politike bullgare.

Një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të marrëdhënjeve bullgaro-maqedonase ishte vizita e përfaqësuesve të Qeverisë të Maqedonisë të Veriut në Sofije për nënshkrimin e një sërë memorandumësh për mirëkuptim dhe deklarata për bashkëpunim. Delegacioni maqedonas u prit me nderimet më të larta në vizitën dyditore në Sofije në një ceremoni të mbajtur në 25 janar të vitit 2022 në sheshin "Aleksandër Nevski". Pritja u bë nga ministrat e qeverisë bullgare në krye me Kryeministrin e ri z.Kiril Petkov. Në kuadër të vizitës, u realizuan takime të përbashkëta mes dy qeverive. Sipas programit të vizitës zyrtare, dy kryeministrat e vendeve fqinje vendosën lule te përmendoret e Luftëtarit të Panjohur dhe vëllëzërve të shenjtë Kirili dhe Metodi, më pas u drejtuan në Qendën Kulturore-Informative të Maqedonisë për të shënuar fillimin e

korrespondencës së Agjencisë për Informim për Media të Maqedonisë të Veriut. Në agjendën e ditës të parë të vizitës zyrtare në Sofije ishte dhe vizita e Univeristetit “Shën Klimenti i Ohrit”.

Në mbledhjen e dytë plenare të ministrave, u prezantuan bazat, prioritetet dhe kalendari i aktiviteteve të grupeve të punës. Mbledhja e përzier e qeverive solli si rezultat disa memorandume për mirëkuptim, programe për bashkëpunim dhe marrëveshje: Memorandumi për mirëkuptim dhe bashkëpunim në fushën e bujqësisë, shkencave agrare, rajoneve rurale dhe ekonomisë së ujërave nënshkruan sot ministrat e Bujqësisë së Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë, Ljupčo Nikollovski dhe Ivan Ivanov. Ministri i Ekonomisë në Qeverinë e Maqedonisë së Veriut, Kreshnik Bekteshi dhe ministri për Inovacione dhe Zhvillim i Bullgarisë, Daniel Lorer, nënshkruan Memorandum për mirëkuptim mes Agjencisë për Nxitje të Sipërmarrësisë në Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Agjencisë Ekzekutive për Promovimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme nga Bullgaria. Ministrat për Transport dhe Lidhje të Republikës së Bullgarisë Nikolaj S’bev dhe të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Bllagoj Boçvarski, nënshkruan Memorandum për liberalizimin e transportit të mallrave drejt dhe nga vendet e treta, si dhe deklaratën për uljen e çmimeve të roamingut ndërmjet dy vendeve. Ministrat Boçvarski dhe S’bev nënshkruan edhe Memorandum për zhvillimin e ndërlidhjes hekurudhore Shkup-Sofje përmes krijimit të grupit të përbashkët të punës, me qëllim përshpejtimin e ndërtimit të Korridorit 8 dhe Iniciativës për vendosjen e linjës ajrore Sofje – Shkup.⁹⁸

Pozicioni i qeverisë maqedonase është se e drejta për vetëvendosje është një e drejtë e patjetërsueshme. Identiteti maqedonas dhe gjuha maqedonase janë një fakt dhe nuk duhet të diskutohen, sepse identiteti ynë nuk shkakton asnjë pretendim ndaj askujt, as tani dhe as në të ardhmen. BE vazhdoi me agjendën e paraparë me takimin e GAC (Këshilli i Punëve të Përgjithshme, takimi i Ministrave të Punëve të Jashtme ose Ministrave të BE-së të vendeve anëtare) dhe takimi i Këshillit Evropian, në të cilin u paraqitën edhe një herë argumentet maqedonase si dhe mundësitë për të kapërcyer këtë situatë.

⁹⁸ <https://vlada.mk/node/27532?ln=sq>

Fqinjësia e mirë nuk krijohet në letër, por me gjeste konkrete dhe mendoj se ekziston një bazë shumë e mirë për të pasur marrëdhënie të shkëlqyera midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut. Për më tepër, qëndrimet e palës bullgare në asnjë mënyrë nuk pasqyrojnë realitetin e ri të krijuar me pas 1 janarit 2007, kur Bullgaria iu bashkangjiti BE-së.

Pas Samitit të Sofijas, do të ishte veprim i duhur Bullgaria të pranonte vazhdimin e negociatave të RMV-së me BE-në, dhe debatet, në vend për çështje historike, dy shtetet fqinje të transferohen në bashkëpunim të mirëfilltë në fushën e kulturës, ekonomisë politikës dhe ekologjisë. Të vendosen prioritete të reja dhe iniciativa të përbashkëta mes dy vendeve duke diksutuar për të gjitha çështjet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes që duhet të jetë unik dhe vetëm në frymën dhe standardet e së drejtës ndërkombëtare bashkëkohore dhe përmes qasjeve moderne për zgjidhjen e marrëdhënieve ndërshtetërore bilaterale dhe multilaterale. Një format i tillë i negociatave moderne nuk mund të ketë kushte për të detyruar njërin nga palët të pranojë kërkesa joreale të bëra nga pala tjetër, siç është heqja dorë (tërësisht ose pjesërisht) nga vetëvendosja e njerëzve të saj dhe heqja dorë nga vetë-identifikimi i qytetarëve të saj.

2. Marrëdhënjet bilaterale mes Maqedonisë të Veriut dhe Bullgarisë (arsyet e kontestit bullgaro-maqedonas)

Nëse Adenauer dhe De Gol do kishin filluar rrugëtimin e përbashkët evropian me kanosje dhe bllokime, asnjëherë nuk do kishin arritur një miqësi për tu marrë shembull si ajo gjermano-franceze. Shtrohet pyetja, nëse lidhshipi aktual në shtetin fqinj është i njohur me mënyrën se si janë ndërtuar urat mes popujve fqinje në BE?! Ky duhet të jetë leksioni më i mirë për palën bullgare në njërin anë dhe atë maqedonase në anën tjetër.

Duke pasur parasysh ulje-ngritjet për më shumë se gjysëm shekulli mes dy shteteve ballkanike, Bullgaria, duke bllokuar procesin eurointegruar të Maqedonisë të Veriut drejtë BE-së, ka paraparë tre kushte kryesore (dhe disa parakushte) që mbeten konstante me dekada:

- Pranimi i një “*të vërtete historike*” për preardhjen bullgare të popullit maqedonas dhe gjuhës;⁹⁹
- Heqje dorë nga deklaratat për ekzistimin e pakicës maqedonase në Bullgari;¹⁰⁰dhe
- Riformulimi i mësimdhënjes për “*okupatorin fashist bullgar*” gjatë Luftës të Dytë Botërore.¹⁰¹

Sa i përket qëndrimeve të lidërshiptit bullgar, ka pasur reagime jo vetëm në RMV por dhe në Bullgari, nga intelektualët bullgar, të cilët, në mes të tjerash, lidhur me pretendimet se gjuha maqedonase është një normë gjuhësore e bullgarishtes, intelektualët bullgarë janë të mendimit se “*të gjitha gjuhët e standardizuara në një farë kuptimi janë artificiale, sepse norma letrare gjithmonë ndërhyjnë në dialektet e folura dhe përcakton se cilat elemente të tyre janë*” të sakta “*dhe cilat*” të pasakta”. Për ta, pretendimet në lidhje me datën e lindjes së një kombi dhe gjuhe janë shkencërisht të pa vërtetuara dhe në kundërshtim me arritjet e shkencës historike, si dhe të shkencave shoqërore dhe shkencave humane në përgjithësi.

Për intelektualët bullgarë, termi histori e përbashkët është e pranueshme, por ata kundërshtojnë interpretimet e tij elementare si dhe përdorimin e tij për të impouar një rrëfim të vetëm-në këtë rast, narativin zyrtar bullgar të së kaluarës. Një tjetër problematikë aktuale për më shumë vite mes dy shteteve fqinje është për marrjen e pasaportave bullgare nga shtetasit maqedonas dhe përdoret më shpesh për të kritikuar politikën e shtetit bullgar si asimiluese ose për të diskredituar kategori të caktuara të qytetarëve dhe politikanëve lokalë si jo besnikë ndaj vendit dhe kombit të tyre. Të gjithë artikujt në lidhje me lëshimin e diskutueshëm të pasaportave bullgare për shtetasit maqedonas deklaruan se kjo ishte një çështje “*biznesi*” dhe manipulimi që nuk kishte asnjë lidhje me

⁹⁹ “Ajo vetëvendosje, ai komb që ata kanë krijuar që nga viti 1944, nuk duhet të bazohet në gënjeshtër dhe fushatë anti-bullgare, por në të vërtetën.”-Ekaterina Zaharieva, Ministra për punë të jashtme, 12.10.2020

¹⁰⁰ “Unë personalisht jam shumë i mërzitur nga përfshirja e OMO Ilinden dhe pakicës maqedonase në një rezolutë politike të Parlamentit Evropian”-Bojko Borisov, kryeministri bullgar, 09.10.2020

¹⁰¹ “Festojnë në 11 Tetor një festë shtetërore kundër të ashtuquajturit , nga ana e tyre, “okupator bullgar”-Krasimir Karakaçanov, Ministër i Mbrojtjes, 22.10.2020

ndjenjën kombëtare të atyre që kërkonin shtetësinë bullgare, por që ishin motive thjesht ekonomike dhe fitimprurëse.

Sipas Ministrisë së Drejtësisë në Bullgari, 88,450 shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë pajisur me pasaportë bullgare. Statistikat e Eurostat gjithashtu deklarojnë se në vitin 2008 numri më i madh i shtetasve maqedonas fituan shtetësi në Bullgari - 3,637, pas së cilës numri statistikor u ul ndjeshëm dhe shkonte nga 400 në 200 qytetarë.¹⁰²

17 shtator 1992	Marrëveshje mes Qeverisë të R.Maqedonisë dhe Qeverisë të R.Bullgarisë për hapjen e Konsullatave të përgjithshme në të dyja shtetet
20 tetor 1992	Marrëveshje për bashkëpunim mes Ministrisë për punë të brendshme të R.Maqedonisë dhe Ministrisë për punë të brendshme të R.Bullgarisë
7 qershor 1993	Marrëveshje mes Qeverive të dy shteteve për bashkëpunim ekonomik dhe tregtar
5 qershor 1999	Marrëveshje mes Qeverive të dy shteteve për inicim dhe mbrojtje të dyanshme të investimeve
12 qershor 2007	Protokoll bashkangjitur marrëveshjes mes qeverive të dy shteteve për inicim dhe mbrojtje të dyanshme të investimeve
24 shtator 1997	Marrëveshje mes dy shteteve për mënjanimin e tatimit të dyfishtë në raport me tatimin për të hyrat dhe kapitalit
12 qershor 1999	Marrëveshje mes qeverive të dy shteteve për transportin rrugor ndërkombëtar

¹⁰² <https://ec.europa.eu/eurostat/data/database>

8 qershor 1999	Marrëveshje për transport të rregullt ajror mes qeverisë të R.Maqedonisë dhe R.të Bullgarisë
23 mars 2000	Konventa konsullore mes R.Maqedonisë dhe R. të Bullgarisë
23 qershor 1999	Marrëveshje mes qeverisë të R. Maqedonisë dhe qeverisë të R.të Bullgarisë për lidhjen e rrjeteve hekurudhore mes dy shteteve
15 korrik 2000	Marrëveshje mes qeverive të dy shteteve për bashkëpunim dhe ndihmë reciproke në punët doganore
13 shtator 2000	Marrëveshje mes qeverisë të R.Maqedonisë dhe qeverisë të R.Bullgarisë për hapjen e dy kalimeve të reja kufitare mes dy shteteve
8 mars 2002	Marrëveshje mes qeverive të dy shteteve për mirëmbajtjen, rinovimin dhe vendosjen e vijës kufitare dhe shenjave kufitare në kufirin shtetëror maqedonas-bullgar
8 mars 2002	Marrëveshje mes qeverive të dy shteteve për masat për parandalimin dhe zgjidhjen e incidenteve kufitare në kufirin shtetëror maqedonas-bullgar
7 prill 2002	Marrëveshje për punë juridike në lëndët civile mes R.Maqedonisë dhe R.Shqipërisë
8 mars 2002	Marrëveshje mes Qeverive të dy vendeve për bashkëpunim në fushën e kulturës
8 mars 2002	Marrëveshje mes qeverive të dy shteteve në fushën e arsimit dhe shkencës
7 prill 2002	Marrëveshje për bashkëpunim në fushën e turizmit mes qeverisë të dy shteteve

8 mars 2002	Marrëveshje mes qeverive të dy shteteve për bashkëpunim në fushën e standardizimit, metrologjisë ,akreditimit dhe vlerësimit të konformitetit
23 shkurt 2001	„ Marrëveshje mes qeverive të R.të Maqedonisë dhe R.Bullgarisë për bashkëpunim në fushën e mjekësisë dhe shkencave mjekësore
19 qershor 2002	Marrëveshje mes qeverisë të R.Maqedonisë dhe qeverisë të R. të Bullgarisë për ndërmarjen e personave me qëndrim ilegal
8 mars 2002	Marrëveshja mes qeverive të dy shteteve në pranimin e ndërsjelltë të dokumentave për arsim dhe nivele shkencore
26 shkurt 2002	Marrëveshja mes qeverive të dy shteteve për trajnimin, kualifikimin dhe mbikualifikimin e të punësuarve në MPB-së të R.të Maqedonisë në Insitutin e lartë për përgatitje të oficerëve dhe për veprimtarinë kërkimor-shkencor dhe dhe qendra të tjera arsimore të MPB-së të R.të Maqedonisë
26 shkurt 2003	Marrëveshje mes Qeverisë të R.Maqedonisë dhe Qeverisë të R.Bullgarisë për bashkëpunim në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, tregtisë ilegale me lëndë narkotike, substance psikotrope, migrimin ilegal dhe vepra tjera penale.
1 gusht 2003	Marrëveshje për sigurim social mes R.Maqedonisë dhe R.të Bullgarisë
14 shkurt 2005	Marrëveshje mes qeverisë të R.Maqedonisë dhe qeverisë të R.Bullgarisë për themelimin e Qendrës kulturore-informative të R.Maqedonisë në Sofija dhe Qendrës kulturore-informative të R.Bullgarisë në Shkup
26 korrik 2005	Marrëveshja mes Qeverisë të R.Maqedonisë dhe qeverisë të R.Bullgarisë për hapjen e kalimit të ri kufitar ndërkombëtar mes dy shteteve

16 mars 2006	Marrëveshje mes qeverisë të R.Maqedonisë dhe qeverisë të R.të Bullgarisë për shkëmbim dhe mbrojtje të ndërsjelltë në informacioneve të klasifikuara
21 janar 2007	Marrëveshje mes qeverisë të R.Maqedonisë dhe Qeverisë të R.Bullgarisë për bashkëpunim policor tejdoganor
1 janar 2007	Marrëveshje mes Qeverive të dy shteteve për udhëtime të ndërsjellta mes qytetarëve
1 tetor 2007	Konventa lidhur me Sistemin transballkanik të naftës
5 prill 2011	Marrëveshje për bashkëpunim ekonomik mes qeverisë të R.Maqedonisë dhe qeverisë të Republikës të Bullgarisë
14 tetor 2010	Marrëveshje mes qeverisë të R.Maqedonisë dhe qeverisë të R.Bullgarisë për themelimin dhe funksionimin e kontakt qendrës të përbashkët për bashkëpunim policor dhe doganor
1 gusht 2017	Marrëveshje për miqësi, fqinjësi të mire dhe bashkëpunim mes R.të Maqedonisë dhe R. të Bullgarisë (ka hyrë në fuqi më datë 14 shkurt 2018 në momentin e shkëmbimit të instrumentave të ratifikimit mes dy shteteve)
26 mars 2019	Marrëveshje mes R.të Maqedonisë dhe R.të Bullgarisë për bashkëpunim në raste katastrofash

Tabela nr.1-Tabelë kronologjike me datat e marrëveshjeve bilaterale mes R.të Maqedonisë të Veriut dhe Republikës të Bullgarisë(1992-2020) që i janë nënshtruar ratifikimit nga të dy shtetet nënshkruese

3. Nga Marrëveshja për fqinjësi të mirë (2017) deri në Samitin e Sofijas (2020)

(Sfidat e RMV-së në procesin eurointegruar)

Duke i konsideruar më se të rëndësishme raportet e mira fqinjësore si kriter për antarësim në BE, RMV ka hedhur hapat e para për të ndërtuar një marrëdhënie bilaterale stabile me qëllim zhvillimin e mëtutjeshëm të fqinjësisë të mirë, miqësisë dhe bashkëpunimit me palën bullgare, duke nënshkuajtur *“Marrëveshjen për Miqësinë, Fqinjësinë e mirë dhe bashkëpunim mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës të Bullgarisë”*.

Marrëveshja është firmosur në Shkup, më 1 gusht të vitit 2017, në dy gjuhët e palëve nënshkruese, të përfaqësuara nga kryeministrat e dy shteteve fqinje, Zoran Zaev dhe Bojko Borisov.

Duke u mbështetur në rëndësinë fundamentale që ka pasur Deklarata e përbashkët mes dy vendeve¹⁰³ dhe faktin që dy shtetet fqinje kanë një histori të përbashkët që lidh popujt e tyre, të mbështetur nga parimet e Kombeve të Bashkuara dhe parimet demokratike të Këshillit të Evropës, palët kanë rënë dakord që të firmosin Marrëveshjen për fqinjësi të mirë, e përbërë nga gjithsej 14 nene, me qëllim që të përforcojnë marrëdhënjet miqësore dhe të mbështesin aspiratat dhe integritet e shtetit maqedonas në Bashkimin Evropian dhe NATO.

Sipas marrëveshjes, palët kanë rënë dakord se do të bashkëpunojnë në kuadër të organizatave të ndryshme ku janë anëtare si: Kombet e Bashkuara, Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë, Këshillin e Evropës dhe forume të tjera. Përveç kësaj, palët kanë rënë dakord për bashkëpunim në sferën

¹⁰³ E nënshkruar në 22 shkurt 1999

e integrimi euroatlantike duke e ndihmuar dhe mbështetur Republikën e Maqedonisë në plotësimin e kriterëve të nevojshme për pranimin e ftesës për antarësim në NATO dhe BE.¹⁰⁴

Palët nënshkruese kanë marrë përsipër të ndihmojnë në zhvillimin e bashkëpunimit në mes shteteve të Evropës Juglindore, duke forcuar mirëkuptimin, paqen dhe stabilitetin në rajon dhe duke realizuar projekte rajonale si pjesë e procesit për ndërtimin e një Evrope të bashkuar.¹⁰⁵

Dy shtetet kanë vendosur të angazhohen për të mbajtur kontakte të rregullta mes veti, me qëllim realizimin e takimeve nëpërmjet përfaqësuesve të dy vendeve në nivele të ndryshme për të zhvilluar dhe me tej marrëdhënjet miqësore dhe bashkëpunimin, me çka, do të ndihmojë në mbajtjen e kontaktave dhe në mes të pushtetit lokal dhe qytetarëve të tyre.¹⁰⁶

Duke pasur parasysh pozitën e tyre gjeografike, ato do të synojnë të krijojnë kushte të mirëfillta ekonomike, finaciare, tregtare dhe juridike me qëllim sigurimin e kushteve të volitshme për lëvizjen e mallërave, shërbimeve dhe kapitalit si dhe të nxisin investimet e përbashkëta dhe bashkëpunim në fushën e turizmit.¹⁰⁷

Duke e vlerësuar të rëndësishëm rolin e lidhjeve të transportit dhe mënyrave të tjera të komunikimit mes tyre, palët do të punojnë për të realizuar projekte të përbashkëta infrastrukturore dhe do të lehtësojnë formalitetet doganore dhe kufitare për qytetarëve dhe mallërat.¹⁰⁸

Shtetet nënshkruese kanë për detyrë të nxisin bashkëpunimin aktiv dhe pa pengesa në fushën e arsimit, kulturës, shëndetësisë, politikës sociale dhe sportit duke pasur për obligim që në afat prej 3 muajsh nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, me qëllim të thellimit të mirëbesimit mes dy vendeve, palët do të

¹⁰⁴ Neni 2 i Marrëveshjes për fqinjësi të mirë, 1 gusht 2017

¹⁰⁵ Neni 3, Po aty

¹⁰⁶ Neni 4, po aty

¹⁰⁷ Neni 5 dhe 6, po aty

¹⁰⁸ Neni 7, po aty

formojnë një Komision ekspertësh të përbashkët multidiciplinar për çështje historike dhe educative, me qëllim që të kontribuojë në interpretimin e mirëfitlltë shkencor të ngjarjeve historike të mbështetura në fakte dhe burime historike. Palët do të organizojnë bashkarisht pjesëmarrje të dy shteteve në ngjarje të përbashkëta historike me qëllim thellimin e frymës dhe vlerave evropiane.¹⁰⁹

Shtetet nënshkruese të marrëveshjes kanë marrë përsipër bashkëpunimin dhe në fushën e informimit publik me mbështetje të mjeteve bashkëkohore informative, mbrojtjen e të drejtës intelektuale të autorëve nga të dy vendet, bashkëpunimin në fushën juridike dhe konsullore, më saktësisht, në fushën e çështjeve administrative, civile dhe penale si dhe në zgjidhjen e problemeve humanitare dhe sociale të qytetarëve të tyre.¹¹⁰

Shtetet angazhohen të mos ndërmarrin, mbështesin ose nxisin asnjë veprim kundrejt shtetit tjetër që kanë karakter armiqësor, nuk do të lejojnë që territori i tyre të shfytëzohet kundër territorit të shtetit tjetër nga organizata ose grupe të tjera që kanë për qëllim kryerjen e veprimeve separatist ose veprime që kanë kanosje për paqen dhe sigurine e shtetit tjetër nënshkrues. Shtetet në fjalë, nuk kanë dhe nuk duhet të kenë pretendime territorial kundrejt njëra tjetrës. Palët kanë të drejtë të mbrojnë të drejtat dhe interesat e shtetasve të tyre në territorin e shtetit tjetër nënshkrues në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Republika e Maqedonisë me këtë marrëveshje, vërteton se asnjë pjesë e Kushtetutës të saj nuk mundet dhe nuk duhet të interpretohet se paraqet ose ndonjëherë do të paraqesë bazë për ndërhyrjen në punët e brendshme të Republikës të Bullgarisë, me qëllim mbrojtjen e statusit dhe të drejtave të personave, që nuk janë shtetar të Republikës të Maqedonisë. Palët njëkohësisht angazhohen të ndërmarrin masa efektive për pengimin e propagandës qëllimkeqe nga ana e institucioneve dhe agjencioneve dhe do të hedhin poshtë akte të subjekteve private që kanë për qëllim nxitjen e dhunës, urrejtjes dhe

¹⁰⁹ Neni 8, po aty

¹¹⁰ Neni 9 dhe 10, po aty

veprimeve të tjera të ngjajshme që do të dëmtonin marrëdhënjen mes dy vendeve fqinje.¹¹¹

Në afat prej 3 muajsh pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për fqinjësi të mirë, dy palët nënshkruese do të formojnë Komision të përbashkët ndërqeveritar që do të udhëhiqet nga Ministrat për punë të jashtme të dy shteteve dhe do të përfshijë dhe përfaqësues të lartë zyrtarë nga të dy vendet. Ky komision do të realizojë takime të rregullta një here në vit, me qëllim mbikqyrjen e zbatimit efektiv të Marrëveshjes për fqinjësi të mirë, zbatimin e masave për përmirësimin e marrëdhënjeve bilaterale mes shteteve nënshkruese si dhe zgjidhjen e problematikave të paraqitura gjatë periudhës të realizimit të Marrëveshjes në fjalë. Sipas nevojës, takimet shpesh të Komisionit të përbashkët ndërqeveritar mund të organizohen edhe sipas nevojës, me kërkesë të njëres prej palëve.¹¹²

Marrëveshja ka hyrë në fuqi pasi është ratifikuar sipas kërkesave kushtetuese të shteteve nënshkruese pas shkëmbimit të instrumentave të ratifikimit pa afat të caktuar. Marrëveshja mund të nënshtrohet ndryshimeve në dakordim me shkrim nga dy palët në rrugë diplomatike, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 13. Marrëveshja mund të shfuqizohet nga secila prej palëve me njoftim me shkrim deri te pala tjetër por do të vazhdojë të jetë në fuqi një vit pas dates të pranimit të një njoftimi të tillë.

Sipas nenit 14 të Marrëveshjes, asnjëra nga palët, në asnjë mënyrë nuk do të interpretohet në atë formë që do të kundërshtojë marrëveshje të tjera bilaterale dhe multilaterale, në të cilat, palë janë shtetet nënshkruese.

Republika e Maqedonisë e ratifikoi marrëveshjen në 18 janar të vitit 2018 kurse hyri në fuqi në 26 janar të vitit 2018.¹¹³ Edhe Parlamenti Bullgar ratifikoi Marrëveshjen për fqinjësi të mirë më 18 janar 2018.¹¹⁴

¹¹¹ Neni 11, po aty

¹¹² Neni 12, po aty

¹¹³ Закон за ратификација на договорот за пријателство, добрососедство и соработка меѓу република македонија и република бугарија, Службен В. на Р.М. бр: [12/2018](#) од 18.01.2018

Pas bllokimit të fillimit të negociatave të Maqedonisë të Veriut në Samitin e BE-së në 28-29 qershor 2018 në Bruksel, që erdhi si goditje e rëndë për shtetin maqedonas i cili sapo kishte bërë një kompromis me palën greke për ndryshimin e emrit, politika e jashtme maqedonase u ballafaqua dhe me probleme të tjera, të cilat i konsideronte të zgjidhura. Pala bullgare u tregua jofleksibile dhe po riste çdo ditë kërkesat e saj lidhur me shtetin fqinj me të cilin ka firmosur në marrëveshje për "*fqinjësi të mirë*".

Memorandumi sqarues bullgar drejtuar shteteve antare të BE-së¹¹⁵, shkaktoi reagime të shumta në Republikën e Maqedonisë të Veriut lidhur me zgjerimin e mëtejshëm të BE-se. Për ironi të fatit, memorandumit paraqet një pamje jo aq të saktë të problemeve të komisionit dypalësh historik dhe arsimor: pala bullgare ka po aq përgjegjësi, në mos më shumë, për progresin e pamjaftueshëm. Memorandumi zbulon se qeveria Bullgare beson se e vërteta historike mund të përcaktohet dhe diktohet nga qeveria; pse atëherë është i nevojshëm një komision dypalësh nëse njëra palë këmbëngul se rezultatet e punës së saj duhet të jenë saktësisht të njëjta me pozicionin e saj? Shkrimi historik cilësor është një proces reflektimi dhe zhvillohet pa ndërhyrje politike.

Ajo që Sofia dëshiron të thotë është se maqedonasit, deri në vitin 1944, kishin të njëjtën histori me bullgarët sepse ata vetë ishin bullgarë, dhe pas vitit 1944 identiteti i tyre i vërtetë u ndryshua disi nga Tito. Një mendim i tillë mund të justifikohet nga një përpjekje për të "*ringjallur*" identitetin "*e vërtetë*" të maqedonasve. Një mendim i tillë etnik ka hyrë në histori dhe mund të jetë i rrezikshëm. Koncepti i shtyrë nga pala maqedonase për historinë "*e përbashkët*" është shumë më në përputhje me shkencën moderne dhe një pikë e mirë fillestare për të shkruar histori të përbashkët në Ballkan, e cila gjithashtu nënkupton që njerëzit kanë pikëpamje të ndryshme për të njëjtat ngjarje.

Fqinji Lindor, me të cilin kemi një Marrëveshje për Fqinjësi të Mirë dhe Bashkëpunim që nga 1 Gushti i vitit 2017, vlerëson se çështjet kryesore të

¹¹⁴ ЗАКОН за ратифициране на Договора за пријателство, добрососедство и соработништво меѓу Република Бугарија и Република Македонија, Законот е приет од 44-то Народно собрание на 18 јануари 2018 г. и е подпечатан со официјалниот печат на Народното собрание.

¹¹⁵ 16 shtator 2020

hapura midis tij dhe Shkupit janë gjuha, historia e përbashkët dhe çështjet e pakicave, të shprehura në gjashtë faqe të gjata me arsyetime historike. Me shpjegime dhe vlerësime të pretenduara të "ideologjisë shtetërore anti-bullgare", Sofja zyrtare i bën thirrje Shkupit të "shkëputet nga trashëgimia ideologjike e Jugosllavisë komuniste", e cila sipas Bullgarisë ishte arsyeja e "inxhinierisë etnike" në Maqedoninë e Veriut.

Sipas Sofjes, maqedonasit janë një projekt i Titos dhe gjuha maqedonase nuk ekzistoi deri më 2 gusht 1944.

"Gjuha maqedonase ose grupi etnik nuk ekzistuan deri më 2 gusht 1944. Krijimi i tyre është pjesë e ndërtimit të plotë të një identiteti të veçantë jo-Bullgar, qëllimi i të cilit ishte ndërprerja e lidhjeve midis popullsisë së Republikës Socialiste të atëhershme të Maqedonisë dhe Bullgarisë. Gjuha letrare Bullgare ka gjashtë norma rajonale të shkruara (kodifikime), tre prej të cilave bazohen në dialekte dhe tre në gjuhën letrare Bullgare. Krijimi i gjuhës maqedonase në 1944 në ish Jugosllavi ishte një akt i kodifikimit dytësor bazuar në gjuhën letrare Bullgare, i pasuruar më tej me forma deri në gjuhën amtare, duke simuluar kështu një proces natyror të bazuar në dialekte. "Arsyet mbi të cilat u krye kodifikimi dhe mënyra në të cilën ai u krye dëshmojnë se gjuha zyrtare e përdorur në Maqedoninë e Veriut sot mund të konsiderohet vetëm një normë e shkruar rajonale e gjuhës Bullgare," lexohet në memorandum.

Por Bullgaria shkon një hap më tej, me një "rishikim" të Marrëveshjes së Prespës për sa i përket gjuhës. Sofja vlerëson se përdorimi i termit gjuhë maqedonase në Marrëveshjen e Prespës nuk është i detyrueshëm për palët e treta dhe nuk e konsideron të detyrueshme standardizimin e Kombeve të Bashkuara nga 1977, kur gjuha maqedonase u njoh. Tani Sofja kërkon që në dokumentet e BE të thuhet "gjuha zyrtare e Republikës së Maqedonisë të Veriut" ose në rast nevojë absolute "gjuha maqedonase me fusnotë".

Sipas marrëveshjes dypalëshe, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë duhet të jenë pjesë e Kornizës negociuese për anëtarësimin në BE të Republikës së Maqedonisë të Veriut dhe të jenë pjesë e Kapitullit 35.

Sofja thekson se vendet kandidate nuk duhet të hyjnë në mosmarrëveshje të hapura në BE dhe beson se mosmarrëveshjet me Shkupin janë një konflikt i pazgjidhur që *"mund të ndikojë negativisht në vendimmarrjen e BE-së mbi anëtarësimin e Maqedonisë të Veriut"*.

Bullgaria akuzon se puna e komisionit të përbashkët të ekspertëve për historinë është bllokuar sepse pala maqedonase refuzoi të bie dakord mbi konceptin e *"historisë së përbashkët"*, në vend të kësaj duke përdorur terma të tillë si *"histori që e ndajnë së bashku"*. Për shkak të kësaj, Sofia beson se besimi është minuar midis të dy palëve.

Sofja gjithashtu informon partnerët e saj të BE-së se Maqedonia e Veriut nuk ka arsye për të kërkuar të drejta për asnjë popullsi në Bullgari, siç është rënë dakord nga të dy palët, por akuzon autoritetet maqedonase se nuk kanë ndryshuar politikën e tyre ndaj individëve dhe organizatave që kërkojnë njohjen e pakicës maqedonase në Bullgari, duke shkelur kështu Nenin 11 të Marrëveshjes për fqinjësi të mirë.

Ironia e madhe e memorandumit është hipokrizia e tij - është e vërtetë që identiteti zyrtar maqedonas u fut në popullatë me ndërhyrjen e shtetit, madje mund të thuhet se kombi u "shpik" nga komunistët (dhe a ka rëndësi kjo?). Por pothuajse e njëjta gjë është e vërtetë edhe për Bullgarinë, ku ndërtimi i kombit ndodhi nën një regjim autoritar. E njëjta gjë vlen edhe për gjuhën: të gjitha gjuhët e sotme standarde ishin dialekte në një moment, dhe zakonisht nevojitet një vendim politik për të vendosur se cila dialekt do të jetë baza për standardin.

Liderët e BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, në 10 nëntor të vitit 2020, u takuan në Sofija, Samit që mbahet në suazat e Procesit të Berlinit¹¹⁶ dhe me të

¹¹⁶ Procesi i Berlinit konsiderohet urë lidhëse mes Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. Njëqind vjet pas Fillimit të Luftës së Parë Botërore, krerët e qeverive, ministrat e Jashtëm dhe ministrat e Ekonomisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës, Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Sllovenisë, si dhe përfaqësuesve të Komisionit European, vendeve të ardhshme mikëpritëse Austrisë dhe Francës u takuan në Berlin më 28 Gusht 2014 për Konferencën e parë të Ballkanit Perëndimor. Një ndër iniciativat rajonale për lidhjen e shteteve të Ballkanit Perëndimor në fusha të rëndësishme si ekonomia, politika dhe infrastruktura me mbështetje të Gjermanisë dhe shteteve tjera evropiane.

cilën kanë kryesuar Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria për relizimin e zonës ekonomike rajonale. Pas aktiviteteve diplomatike intenzive dhe tensioneve në relacionin Sofija-Shkup, në 17 nëntor të vitit 2020 u realizua dhe kanosja e Bullgarisë për veto kundrejt Maqedonisë të Veriut dhe rrugëtimit për antarësim të saj në BE që në RMV interpretohet si një mesazh jo shume miqësor nga shteti fqinj. *“Ne kemi bllokadën e parë nga Bullgaria. Sot, neni 2 i Marrëveshjes është shkelur, ne nuk kemi shkelur asgjë deri më tani. Kjo është një ndjenjë e pakëndshme. Ne duhet të jemi të zgjuar dhe ta zgjidhim mosmarrëveshjen në një mënyrë miqësore, dhe sot një mesazh jo aq miqësor u dërgua nga Bullgaria fqinje. "Hapi i parë është bllokuar."* Sipas Zaev, neni 2 i Marrëveshjes së Fqinjësisë së Mirë thotë se Bullgaria duhet të mbështesë RMV-në në rrugën e integritimit. Pala Bullgare duhet të ndajë përvojën e saj në mënyrë që të ndihmojë Maqedoninë e Veriut të përmbushë kriteret e nevojshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe të mbështesë Maqedoninë në marrjen e një ftese për anëtarësim. Kjo deklaratë vjen pas aktivitetit intensiv diplomatik në Berlin, përmes të cilit përfaqësues të lartë të Shkupit dhe Sofjes u përpoqën të gjenin një zgjidhje për çështjet e diskutueshme rreth të cilave ishin kishin pasur përplasje në periudhën e kaluar. Të dy vendet u penguan në çështje historike, për të cilat historianët e të dy vendeve nuk gjetën një zgjidhje në takimin tre-ditor në tetor 2020 në Shkup.

Në Bruksel u zhvillua një diskutim në nivel ambasadorësh mbi kornizën negociuese për Maqedoninë e Veriut, si dhe për Shqipërinë. Në takimin e COREPER (Përfaqësuesit e Përhershëm / Ambasadorët e Shteteve Anëtare të BE), të kryesuar nga Ambasadori Gjerman, nuk u arrit asnjë marrëveshje për miratimin e kornizës negociuese për fillimin e negociatave midis Maqedonisë së Veriut dhe BE-së, siç demonstroi përfaqësuesi Bullga i cili nuk pranoi të jepte mbështetje.

Pozicioni i qeverisë maqedonase është se e drejta për vetëvendosje është një e drejtë e patjetërsueshme. Identiteti maqedonas dhe gjuha maqedonase janë një fakt dhe nuk duhet të diskutohen, sepse identiteti ynë nuk shkakton asnjë pretendim ndaj askujt, as tani dhe as në të ardhmen. BE vazhdoi me agjendën e paraparë me takimin e GAC (Këshilli i Punëve të Përgjithshme, takimi i Ministrave të Punëve të Jashtme ose Ministrave të BE-së të vendeve anëtare)

dhe takimi i Këshillit Evropian, në të cilin u paraqitën edhe një herë argumentet maqedonase si dhe mundësitë për të kapërcyer këtë situatë.

Fqinjësia e mirë nuk krijohet në letër, por me gjeste konkrete dhe mendoj se ekziston një bazë shumë e mirë për të pasur marrëdhënie të shkëlqyera midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veirut. Për më tepër, qëndrimet e palës bullgare në asnjë mënyrë nuk pasqyrojnë realitetin e ri të krijuar me pas 1 janarit 2007, kur Bullgaria iu bashkangjiti BE-së.

Konkluzione dhe Rekomandime

Fatkeqësisht, Ballkani gjithmonë fsheh të papritura. Por në këtë rast, është vërtet e vështirë të shohësh arsyeshmërinë.

Unë mendoj se pyetja kryesore këtu është, pse Bullgaria këmbëngul me obsesionin e saj me "*çështjen maqedonase*" me qëndrime kaq agresive për momentin? Mund të jetë e lidhur, nga njëra anë, me trazirat politike me të cilat përballlet qeveria në Sofje. Të pozosh si një mbrojtës i nderit kombëtar është gjithmonë taktikë e mirë për shpërqendrim. Dhe së dyti, ndikimi i partive "*patriotike*" në qeveri edhe pse mund të jetë vetëm një pozicion simbolik.

I vetmi kontest i ngjashëm ishte mosmarrëveshja e gjatë midis Greqisë dhe përsëri Maqedonisë, e cila u ndez nga nacionalizmi pa asnjë ndikim në thelbin e pranimin në BE dhe NATO. Por në fund, Greqia dhe Maqedonia gjetën një kompromis në Prespë.

Tani Bullgaria po provokon një konflikt edhe më të pakumtimtë për problemet bilaterale plotësisht të trilluara. Çështja se si historianët ose politikanët në Maqedoni interpretojnë historinë e kombit të tyre ose të gjuhës së tyre mund të zemërojë nacionalistët bullgarë (dhe anasjelltas) por nuk ka asnjë lidhje me Kriteret e Kopenhagës ose ndonjë kriter tjetër që një vend kandidat duhet të përmbushë BE.

Që nga momenti i ringjalljes kombëtare, popujt ballkanas përjetuan larminë etnike të Ballkanit vetëm si "*material*" për parashikimet e tyre

kombëtare të madhësisë. Kufijtë e shteteve kombëtare në Ballkan përcaktohen nga luftërat dhe gjaku, nga gjenocidet, nga shkëmbimi i popullsisë, nga asimilimi i pamëshirshëm. Historia e rajonit të Maqedonisë, e cila në vetvete mund të jetë një shembull pozitiv i ekzistencës paqësore të një hapësire të vogël të shumë popujve, kulturave dhe feve, dëshmon qartë për shkatërrimin e aspiratave për kombe "*të pastra*" në Ballkan.

Kur Bullgaria pretendon se nuk ka asnjë pakicë maqedonase në territorin e saj, ajo vetëm konfirmon se ka pakica brenda kufijve të saj. Sepse diçka që nuk ekziston nuk mund të mohohet! Frika nga pakica maqedonase flet për pasigurinë e identitetit kombëtar bullgar. Popujt me një identitet të qartë kombëtar nuk kanë frikë nga pakicat.

Pas Samitit të Sofijas, do të ishte veprim i duhur Bullgaria të pranonte vazhdimin e negociatave të RMV-së me BE-në, dhe debatet, në vend për çështje historike, dy shtetet fqinje të transferohen në bashkëpunim të mirëfilltë në fushën e kulturës, ekonomisë politikës dhe ekologjisë. Të vendosen prioritetet të reja dhe iniciativa të përbashkëta mes dy vendeve duke diskutuar për të gjitha çështjet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes që duhet të jetë unik dhe vetëm në frymën dhe standardet e së drejtës ndërkombëtare bashkëkohore dhe përmes qasjeve moderne për zgjidhjen e marrëdhënieve ndërshtetërore bilaterale dhe multilaterale. Një format i tillë i negociatave moderne nuk mund të ketë kushte për të detyruar njërin nga palët të pranojë kërkesa joreale të bëra nga pala tjetër, siç është heqja dorë (tërësisht ose pjesërisht) nga vetëvendosja e njerëzve të saj dhe heqja dorë nga vetë-identifikimi i qytetarëve të saj.

T'u japë një shtysë fillestare vendimtare aktiviteteve me potencial të fortë për përmirësimin e marrëdhënieve përmes promovimit të shkëmbimeve politike, diplomatike dhe civile, bashkëpunimit ushtarak-teknik, bashkëpunimit ekonomik, mjedisor, arsimor dhe kulturor, bashkëpunimit shkencor, medias dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut .

Do të ishte e rëndësishme që të përfshihen organizatat joqeveritare si shoqëri civile në biseda dhe bashkëpunim. Çështjet dhe aktivitetet e lidhura me historinë nuk duhet të jenë aq të përhapura sa aktualisht, por duhet të përfshihen si një aspekt specifik i mundshëm i bashkëpunimit kulturor dhe arsimor. Të

bëhet një kërkesë të qartë për politikanët, qytetarët dhe mediat në të dy vendet për të kundërshtojnë në mënyrë të prerë gjuhën e urrejtjes dhe manifestimet e revanshizmit historik, arrogancës dhe epërsisë në jetën politike dhe publike.

Pse Ballkani nuk ndryshon edhe kur përfshihet zyrtarisht në BE? Sepse aspirata për t'u bërë një anëtare e BE-së për vendet e Ballkanit nuk lindi nga rrethanat që ndanin themeluesit e BE-së. Ata donin të krijonin një komunitet paqësor të popujve, kombësive dhe pakicave. Padyshim që kjo nuk ishte aspirata e shteteve-kombe të Ballkanit. Duket se për politikanët e sotëm Bullgarë, BE duhet të jetë vetëm një garanci se ata vazhdojnë të ëndërrojnë për një "*Bullgari të Madhe*", tani përmes mjeteve diplomatike. Nëse "*Bullgaria e Madhe*" nuk mund të ekzistojë në të tashmen, atëherë të paktën të ketë ekzistuar në të kaluarën! Duke "*shantazhuar*" maqedonasit, në momentin kur janë në telashe, të pranojnë se të paktën dikur ishin bullgarë. Ndërsa politikanët bullgarë flasin për rrënjët, gjakun dhe origjinën etnobiologjike, ata ende nuk jetojnë në të tashmen evropiane.

Referenca:

1. Закон за ратификација на договорот за пријателство, добрососедство и соработка меѓу република македонија и република бугарија, Службен В. на Р.М. бр:[12/2018](#) од 18.01.2018
2. ЗАКОН за ратифициране на Договора за пријателство, добрососедство и сѐтрудничество между Република Бѐлгарија и Република Македонија, Законѓт е приет од 44-то Народно сѐбрание на 18 јануари 2018 г. и е подпечатан со официјалниот печат на Народното сѐбрание.
3. Marrëveshjen për Miqësinë, Fqinjësinë e mirë dhe bashkëpunim mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës të Bullgarisë"- versioni në gjuhën maqedonase, 1 gusht 2017.
4. Çavdar Marinov, „Македонското прашање од 1944 до денес“, 2014.
5. <https://ec.europa.eu/eurostat/data/database>
6. Алфа TV, 21.05.2013

KONCEPTI JURIDIKO-PENAL I BASHKËPUNIMIT NË OPTIKËN HISTORIKO-JURIDIKE SHQIPTARE

Xhenis Sina

Abstrakt

Në këtë artikull bëhet një prezantim i konceptit juridik të Institutit të bashkëpunimit sipas një rendi kronologjik historik sipas të Drejtës në Shqipëri. Në veçanti analizohen kodet penale që kanë vepruar nën pushtete të ndryshme politike dhe ndryshimet thelbësore që ka pësuar bashkëpunimi në secilin prej tyre. Nën lupën krahasimore shqyrtohen format nëpërmjet të cilave shfaqet ky institut i rëndësishëm i të drejtës penale dhe evoluimi i tyre.

Fjalë kyce: *E drejta zakonore; Kanuni i Lek Dukagjinit; Kodi penal otoman; Kodi penal i vitit 1928; Kodi penal i vitit 1952; Kodi penal i vitit 1972; Kodi penal i vitit 1977; Kodi penal i vitit 1993; organizatë kriminale.*

Hyrje

Instituti i bashkëpunimit në veprën penale, njihet që në kohërat e lashta, por një përpunim të hollësishëm dhe një sistematizëm të plotë ai mori në teorinë e së drejtës mesjetare dhe të drejtën penale franceze. Parimet e vendosura në lidhje me bashkëpunimin në veprën penale që gjetën pasqyrim në Kodin Penal Francez të vitit 1810 pothuajse u inkorporuan ku me ndryshime dhe ku pa ndryshime, ku pjesërisht dhe ku tërësisht edhe në të drejtat penale të shteteve të tjera europiane. Në këtë artikull bëhet një krahasim midis sistemeve të së drejtës që ka vepruar në kohë të ndryshme në territorin shqiptar, dhe sesi institute I

bashkëpunimit është trajtuar nga secili prej tyre. Fillimisht trajtohet e drejta zakonore vendase ku përfaqësues kryesor merret sistemi i normave të “Kanunit të Lek Dukagjinit” dhe sesi përcaktohej ndarja e roleve të bashkëpunimit në këtë insitut. Do të vëmë re se dhe pse kemi të bëjmë me një formë arkaike të së drejtës, një pjesë e saj vazhdon të jetë koherente edhe në të drejtën penale aktuale. Më pas, si pasojë e pushtimit otoman të territoreve shqiptare, vihet re dhe ndryshimin e së drejtës që do të veprojë në bazë të ligjit të Sheriatit dhe kanunametë otomane dhe një zgjerim i konceptit të bashkëpunimit. Me fitimin e pavarësisë të Shqipërisë në vitin 1912, fillojnë të miratohen edhe ligjet e para në lëmin e së drejtës penale, ku kulmin e përsosjes e arrin me kodifikimin e parë me “Kodin Penal të vitit 1928”, nën mbretërimin e Mbretit Zog I.

Pikërisht në këtë moment insituti i bashkëpunimit merr një formë të ngjashme me ato që parashikoheshin nga kodet penale europiane të po së njëjtës periudhë, por edhe një përcaktim i shfaqjes së formave të këtij insitutit, sic mund të citojmë përmendjen e termit “bandë”. Ky kod mbetet në fuqi deri në vitin 1948, ku me ardhjen e regjimit komunist në pushtet, ndryshime do të evidentohen edhe në të drejtën penale.

Me Kodin Penal të vitit 1952 bëhet një interpretim sipas teorisë socialiste të institutit të bashkëpunimit, interpretim i cili do të vazhdojë të zgjerohet si koncept me kodin penal të vitit 1953 dhe 1972. Ndryshime të theksuara me karakter politik të institutit të bashkëpunimit pasohen tek Kodi Penal i vitit 1977. Ku element interesant është përcaktimi si ‘organizatë kriminale’ i çdo lloj grupimi që do të shfaqte bindje politike të ndryshme nga ato të pushtetit komunist. Një sistematizim demokratik do t’i bëhet të drejtës penale shqiptare pikërisht me Ligjin nr.7669 të vitit 1993, ku bëhet edhe një ri përcaktim i institutit të bashkëpunimit dhe formave të saj. Vlen të thuhet që me ndryshimet që iu bënë Kodit Penal në vitin 2004 u arrit në përcaktim akoma më i plotë i parashikimit të formave të shfaqjes së institutit të bashkëpunimit i cili pasurohet herë pas here edhe nga interpretimet e vendimeve të Gjykatës së Lartë.

1. Koncepti juridiko penal i bashkëpunimit, sipas së drejtës penale që ka vepruar në Shqipëri, përpara instalimit të sistemit komunist.

Për të folur për një institut të tillë të së drejtës duhet të kemi parasysh se ai përfshihet në të Drejtën Penale dhe klasifikohet si krim. Pra për të patur një vizion sa më të qartë për temën në vazhdim do të shohim diçka më të thelluar në fushën e së Drejtës Penale, në origjinën e saj dhe pikërisht në të drejtën zakonore shqipëtare, si një nga burimet kryesore të së drejtës sonë penale. Studimi i së Drejtës Zakonore ka gjithashtu një rëndësi aktuale për të kuptuar fenomenin e zhvillimit të legjislacionit penal shqipëtar në përgjithësi dhe atë të bashkëpunimit në veçanti. E drejta zakonore shqipëtare u formua dhe u përsos në një ambjent të vështirë ekonomiko-social. Kulmi i zhvillimit të tyre përfaqësohet nga kanunet të cilët me të vërtetë mund të renditen si corpus-juris me vlera të pamohueshme historike e juridike. Këtu mund të përmendim Kanunin e Lek Dukagjinit, Kanunin e Labërisë etj. Zhvillimi ekonomiko-shoqëror i vendit bëri që vendin e zakoneve ta zinin normat e së drejtës zakonore.

E drejta zakonore u krijua mbi bazën e zakoneve dhe praktikës së gjykimit të pleqve. Ajo pësoi ndryshime të pjesshme sasiore dhe shpeshherë jo aq të dukshme për shkak të ndikimit jo shumë të fuqishme të ideologjisë dhe politikës së klasave sunduese, gjë që nuk ndodh tanimë. E drejta zakonore rregullonte çdo aspekt të jetës shqipëtare duke filluar që nga lindja e deri në vdekje. Në kuadrin e veprave penale aty parashikohet dhe instituti i bashkëpunimit. Kjo gjë duket qartë në normat e Kanunit të Lek Dukagjinit, ku jepen elementët thelbësorë të kuptimit të bashkëpunimit, llojet e bashkëpunësorëve dhe rregullat e përgjithshme të tyre. Sipas të drejtës zakonore me bashkëpunim kuptohet kryerja e një veprë penale nga dy ose më shumë persona bashkë. Pra siç shihet kërkohet si elementi objektiv, ekzistenca e dy ose më shumë personave së bashku në kryerjen e veprës penale, ashtu dhe elementi subjektiv siç është marrëveshja midis tyre për të realizuar veprën penale.

Përveç së drejtës zakonore shqiptare një tjetër sistem normash ligjore filloj të operonte në territoret shqipfolëse pas pushtimit otoman siç ishte Ligji i Sheriatit që përbëhej nga një sistem juridik normash të teologjisë islame. Krahshërimit pushteti otoman nxori dhe kanunametë nga Sulltan Mehmeti i dytë dhe nga viti 1878 hyri në fuqi Kodi Penal Otoman i cili pësoi plotësime të ndryshme të mëvonshme. Ky kod penal bashkë me ligjet penale të miratuara më vonë veçoi si ligj me fuqi dhe në Shqipëri dhe pas shpalljes së pavarësisë kombëtare

dhe krijimit të shtetit të pavarur shqiptar (28 nëntor 1912). Në ligjin shtesë të këtij kodi që hyri në fuqi më 22 maj 1327 sipas kalendarit të vjetër otoman parashikohet dhe gjen rregullim pikërisht instituti i bashkëpunimit. Konkretisht pika 45 e këtij ligji parashikon: " Kur shumë persona së bashku bejnë një krim apo delikt, ose secili prej tyre për realizimin e fajit bën një a disa prej veprave që përbëjnë krimin apo deliktin, personat e përmendur quhen bashkëveprues dhe të gjithë ndëshkohen si veprues" Pra për herë të parë jepet nocioni i bashkëpunimit si dhe përgjegjësia penale e bashkëpunëtorëve për të cilët pavarësisht nga roli që kanë patur në kryerjen e krimit do të ndëshkohen njëjloj sikurse ekzekutorët e krimit.

Megjithatë duke qënë një ligj i huaj, një ligj i një shteti pushtues dhe si i tillë, nuk mund të kishte po ato vlera në Shqipëri. Ai zbatohet në qytete dhe në zonat e tjera të pushtuara nga perandoria otomane, kurse në zonat malore të cilat nuk iu nënshtruan pushtimit dhe administratës së huaj vazhdon të vepronte e drejta zakonore penale e shqiptarëve, si shfaqje e qëndresës kundër pushtimit të huaj. Në vendin tonë elementët thelbësor të kuptimit të bashkëpunimit, llojet e bashkëpunëtorëve dhe përgjegjësia e tyre jepet edhe në të drejtën zakonore penale shqiptare, sidomos në Kanunin e Lek Dukagjinit. Për të pasur bashkëpunim sipas të drejtës zakonore shqiptare duhet të ekzistojë marrëveshja e mëparshme midis bashkëpunëtorëve.

Ky nocion është i njëjtë me kuptimin që jep legjislacioni i sotëm për institutin e bashkëpunimit. Sipas kanuneve për të patur bashkëpunim në krim kërkohej të ekzistonte patjetër dijenia, pra të kishte një marrëveshje të mëparshme midis bashkëpunëtorëve. Konkretisht sipas pikës 839 të Kanunit të Lek Dukagjinit parashikohej se "pushka dhe buka e dhanun me dije të vrasjes i sjellin gjakun atij që e jep". Po kështu zgjidhej çështja kur një person pranonte ftesën e një tjetri dhe shkonin për të vrarë një të tretë që nuk i kishte borxh gjakun vrasësit. Sipas Kanunit të Lek Dukagjinit njiheshin këta lloj bashkëpunëtorësh: Doras (ekzekutori) është personi që kryen veprën penale. Simalmer (ndihmës) është ai që i jep ndihmë dorasit ose në vrasje ose në vjedhje (pika 850 e kanunit). Hjekësi (ndërmjetësi) është ai që me ndërmjetësimin e tij ose fshehurazi ndihmon ekzekutorin për të kryer një krim.

Kështu i specifikon llojet e bashkëpunëtorëve Kanuni i Lek Dukagjinit duke treguar dhe përgjegjësinë e tyre për kryerjen e veprës penale. Bashkëpunëtorët në rolin e ndihmësve përgjigjen njëlloj si ekzekutorët, kurse si rregull nxitësit ose shtytësit në krim nuk përgjigjen si bashkëpunëtorë por i paguajnë një gjobë bajrakut të tyre ose i digjet shtëpia. Për shtytësit vepronte parimi "goja nuk qet kend në gjak " d.m.th përgjigjej vetëm ekzekutori sipas rregullit " gjaku shkon për gisht". Pas ngjarjes historike të Kongresit të Lushnjes (28 janar 1920) shteti shqiptar filloi të nxirrte akte normative që përmbanin norma penale.

Ligji penal Otoman në këtë periudhë historike, nuk u përgjigjej më nevojave të praktikës në luftën kundër kriminalitetit dhe për faktin se shteti turk ndodhej në kushtet e anarkisë politike dhe revoltave të ashpra brenda vendit ashtu sikurse dhe për shkak të mardhënieve të tendosura ndërkombëtare. Për këtë arsye në 27 prill 1920 u miratua "Ligji Ndëshkimor për Faje Politike". Sipas të drejtës ndëshkimore bashkëpunëtor quhet ai që me dije merr pjesë në një vepër të jashtëligjshme. Bashkëpunimi përbëhej nga elementët si: ekzistenca e veprimit fizik dhe vullnetit keqdashës. Ndërsa sipas shkallës së bashkëveprimit, bashkëpunimi ndahet në: bashkëveprim kryesues dhe bashkëveprim tërthor. Një përkthim më të plotë instituti i bashkëpunimit e gjeti në Kodin Penal të vitit 1928 gjatë mbretërimit të mbretit Zog I. Në nenin 64 të tij citohej: "Kur dy ose më shumë persona bashkohen në të kryerjen e një faji, secili nga ekzekutorët direkt dënohet në ndëshkimin e caktuar për fajin e bamun". Po me këtë ndëshkim dënohet dhe ai që ka determinue tjetrin me ba fajin. Sipas neneve 60 dhe 65 të këtij kodi bashkëpunëtorët ndahen në: (1) Ekzekutorë, (2) Bashkëpunëtor direkt, (3) Determinues, (4) Persona të tjerë që bashkohen në të kryerjen e veprës penale.

Sipas Kodit Penal të Zogut, me ekzekutorë do të konsideroheshin vetëm personat që merrnin pjesë direkt në kryerjen e veprës penale, pra që sulmojnë në kuptimin e ngushtë të fjalës, drejtpërdrejt objektin e mbrojtur nga ligji. Bashkëpunëtorë direkt do të kuptonim personat e tjerë që merrnin pjesë në ekzekutimin e veprës penale. Determinues quhen të gjithë ata persona që shtyjnë direkt ekzekutorin në kryerjen e veprës penale. Shtytësi duhet të ishte shkaku kryesor dhe vendimtar për kryerjen e veprës penale. Pra ndahej rasti kur ekzekutori e ka kryer veprën dhe për arsyet e veta duke u pasqyruar në një

zbritje të dënimit për këtë rast. Po kështu nën titullin " deliktet kundër sigurimit shtetëror" në "kaptinën 4, në nenin 144 të Kodit Penal të Zogut parashikohet se: Kushdo që formon një bandë të armatosur ose ushtron në atë komandë të lartë ose një funksion të posaçëm ndëshkohet me burgim të rëndë ose me burgim jo më pak se 10 vjet, gjithë të tjerët që kanë marrë pjesë në atë bandë ndëshkohen me burgim nga 30 muaj - 10 vjet."

Përsa i përket përgjegjësisë së tyre nuk bëhej ndonjë dallim, me përjashtim të rasteve kur ekzekutori në kryerjen e veprës penale ishte nisur dhe nga shkaqe personale. Sipas nenit 25 të kodit penal të pjesës së përgjithshme shtytësi dhe ndihmësi përgjigjeshin për fajin penal të kryer edhe kur ky kishte mbetur në fazën përgatitore apo në tentativë. Po ashtu sipas nenit 26 të kodit penal përcaktohej parimi sipas të cilit shtytësi dhe ndihmësi kanë përgjegjësi penale duke u marr parasysh shkalla e kontributit të tyre në kryerjen e fajit penal. Përsa i përket përgjegjësisë penale të bandës së armatosur, si dhe caktimit të dënimit, në kodin penal parashikoheshin rregulla të veçanta. Sipas këtij kodi dënohej jo vetëm formimi por edhe pjesëmarrja për të kryer vepra të tjera/delikte të cilat parashikohen shprehimisht në këtë nen.

Deliktet drejtoheshin kundër sigurimit shtetëror ashtu sikurse vetë kodi e parashikon në titullin e I të tij. Një dispozitë tjetër që duhet cituar nga ky kod është dhe neni 145, i cili parashikon ndëshkimin për të gjithë ata që i japin ndihmë një bande, që tashmë është formuar, pra personat që u sigurojnë streh, ushqim, municion etj. Ajo që paraqitet e veçantë në këtë kod është dispozita 146 e tij. Në këtë dispozitë parashikohet përjashtimi nga dënimi për ata që kanë formuar bandën, me kusht që ta shpërndajnë atë para se të kryejë deliktin për të cilin është krijuar.

Gjithashtu përjashtohen nga dënimi ata që vetëm marrin pjesë në bandë, pa qenë formues të saj me kusht që të tërhiqen dhe të lënë armët. Duhet të theksojmë se ky nen bën përjashtim nga dënimi, vetëm kur banda nuk e ka realizuar deliktin apo deliktet për kryerjen e të cilave është formuar. Kjo ndoshta tregon dhe ashpërsinë reale të Kodit Penal të Zogut.

2.Koncepti juridiko penal i bashkëpunimit, sipas së Drejtes Penale që ka vepruar në Shqipëri, gjatë sistemit komunist.

Mbas çlirimit të vendit instituti i bashkëpunimit gjeti vend në “Ligjin nr 599, i datës 13 maj 1948”, mbi pjesën e përgjithshme të Kodit Penal. Ky ligj dallonte këta bashkëpunëtorë në ekzekutorë, shtytës, ndihmës, inisiatorë. Ekzekutorët janë ata që çenojnë drejtpërdrejtë objektin e mbrojtur nga ligji. Shtytësit janë ata që me qëllim shtyjnë një person tjetër të kryejë një faj penal. Ndhimësit janë personat që me qëllim ndihmonin një person tjetër në kryerjen e një faji penal. Neni 24/2 na përcakton dhe mënyrat e dhënies së kësaj ndihme duke dhënë këshilla, udhëzime, duke vënë në dispozicion mjete, duke larguar pengesat për kryerjen e fajit penal, duke premtuar fshehjen e fajit penal, të veglave me të cilat është kryer fajit penal, të gjurmëve të fajit penal dhe të sendeve që mund të rrjedhin nga fajit penal. Sipas nenit 25 të pjesës së përgjithshme të kodit penal, shtytësi dhe ndihmësi përgjigjeshin si për faj penal të kryer por dhe kur mbetej në fazën e tentativës. Po ashtu sipas nenin 26 përcaktohej parimi sipas të cilit "shtytësi dhe ndihmësi janë përgjegjës penalisht brenda kufijve të qëllimit të tyre duke u marrë parasysh shkalla e kontributit të tyre në kryerjen e fajit penal". Gjithashtu duhet thënë se në pjesën e përgjithshme të kodit penal të vitit 1948 u sanksionua parimi sipas të cilit inisiatorët, organizatorët dhe anëtarët e thjeshtë të organizatës kriminale kanë përgjegjësi penale për të gjithë veprimtarinë kriminale të kryer nga organizata.

Kodi i ri penal i regjimit komunist hyri në fuqi në shtator të vitit 1952. Në këtë kod penal instituti i bashkëpunimit mori një përpunim më të plotë dhe që me ndonjë përjashtim u ruajt dhe në kodin penal të vitit 1977. Sipas nenit 12 të kodit penal: "Bashkëpunimi është kryerja me dashje e një krimi nga disa persona bashkë, ose krijimi për këtë qëllim i një organizate kriminale. "Sipas të drejtës penale të kësaj kohe, rëndësi e veçantë i kushtohej elementëve teorik të tillë si: lidhja shkakësore, faji, përgjegjësia penale e secilit bashkëpunëtor. Kështu sipas kësaj të drejte për të pasur figurën e krimit të bashkëpunimit në krim kërkohet: (a) pjesëmarrja e dy ose më shumë personave në kryerjen e një krimi, (b) lidhja shkak-pasojë ndërmjet veprimeve të çdo pjesëmarrësi në rezultatin kriminal, (c) elementi i dashjes. Teoria e së drejtës penale socialiste njihte dy forma kryesore të bashkëpunimit: bashkëpunim i thjeshtë dhe bashkëpunim i veçantë.

Forma e bashkëpunimit të thjeshtë është forma që paraqet më pak rrezikshmëri shoqërore, zakonisht në bashkëpunimin e thjeshtë hyjnë rastet kur pjesëmarrësit në krim paraqiten në role të veçanta si; nxitës, ndihmës, ekzekutor. Po kështu këtu bëjnë pjesë dhe rastet e tjera ku pjesëmarrësit në krim paraqiten në të njëjtin rol, (ekzekutorit) me kusht që të mos konkurojë me elementët e organizatës kriminale. Ndërsa bashkëpunimi i veçantë paraqet rrezikshmëri më të lartë shoqërore. Këtu është fjala për grupe personash të përgatitur për të kryer një ose më shumë krime. Karakteristikë është organizimi i pjesëmarrësve dhe përgatitja e tyre për të kryer veprimtari kriminale. E drejta penale e kësaj kohe njihet vetëm tre forma të bashkëpunimit të veçantë si : (1) Grupin e organizuar, (2) Bandën e armatosur; (3) Organizatën kriminale.

Përsa i përket grupit të organizuar deri nga fundi i vitit 1965, në praktikën gjyqësore lidhur me krimet e përvetsimit të pasurisë socialiste dhe asaj të qytetarëve është pranuar deri diku një njësime i kuptimit të grupit të organizuar me atë të bashkëpunimit të thjeshtë. Sipas kodit penal të vitit 1953 banda njihet vetëm si formë bashkëpunimi në krimet kundër shtetit, e citohej pikërisht prej nenit 69 të kodit i cili parashikon organizimin ose pjesëmarrjen në bandat e armatosura ku me “bandë” do të nënkuptohej një grup prej 2 ose më shumë personash, të armatosur, me një strukturë të qendrueshme, e krijuar me qëllim për të kryer veprimtari kundër pushtetit popullor.

Karakteristikë për bandën e armatosur ishin pikërisht organizimi dhe qëndrueshmëria e saj. Këto karakteristika e dallojnë atë nga grupi i zakonshëm, i krijuar rastësisht për të kryer një akt terrori ose një akt diversioni të veçantë. Ndryshe nga kodi penal i Zogut ky kod parashikonte në një dispozitë të tij krijimin e organizatës kriminale kundër pushtetit popullor (neni 69) konkretisht: "Organizimi ose pjesëmarrja në bandat e armatosura që hyjnë në Republikën Popullore të Shqipërisë ose që formohen në tokën e Republikës Popullore të Shqipërisë për të minuar pushtetin popullor me anë të sulmit kundër institucioneve shtetërore ose shoqërore, kundër përfaqësuesve të pushtetit popullor, punonjësve, ndërmarrjeve dhe pasurisë shtetërore ose pasurisë qytetare, dënohen me heqje të lirisë jo më pak se 10 vjet ose me vdekje dhe kurdoherë me konfiskim të pasurisë" Ky kod sikurse u tha nuk parashikonte dënime të ndryshme dhe as përjashtim nga dënimi të krijuesve/ pjesëmarrësve të bandës të cilët pendoheshin ose bashkëpunonin me drejtësinë.

Megjithatë vihet re një ashpërsim e kodit penal të vitit 1952. Në këtë kod krimi i organizimit ose i pjesëmarrjes në bandat e armatosura, konkuron me të gjitha krimet e tjera që kryhen prej bandës. Në nenin 76 të Kodit Penal parashikohej pjesëmarrja në një organizatë kriminale e cila ka për qëllim kryerjen e krimeve kundër shtetit të parashikuar në nenet 64-75 të kodit. Në kuptim të këtij neni kemi të bëjmë me organizatë kriminale, vetëm kur ajo ka për qëllim kryerjen e veprimeve të tilla si: Diversion, sabotim, vepra terroriste kundër përfaqësuesve të pushtetit, të cilat parashikon vetë dispozita.

Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë u miratua me ligjin nr 5591, datë 15.06.1977 dhe hyri në fuqi me 1 tetor 1977. Ajo që vihet re qysh në fillim është se ky kod është vetëm një vazhdimësi e kodit të mëparshëm. Sipas nenit 13 të Kodit Penal të vitit 1977 "Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje midis tyre, nga një grup i organizuar, nga një bandë e armatosur, ose nga një organizatë kundër revolucionare". Në teorinë e së drejtës penale socialiste të Shqipërisë si kriter ndarjeje në forma të ndryshme të bashkëpunimit është pranuar shkalla e lidhjes subjektive midis pjesëmarrësve në veprën penale. Pikërisht kjo shkallë e lidhjes subjektive përcakton dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të një forme nga një formë tjetër bashkëpunimi. Mbi këtë bazë teorike të së drejtës penale socialiste janë pranuar 3 forma bashkëpunimi. (1) bashkëfajësia, (2) bashkëpunim i thjeshtë (3) organizata kriminale. Duke u nisur nga fakti që kriteri më i drejtë për përcaktimin e formave të bashkëpunimit, është shkalla e lidhjes subjektive midis pjesëmarrësve në veprën penale është cilësuar më e drejtë ndarja e bashkëpunimit në dy forma kryesore: (1) Bashkëpunim i thjeshtë dhe (2) Bashkëpunim i veçantë. Trajtimi teorik është i njëjtë me atë që është bërë në komentin e Kodit Penal të vitit 1952.

E drejta penale e kësaj kohe dhe konkretisht neni 13 i Kodit Penal njeh 3 forma të bashkëpunimit të veçantë: 1) Grupin e Organizuar, Bandën e Armatosur dhe Organizatën Kriminale. Kodi Penal i mëparshëm i vitit 1952 termin grup jo gjithmonë e përdorte në kuptimin e grupit si formë e bashkëpunimit të veçantë. Kështu p.sh. fjala grup që përmendet në lidhje me krimin e kundërshtimit të përfaqësuesit të pushtetit, të parashikuar prej nenit 239 të Kodit Penal të vitit 1952, nuk ka kuptimin e grupit si formë e

bashkëpunimit të veçantë, por tregon thjesht numrin e subjekteve që kërkohet për të pasur figurën e krimit në rastin konkret. Në disa raste Kodi Penal i mëparshëm kur kishte parasysh grupin si formë e veçantë e bashkëpunimit ka përdorur fjalët "grup i organizuar" siç është rasti për krimet e parashikuara nga nenet 80;81;180;191. Sikurse u përmend më sipër "Banda" përfaqëson në vetvete një formë tjetër bashkëpunimi të veçantë. Sipas kodit penal të vitit 1977 banda e armatosur njihej si formë e bashkëpunimit të veçantë vetëm në krimet kundër shtetit, dhe pikërisht në atë të parashikuar prej nenit 51 të këtij kodi dhe konkretisht: "Organizimi i bandave të armatosura dhe pjesëmarrja në to, për të kryer krime kundër shtetit dënohen me heqje të lirisë jo më pak se 10 vjet ose me vdekje.

Duhet të theksojmë se edhe ky kod e quan krimin e konsumuar, me organizimin ose pjesëmarrjen në bandën e armatosur pa qënë nevoja për kryerjen e krimeve të tjera. Krimi në fjalë konkuron me të gjitha krimet e tjera. Sipas ligjit penal dhe praktikës gjyqësore të kësaj kohe me "bandë" kuptohet një grup prej dy ose më shumë personash i armatosur dhe i qëndrueshëm, i krijuar me qëllim për të kryer veprimtari kundër shtetit të diktaturës së proletariatit. Tipike për bandën është jo numri i pjesëmarrësve në të, por organizimi dhe qëndrueshmëria e saj. Së fundi forma më e lartë e bashkëpunimit të veçantë përsa i përket organizimit e qëndrueshmërisë ashtu dhe rrezikshmërisë shoqërore ishte "Organizata Kundër revolucionare", *me organizatë revolucionare kuptohej një grup relativisht i madh njerëzish , i qëndrueshëm dhe i organizuar mirë, i krijuar me qëllim për të dobësuar ose përmbysur pushtetin shtetëror...* Siç shihet organizata kundër-revolucionare destinohet për një veprimtari të gjerë, zakonisht për kryerjen e veprave të ndryshme si agjitacioni e propaganda, diversion, akt terrori spiunazh, prandaj organizimi i saj është më i perfeksionuar.

Sikurse banda dhe organizata kundër-revolucionare meqënëse janë forma të ndryshme të bashkëpunimit në krim, ato parashikohen në pjesën e posaçme të Kodit Penal si figura të veçanta krimesh. Kodi Penal i vitit 1977 në krahasim me Kodin Penal të vitit 1972 sillte disa ndryshime kryesore: (1) Zgjerimi dhe përcaktimi me saktësi e nocionit të organizatës kundër-revolucionare. (2) Parashikohet sanksion konkret për këtë lloj krimi. Trajtimi nga ana teorike është i njëjtë me atë që bëhet në komentarin e Kodit Penal të

vitit 1952. Pra të gjithë bashkëpunëtorët janë përgjegjës sikurse vetë ekzekutori. Edhe në lidhje me caktimin e masës së dënimit, nuk njihej ndonjë diferencim paraprak për bashkëpunëtorët e ndryshëm. Për çdo rast Gjykata në caktimin e masës së dënimit niset nga rrethanat konkrete, duke marrë parasysh shkallën e pjesëmarrjes së secilit në veprën penale, rrezikshmërinë e veprës dhe personalitetin e fajtorit. Duke u nisur nga ky fakt në praktikën gjyqësore nuk janë të rralla rastet që shtytësit në krim ose në kundravajtje penale i caktohet një masë dënimi më e madhe se ekzekutorit dhe ndihmësit.

3.Koncepti juridiko penal i bashkëpunimit, sipas së drejtës aktuale penale.

Deri në daljen e kodit të ri penal, u bënë një sërë shtesash dhe ndryshimesh, të cilat u realizuan në Ligjin nr 7669 datë 16.11.1993, i cili solli ndryshime si në pjesën e përgjithshme edhe në atë të posaçme. Ndryshim ky që erdhi si pasojë e rënies së regjimit të diktaturës dhe krijimin e një rendi të ri demokratik shtetëror. Konkretisht ndryshoi Neni 57 i Kodit Penal që parashikonte krijimin e “organizatës kriminale” duke dhënë këtë përkufizim: "Krijimi i një organizate me karakter fashist, komunist, totalitarist, terrorist, të drejtuar kundër rendit kushtetues ose pjesëmarrja në to dënohet”.

Në krahasim me kodin penal të mëparshëm pati disa ndryshime kryesore siç ishte zgjerimi i nocionit të organizatës kundër shtetit duke përfshirë të gjitha ato forma organizimi që bazohen në një sistem totalitar qeverisës, drejtuar kundër rendit kushtetues, ashtu sikurse parashikoheshin sanksione direkte dhe reale për këtë lloj krimi. Nga ana objektive Neni 57 i Kodit Penal parashikonte si organizimin ashtu dhe pjesëmarrjen në një organizatë kundër rendit kushtetues. Këto dy nocione ndonëse parashikohen nga e njëjta dispozitë e Kodit Penal kanë dallime midis tyre. Me “organizim” kuptohen ato veprime që shprehen në gjetjen e bashkëpunëtorëve, në përpunimin e planit kriminal për krijimin e organizatës dhe kryerjen e krimeve kundër shtetit, drejtimin direkt të veprimeve të pjesëmarrësve për realizimin e planit kriminal, në gjetjen e bazave për mbledhjet e organizatës. Me pjesëmarrje në organizatë kuptohen ato veprime që shprehen për realizimin e planit kriminal të organizatës. Pjesëmarrja në organizatë është kurdoherë pjesëmarrëse aktive dhe dallohet bashkëpunimi në

formën e ndihmës. Bashkëpunëtori (ndihmës) nuk merr pjesë drejtpërdrejt në organizatë por i jep ndihmën e premtuar që më parë në një rast të shkëputur.

Konkluzion

Dhënia e ndihmës shprehet në asistimin e një ose disa pjesëmarrësve të organizatës, në fshehjen e tyre, dhënien e ilaceve për mjekim etj. Në këto raste bashkëpunëtori do të përgjigjet sipas nenit që do të cilësohet vepra e anëtarit të organizatës. Krimi konsiderohej i kryer në bashkëpunim që nga çasti i krijimit ose pjesëmarrjes në një organizatë kundër rendit kushtetues, pavarësisht nga krimet e kryera prej saj. Kjo ndodh për vetë rrezikshmërinë shumë të theksuar që paraqet vepra kriminale, e cila konkuron në çdo rast me krimet e tjera kundër shtetit. Fakti që krimi i parashikuar nga Neni 57 i Kodit Penal quhet i kryer që nga çasti i krijimit të organizatës kriminale ose pjesëmarrjes në të por nuk do të thotë se mohohej tentativa për krijimin e organizatës. Pjesëmarrësi i organizatës kundër rendit kushtetues duhet të dinte se bënte pjesë në një organizatë kriminale, se veprimtaria e tij ishte pjesë përbërëse e veprimtarisë kriminale kundër rendit kushtetues, dhe me dashje dhe qëllim të posaçëm kundër shtetit. Pjesëmarrësit e organizatës kundër shtetit dënoheshin sipas parimeve të pjesës së përgjithshme mbi përgjegjësinë e bashkëpunëtorëve. Pjesëmarrësi në organizatën kriminale përgjigjej jo vetëm për veprat për të cilat ai kishte marrë pjesë drejtpërdrejt por edhe për ato të kryera nga pjesëmarrës të tjerë të organizatës kriminale, nëqoftëse kryerja e këtyre veprave hynte në planin e veprimtarisë së organizatës. Kur organizata kryente dhe krime kundër rendit kushtetues atëherë kishte konkurrim krimesh, dhe bëhej bashkimi i dënimeve sipas rregullave të përgjithshme. Edhe me ndryshimet që pati Kodi Penal në vitin 2004, përse I përket institutit të bashkëpunimit në aspektin teorik nuk pati ndryshime të tjera ashtu sikurse edhe në ndarjen e roleve të pjesëtarëve vazhdoi të ishte i njëjti klasifikim.

Bibliografia

1. “Kanuni i Lek Dukagjinit” nga Shtjefen Gjeçovi, Adrion LTD, 2001;
2. “E drejta penale e Republikës Popullore të Shqipërisë”, pjesa e posacme, Ismet Elezi, 1970;

3. Elezi, Ismet; Kaçupi, Skender; Maksim, Haxhia; "Komentar i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë", Tiranë , 2004;
4. “Ligji Ndëshkimor për Faje Politike” 27.04.1920, biblioteka elektronike e Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2020;
5. Kodi Penal i vitit 1928, biblioteka elektronike e Parlamentit të Republikës së Shqipërisë, 2020;
6. Ligji nr.599 “Për ndryshime në Kodin Penal” 13.05.1948, biblioteka e Universitet të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, 2020.
7. Kodi Penal i vitit 1952, biblioteka elektronike e Parlamentit të Republikës së Shqipërisë, 2020;
8. Kodi Penal i vitit 1972, biblioteka elektronike e Parlamentit të Republikës së Shqipërisë, 2020;
9. Ligji nr.7669 “Për ndryshime në Kodin Penal” 16.03.1993, Qendra e Botimeve Zyrtare, arkivi elektronik i akteve, 2020;
10. Kodi Penal i vitit 2004, Qendra e Botimeve Zyrtare, 2020.

PARALLEL LEARNING OF TWO OR MORE LANGUAGES

PhD. Edi KELA

Edikela17@gmail.com

ABSTRACT

There are various theories about how to teach a child to simultaneously use two languages. Many scientists agree that a child who is exposed to a parallel study of two languages in early childhood will naturally learn to use both languages. The child in this period will certainly go through different stages of intermingling in languages; borrowing words from the other language to express an idea, sometimes even in the same sentence. This is because a particular word can exist in one language, but not in the other one. Although, more specifically the meaning of a particular word in one language, can give a message that is not easily translated into the other language.

Children can experiment with languages to make a special effect or to focus themselves in certain situations. For example, one language may have less significance and it will be used to transmit information related to one's home or family, while the other may be used more formally in communication outside the home. However, there will still be periods where one language will be used more.

With this paper I will try to examine the obstacles and problems that arise in the parallel learning of two languages.

Key words: *two languages, obstacles, problems*

Advantages of the parallel learning of two or more languages.

Parallel learning of two or more languages means studying and familiarizing two or more cultures. Children who speak two or more languages without difficulty can balance languages and communicate in both languages. Most often these children come from parents of different cultures, speak different languages or grow in areas where their mother tongue is not used.

Research suggests that the mental capacity of bilingual children is different compared to children who speak only one language. People who use two or more languages in daily communication are in priority compared to people who communicate only in one language.

The advantage does not apply to intelligence, but that the mental capacity of bilingual children shows greater flexibility and adaptation to new situations.

Cognitive advantages of people who speak two or more languages:

-People who speak two or more languages are "better"

Knowing two or more languages increases the ability to solve tasks and problems. From the research it has been shown that people who speak two or more languages show better success in solving foreign language tests (English) compared to monolingual people.

- Bilingual people are better in multitasking

The brain of bilingual people is more flexible and can more easily divert attention from speech to writing or to some other content.

Based on a research carried out at the Pennsylvania State University, this is a kind of "juggling", because at the same time they are able to focus attention in different content.

The research used a simulator for driving a vehicle while solving other

tasks that distracted them. The survey showed that bilingual people made fewer mistakes in using vehicle.

- The risk of getting Alzheimer's disease is smaller.

Based on tests carried out by Evy Woumans at university hospitals in Brussels, first symptoms of Alzheimer's disease of monolingual people appear at 71 years of age, while in bilingual people the first symptoms appear at 75 years of age.¹¹⁷

However, this research remains a hypothesis that requires more serious scientific research.

From my research I came to the conclusion that people with Alzheimer's disease do not forget the second language, that is, in the early stages of the disease, while the patient can still speak and express emotions without difficulty, can use the two languages.

Better memory

The more often the brain matches with the muscle the more we practice we have more condition. Learning a language involves remembering grammatical rules and enriching the vocabulary, which helps strengthen the "brain muscles". This skill enhances the total memory that means that people who speak two or more languages have better memory and can store more information, a range of numbers, names, and instructions.¹¹⁸

Better perception

People who speak two or more languages have a better perception; they are better at selecting important information from insignificant, which means they can better see inaccurate information. It is therefore not surprising that writers knowing the advantages of multilingualism created polyglot

¹¹⁷ Ellen Bialystok and Fergus I. M. Craik, *Cognitive and Linguistic Processing in the Bilingual Mind*, Current Directions in Psychological Science, February 2010 19: 19-23.

¹¹⁸ IBDEM

characters such as Sherlock Holmes and Hercule Poirot.¹¹⁹

In addition to the abovementioned advantages, people who speak two or more languages have different views on cultures, in terms of religion, multiculturalism, etc. From the conducted research, I found that in the Republic of Macedonia, people who skillfully speak two or more languages almost have similar views about the events in the Republic of Macedonia.

They evaluate events more objectively, criticize on the basis of arguments and consider the cultural and moral values of the people.

I would like to mention the way I have learned languages. I try to remember which language I learned first; the answer is I do not remember!!!

Since I know myself, I know that I speak Turkish, Macedonian and Albanian language, and also Serbian-Croatian language (my grandmother's mother tongue).

Turkish language is the language we used to speak at home, but on the other hand home for me was also my neighbors' home Uncle Dimitri and Aunt Smilla who were Macedonians where I spent a good part of the day; on the other hand my home was also at the home of Tota and with Tota I was speaking Albanian language.

By learning the languages I learned about the way of life of the nations whose languages I spoke. Did it make me forget where I belong? Absolutely not, I felt that I belong everywhere but that there are some small differences that I need to cherish for being me.

Obstacles and problems that arise in the parallel learning of two or more languages

Parallel learning of two or more languages can lead same problems but

¹¹⁹ <http://www.lexis.rs/index.php/en/blog/40-prednost-bilingvizma>

parents play a major role here, they have to be well informed and guide the child correctly. Adults who actively use two or more languages also can face certain problems.

The most common problems that a child can face in parallel learning in two or more languages are:

- Interference in languages,
- Difficulties in pronunciation of certain voices,
- Difficulties in expressing an opinion because of an insufficient fund of words

Till they fully comprehend the two languages, the intermingling of languages is a normal phenomenon. When expressing a particular opinion or attempting to translate a particular sentence from one language to another, there is interference in languages because certain words or expressions may not be in the other language so a child can "borrow" words while communicating in one language or expressions from the other language.

The research showed that the third problem is quite evident in the Republic of Macedonia. Although Macedonia is considered as a multi-lingual state, the question arises whether bilingual people use the two languages well enough and skillfully. From the conducted research it turned out that over 60% of people who can communicate in two or more languages and their word fund is rare. Of course, the level of education, the environment in which they grew up, the parents, and so on play a major role. However, the parents have a key role to play in their information and education.

So, bilingualism is the ability of a speaker to alternately use two or more languages.¹²⁰

Bibliography

1. Bernard Pottier, "Linguistique générale", Klincksieck, Paris, 1985

¹²⁰ Edwards 1994: J. Edwards, *Multilingualism*. London; New York.

2. Bratt Paulston, Richard G. *Tucker*,” [Intercultural Discourse and Communication](#)”, Blackwell Publishing Ltd, USA, 2005
3. Colin Baker, Sylvia Prys Jones, “Encyclopedia of Bilingualism and Bilingual Education”, Multilingual Matters, 1998
4. C.T. Onion, [G. W. S. Friedrichsen](#), [R. W. Burchfield](#), “The Oxford Dictionary of English Etymology”, 1st Edition, Oxford University Press, Oxford, 1966. P. 401
5. Dianna L. Stone D., Eugene F. Stone-Romero, „The Influence of Culture on HUMAN Resource Management Processes and Practices“, Psychology Press, Taylor&Francis , New York, London, 2008
6. Daniel Chandler, “The Basics Semiotics”, Routledge, London, 2007
7. Ellen Bialystok and Fergus I. M. Craik, *Cognitive and Linguistic Processing in the Bilingual Mind*, Current Directions in Psychological Science, February 2010
8. Edwards 1994: J. Edwards, *Multilingualism*. London; New York.

VIKTIMOLOGJIA DHE RËNDËSIA E STUDIMIT TË SAJ - POZITA E VIKTIMAVE NË SHQIPËRI

MSc.Albina BERISHA

International University of Struga (a.berisha@eust.edu.mk)

Abstrakt

Kriminaliteti ndër vite ka pësuar një rritje të madhe gjithashtu është sofistikuar në metodat e tij. Me rritjen kaq të madhe të numrit të krimeve, rriten edhe numrat e personave që bien viktima të krimit. Trajtimi i këtyre rasteve kërkon një përkushtim shumë të madh të aktorëve shtetëror dhe jo-shtetëror dhe një bashkëpunim ndërkombëtar për minimizim të rasteve të viktimizimit.

Shoqëria është një hallkë shumë e rëndësishme e zhvillimit të një shteti, përballja e saj me fenomene negative si kriminaliteti, korrupsioni, varfëria, problemet e shumta në brendësi të strukturave familjare, çon në një probabilitet shumë të lartë që kategori të veçanta të bien pre e viktimizimit në vend.

Identifikimi i faktorëve bazë që ndikojnë në shfaqjen e viktimizimit dhe analizimi i këtyre faktorëve dhe pasojat që ato sjellin mund të ndikojnë në uljen e rasteve të viktimizimit.

Fjalë kyçe: *Viktima, viktimologjia, Shqipëri, pozitë.*

Hyrje

Sot në botë numri i viktimave të krimit është në rritje, sipas të dhënave zyrtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara rreth 464,000 njerëz vlerësohet të kenë qenë viktimat të vrasjes me dashje në 2017, ku një normë mesatare globale e vrasjeve prej 6.1 viktimash për 100,000 banorë u vlerësua në vitin 2017 dhe rreth 90 për qind e të gjitha vrasjeve të regjistruara në mbarë botën janë kryer nga autorë meshkuj.¹²¹

Këto janë disa shifra zyrtare, por ka ende shumë krime që nuk janë raportuar, ka shumë viktimat të cilat nuk kanë gjetur guxim për t'u drejtuar në organet kompetente për të kërkuar ndihmën dhe të drejtat që i garantohen me ligj. Ka disa arsye që mund t'i bëjë viktimat të mos drejtohen në organet kompetente, mund të jetë mungesa e besimit në institucione, kërcënimet për jetën e tyre ose për familjarët e tyre, mund të ndikoj edhe korrupsioni i lartë në institucione, joprofesionalizmi i stafit (mos përgatitja e personelit të punësuar, të cilët mund të shkaktojnë viktimizim sekondar), zvarritja e procedurës për të dënuar shkelësit, mos ofrimi i kompesimit të dëmit të viktimave (ose familjarëve të viktimës). Pra ka një sërë faktorë që ndikojnë në mos raportimin e rasteve të viktimizimit duke çuar shpeshherë deri në humbje jete të viktimave.

Studimi i viktimologjisë në aspekt të veçuar nga kriminologjia, i vjen në ndihmë profesionistëve të cilët duhet të përgatiten për mënyrën e trajtimit të rasteve të viktimave të ndryshme, të kuptuarit e faktorëve që ndikojnë në shfaqjen e rasteve të viktimizimit në një shoqëri, gjithashtu përgatitja e studimeve cilësore në këtë fushë mund t'i ndikojë pozitivisht edhe viktimave për t'u informuar mbi të drejtat e tyre, mbi pozitën e tyre në procedurë penale dhe për informimin mbi të gjithë institucionet ku mund të drejtohen për të kërkuar ndihmë. Një bashkëpunim efikas midis gjyqëtarëve, policëve, punonjësve social/psikologëve dhe palëve të interesuar do t'i vendoste në një pozitë më të mirë viktimat.

¹²¹ [Global study on homicide](#)

Gjithashtu shtetit duhet të marrë në konsideratë të gjithë faktorët që ndikojnë në shfaqjen e viktimizimit në vend, të studioj gjendjen aktuale të rasteve të viktimave, një pasqyrë e qartë të reagimit të shoqërisë ndaj viktimizimit, gjithashtu duhet bërë dhe identifikimi i viktimave potenciale. Të gjithë këto fusha mund të sjellin ndërmarrjen e masa që ndikojnë në uljen e viktimizimit në vend dhe në rregullimin e pozitës së viktimave në drejtësi. Kujdesi i vazhdueshëm duhet bërë ndaj grupeve potenciale për të qënë viktimas si : të miturit, femrat, të moshuarit. Të cilët për shkak të disa arsye mund të bien lehtë viktimas të krimit.

Viktimologjia si shkencë e veçantë

Puna në drejtësinë penale është një bashkëveprim i ndërlidhur midis palëve të interesuara, gjyqëtarëve, oficerëve dhe autorëve. Ka dhe një pjesë tjetër thelbësore të procesit, por që shpeshherë anashkalohen në përpjekje për të ndëshkuar autorët: viktimas.

Vetë termi viktimë ka kaluar një evolucion. Ai e ka origjinën nga termi latin viktimas që i referohet një kafshe ose qenieje njerëzore të ofruar si flijim për një hyjni. Gjatë shekullit të 17-të, u përdor për të përshkruar njerëzit që u plagosën, u torturuan, ose të vrarë. Aktualisht, termi viktimë i referohet një personi që pëson dëmtime ose lëndime në një shumëllojshmëri të rrethanave.¹²² Viktimat e krimit përfshijnë çdo individ, pa dallim e racës, gjinisë, fesë, moshës apo dhe orientimit seksual.

Në studimet e hershme kriminologjike vihet re se para shekullit të 20 hulumtimet dhe informacionet për viktimat kanë qënë të pakta, por kjo nuk ka ardhë nga fakti që nuk janë trajtuar viktimat e krimit, por që fokusi dhe vëmendja primare ka qënë tek autorët e krimit.

Benjamin Mendelsohn, i referuar shpesh si babai i viktimologjisë, e përshkruan këtë fushë si "shkenca e viktimave dhe viktimitetit. Me viktimitet nënkuptojmë konceptin e përgjithshëm, fenomenin e përbashkët specifik që karakterizon të gjitha kategoritë e viktimave, pavarësisht nga shkaku i situatës

¹²² Nicky Ali Jackson, Kathryn M. Campbell, Margaret Pate, "The victimology of wrongful conviction- Innocent Inmates and Indirect Victims", Routledge, 2022, pg.11

së tyre". Me fjalë të tjera, vazhdon Mendelsohn, "ajo (viktimologjia) duhet të marrë parasysh të gjitha fenomenet që shkaktojnë viktima, në masën që shoqëria interesohet për to".¹²³

1.1 Fushat kryesore të studimit në viktimologji

Fushat kryesore ku është e përqendruar viktimologjia i përketë :

1. Studimi i viktimave të krimit dhe marrëdhëniet e tyre me shkelësit.
2. Eksplorimi i karakteristikave të cenueshmërisë së viktimës.
3. Ekzaminimi i gjendjes së rëndë të viktimës.
4. Një ekzaminim i përgjigjes së sistemit të drejtësisë penale ndaj viktimave.
5. Një ekzaminim i reagimit të shoqërisë ndaj viktimizimit.
6. Identifikimi i “viktimave” të reja të sjelljeve që nuk konsideroheshin më parë kriminale.¹²⁴

Mund të themi që viktimologjia është studimi i viktimizimit që përfshin analizën e marrëdhënies viktimë-shkelës si dhe përvojat e viktimës me sistemin e drejtësisë penale gjatë administrimit të drejtësisë.

Por në bazë të Deklaratës mbi Parimet Themelore të Drejtësisë për viktimat e krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit , kuptimi viktimë në raste të

¹²³ Shelly Clevenger, Jordana N. Navarro, Catherine D. Marcum, George E. Higgins , “Understanding Victimology”, 2018, pg.11

¹²⁴ Nicky Ali Jackson, Kathryn M. Campbell, Margaret Pate, “The victimology of wrongful conviction- Innocent Inmates and Indirect Victims”, Routledge, 2022, pg.12

caktuara përfshinë dhe të afërmit në lidhje familjare ose farefisnore që kanë jetuar me viktimën ose kanë qenë të varuar nga viktima.¹²⁵

1.2 Viktimologjia dhe rëndësia e saj si degë e vecantë

Fusha e viktimologjisë përfshin këto dy qëllime kryesore:

- të parandalojë që viktimizimi të ndodhë në radhë të parë
- të minimizojë dëmin pas viktimizimit, si dhe të parandalojë viktimizimin e përsëritur.

Autori Frederick Wertham nënvizon rëndësinë e viktimologjisë në kuptimin e përgjithshëm të krimit: *“Nuk mund të kuptohet psikologjia e vrasësit nëse nuk kupton sociologjinë e viktimës. Ajo që na nevojitet është një shkencë e viktimologjisë”*.¹²⁶

Studimi ndaj kësaj disipline jep ndihmesën e saj në të kuptuarit më qartë jo vetëm të shkaqeve që çuan një person të jetë viktimë, por edhe të analizuarit të efekteve psikologjike të krimeve mbi viktimat, ndërveprimet ndërmjet viktimave dhe sistemit të drejtësisë penale por edhe analizën e marrëdhënieve ndërmjet viktimave dhe autorëve.

2. Tipologjia e viktimave të krimit

Në fund të viteve 1930 dhe në fillim të viteve 1940, një avokat i specializuar në punën e mbrojtjes penale filloi një seri studimesh të krijuara për të ndihmuar: avokatët mbrojtës në përgatitjen e çështjeve në emër të klientëve të tyre. Avokati ishte Benjamin Mendelsohn dhe studimet e tij, veçanërisht ato për

¹²⁵ Halili, Ragip, “Viktimologjia”, Prishtinë, 2011, fq.47

¹²⁶ Po aty.

përdhunimin, arritën kulmin me përcaktimin e një tipologjie të viktimave kriminale.¹²⁷

Kjo tipologji përbëhet nga kategoritë e mëposhtme:

Niveli i fajësisë së viktimës	Shembuj
Plotësisht i pafajshëm	një individ i vrarë teksa fle në gjumë
Viktimë me faj të vogël	grabitet një individ pasi ka ekspozuar para
Viktima fajtor si shkelësi	një individ i vrarë gjatë një transaksioni droge
Viktima më shumë fajtor se shkelësi	një individ i vrarë pasi ka nisur një sherr fizik
Viktima fajtoresh plotësisht	një individ i vrarë gjatë kryerjes së një grabitjeje
Viktima imagjinare	një individ që pretendon se është viktimizuar

Tabela.1 Niveli i fajësisë së viktimave të Mendelsohn-it, me shembuj.¹²⁸

Kjo ndarje ka ndihmuar në fushën e viktimologjisë, duke u bërë dhe shembull kyç sesi studiues të viktimologjisë së hershme kanë shërbyer për të përcaktuar viktimën dhe nivelin e fajësisë së saj. Nga ndarja e paraqitur në tabelën 1, shihet se vetëm dy kategori lidhen me viktimat faji i të cilave është më i vogël se faji i vetë autorit, dhe vetëm një kategori i përket viktimës që konsiderohet plotësisht e pafajshme.

Nga ana tjetër kemi më shumë kategori ku përfshijnë viktimat që kanë faj sëbashku me autorin e krimit dhe viktimat që kanë faj më të madh se autori.

Mendelsohn mendon se për këto përfundime ndoshta qëndron fakti se analistët socialë të krimit kanë neglizhuar viktimën e pafajshme. Në përgjithësi shkencëtarët social që analizojnë krimin i fillojnë studimet e tyre me dy supozime:

1. Kërkojnë shpjegim për sjellje kriminale

¹²⁷ Sengstock, Mary C. , "The Culpable Victim in Mendelsohn's Typology", April 1976, pg.2

¹²⁸ Shelly Clevenger, Jordana N. Navarro, Catherine D. Marcum, George E. Higgins, "Understanding Victimology", 2018, pg.14

2. Ata supozojnë se ky shpjegim do të qëndrojë në faktorë social, në vend të faktorëve psikologjikë apo biologjikë.¹²⁹

2.1 Shkaqet dhe pasojat e viktimizimit

Nëse flasim për shkaqet ose pasojat e viktimizimit mund të themi që janë dhe të ngjashëm me shkaqet dhe pasojat e kriminalitetit. Shpjegimet mbi faktorët e viktimitetit mbështeten në teoritë e njohura mbi shkaqet e kriminalitetit.

Kryesisht kemi disa faktorë të jashtëm të viktimizimit që mund të jenë :

- Faktorë ekonomiko-socialë
- Faktorët politikë ose konfliktet politike
- Familja
- Media e shkruar
- Sëmundje sociale etj.

Por kemi dhe faktorë të tjerë që mund të merren si faktorë të brendshëm të viktimizimit që mund të jenë:

- Vetë dhe cilësitë biofizike
- Karakteri dhe temperamentit si faktorë i viktimizimit
- Inteligjenca si faktorë i viktimizimit
- Emocionet
- Motivet

¹²⁹ Sengstock, Mary C. , "The Culpable Victim in Mendelsohn's Typology", April 1976, pg.10

- Çrregullimet mendore etj.¹³⁰

Një nga fushat kryesore të viktimologjisë është shqyrtimi i faktorëve që e bëjnë një individ ose një grup individësh të ndjeshëm për t'u bërë viktimë e një krimi ose një sulmi të dhunshëm.

Disa autorë kanë kategorizuan disa elementë që mund të funksionojnë si faktorë rreziku dhe mbrojtës për viktimat e krimit:

- Faktorët mbrojtës individuale
- Faktorët mbrojtës familjarë
- Faktorët shtesë të mbrojtjes familjare
- Faktorët e fleksibilitetit.

Klasifikimi i lartpërmendur përfshin kryesisht elemente mbrojtëse individuale si "temperamenti, aftësia për të reflektuar, qëndrimet njohëse" dhe komponentët e familjes si aftësia e anëtarëve të familjes për të shprehur emocione si ngrohtësia dhe dhembshuria, marrëdhëniet ndërpersonale mes tyre dhe ndikim tek viktimë. Autorët gjithashtu shtuan një element shtesë mbrojtës të ofruar nga familja, që përfshinte anëtarë që nuk kanë lidhje gjaku, por që formojnë sistemin e mbështetjes sociale. Faktorët e fleksibilitetit marrin në konsideratë rolin e këmbënguljes dhe përballjes së viktimës për t'u përballur me përvojat stresuese dhe duke pasur parasysh rolin e elementeve fizike, psikosociale dhe mjedisore në jetën e viktimës.¹³¹

Përveç kategorive të përmendura, ekziston një listë tjetër me shumë faktorë që ndikojnë në rrezikun e viktimizimit. Ato renditen më poshtë si:

1. Faktorët individualë

¹³⁰ Halili, Ragip, "Viktimologjia", Prishtinë, 2011, fq.118-125

¹³¹ Rejani Thudalikunnil Gopalan, Editor, "Victimology - A Comprehensive Approach to Forensic, Psychosocial and Legal Perspectives", 2022, pg.273

- Historia e mëparshme e (dhuna në familje/dhuna nga partneri intim).
- Gjinia.
- Moshë e re.
- Përdorimi i alkoolit dhe drogës.
- Sjellje seksuale me rrezik të lartë.
- Përvojat e fëmijërisë (të qënurit dëshmitarit ose viktimë e dhunës).
- Të qenit më pak i arsimuar.
- Papunësia.
- Në rastin e meshkujve, dallimet në përkatësinë etnike në partnerë shfaqen si faktor.
- Për gratë, niveli i arsimimit luan një rol veçanërisht
- Përsa i përket grave, prania e një partneri që shpesh është abuziv verbalisht, sjellja, xhelozia dhe posesiviteti duket se rrisin rrezikun.

2. *Faktorët e marrëdhënieve*

- Partnerët që kanë dallime financiare, arsimore apo profesionale
- Një çekuilibër i fuqisë dhe kontrollit në marrëdhëniet me një partner dominuese.

3. *Faktorët e Komunitetit*

- Varfëria dhe faktorët shoqëruar (p.sh. mbipopullimi).
- Kur ka një shkallë të reduktuar të kapitalit social në kushtet e mungesës ose mungesa e institucioneve ose e marrëdhënieve ose e parimeve të sjelljes shoqërore që janë përgjegjës për vendosjen e ndërveprimeve të shëndetshme shoqërore (si në mënyrë cilësore ashtu edhe në mënyrë sasiore) brenda një komuniteti, ai mund të funksionojë si një faktor rreziku potencial.
- Dhuna në familje dhe/ose dhuna nga partneri intim nuk ka gjithmonë sanksione të forta të komunitetit. dhe kjo ndonjëherë shihet në mungesë vullneti të policisë për të ndërhyrë dhe marrë masa.

4. Faktorët shoqërorë

- Normat gjinore patriarkale (p.sh. gratë duhet të qëndrojnë në shtëpi, të mos hyjnë në fuqinë punëtore, duhet të jenë të nënshtruara)¹³²

Siç u përmend më lart, viktimizimi ndikon jo vetëm tek viktimat kryesore, por edhe tek anëtarët e familjes, miqtë, bashkëpunëtorët dhe shoqëria. Viktimat parësore dhe dytësore përjetojnë efekte afatshkurtra dhe afatgjata si rezultat i viktimizimit. Menjëherë pas një krimi, viktimat do të përjetojnë efekte fizike dhe/ose psikologjike – dëme ekonomike.

Sipas profesorëve Wallace dhe Roberson këto janë katër kategoritë e pasojave të dhunës fizike (llojet e dëmtimeve fizike të pësuar nga viktimat e dhunës fizike mund të mbulojnë të gjithë spektrin e sëmundjes, nga mavijosjet e thjeshta deri te plagët vdekjeprurëse me armë zjarri në kokë). Ato përfshijnë si në vijim:

1. *Lëndimet e menjëhershme*: mavijosje, kontuzione, prerje dhe kocka të thyera. Këto lëndime kanë tendencë të shërohen shpejt dhe për këtë arsye shpesh mund konsiderohen si të parëndësishme.
2. *Lëndimet që lënë shenja të dukshme*: humbja e dhëmbëve, humbja e gishtërinjve ose këmbëve, ose humbja e përkohshme e lëvizshmërisë. Këto lëndime mund të ndryshojnë jetën e viktimës, por shpesh nuk konsiderohen si katastrofike.
3. *Lëndimet fizike afatgjata të panjohura*: ekspozimi ndaj sindromës së mungesës së imunitetit të fituar ose sëmundjeve të tjera seksualisht të transmetueshme. Këto lëndime mund të jenë katastrofike pasi mund të rezultojnë në humbjen e jetës ose një rënie të ndjeshme të cilësisë së jetës.
4. *Lëndimet katastrofike afatgjata*: lëndime që ndryshojnë lëvizshmërinë fizike të viktimës. Këto lëndime janë katastrofike në atë që cilësia e jetës së viktimës mund të ndryshojë përgjithmonë.¹³³

¹³² Rejani Thudalikunnil Gopalan , Editor, "Victimology - A Comprehensive Approach to Forensic, Psychosocial and Legal Perspectives", 2022, pg.273-274

¹³³ Harvey Wallace, Cliff Roberson, Julie L.Globokar, "Family Violence: Legal, Medical, and Social Perspectives", 2019, pg.31-32

Autorët përmendin dhe çrregullimi i stresit akut , i cili është stresi akut që përjetohet menjëherë pas një ngjarjeje traumatike gjithashtu dhe çrregullimi i stresit posttraumatik i cili përkufizohet si zhvillimi i simptomave karakteristike pas një ngjarjeje shqetësuese psikologjike që është jashtë kufijve të përvojës së zakonshme njerëzore. Edhe këto janë pasoja të viktimizimit të cilat do të ndikojnë në risocializimin e viktimave.

Marrëdhëniet e punës shpesh ndikohet nga viktimizimi, nëpërmjet rasteve të uljes së produktivitetit të punëtorëve, humbjes së pagave dhe rritjes së mungesave. Viktimizimi ndikon gjithashtu në marrëdhëniet shoqërore pasi viktimat mund të distancohen nga ata me të cilët dikur kishin besim. Ata mund të mos lidhen më në të njëjtën mënyrë me të huajt – ata që nuk janë viktimizuar – pasi miqtë nuk mund ta kuptojnë atë që kanë përjetuar. Për më tepër, viktimat dytësore mund të vuajnë pasoja psikologjike të viktimizimit duke përfshirë humbjen e gjumit, depresionin, fajn, frikën dhe izolimin.

3.Viktima në procedurë penale

Gjatë pjesës më të madhe të shekullit të njëzetë, viktimat e krimit luajtën një rol të kufizuar në procedurat penale në shumë juridiksione. Vetëm në vitet 1970 dhe 1980 studiuesit dhe politikëbërësit filluan të sfidojnë rolin e zvogëluar të viktimave në procesin e drejtësisë.

Gjatë Mesjetës së Hershme, viktimat e krimit luajtën një rol të rëndësishëm në administrimin e drejtësisë penale duke marrë pjesë aktive si prokurorë privatë. Megjithatë, gjatë shekujve, viktimat u marginalizuan nga gjykimet penale si në juridiksionet e ligjit zakonor ashtu edhe në atë civile dhe roli i viktimës u bë kryesisht ai i një dëshmitari. Në këtë rol, viktimat kishin pak mundësi për të paraqitur pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre gjatë procesit dhe për të marrë pjesë aktive në gjyq, përveç rasteve kur dëshmonin. Një nga studiuesit e parë që e pranoi situatën ishte McDonald (1975, 650) i cili e përshkroi viktimën si “njeriun e harruar” në procedurën penale. Diku midis fundit të viteve 1960 dhe fillimit të viteve 1980, perceptimi i viktimave dhe nevojave të tyre pësuan ndryshime të rëndësishme në shumë shtete perëndimore. Gjatë kësaj kohe, studiuesit fillimisht filluan të vënë re dhe të

trajtojnë mungesën e viktimave nga sistemi i drejtësisë penale dhe të nxjerrin në pah problemet që lidhen me trajtimin e tyre.¹³⁴

Debati akademik u përforcua dhe u rrit ndërgjegjësimi i publikut për viktimat dhe rolin e tyre në sistemin e drejtësisë penale kontribuoi në miratimin e një instrumenti ndërkombëtar. Në vitin 1985, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (OKB) miratoi unanimisht Deklaratën e OKB-së për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit (Deklarata) në Rezolutën 40/34 duke theksuar se “milionë njerëz në mbarë botën vuajnë dëm si rezultat i krimit dhe shpërdorimit të pushtetit dhe se të drejtat e këtyre viktimave nuk janë njohur në mënyrë adekuate”.¹³⁵

Asambleja e Përgjithshme emëroi një sërë parimesh bazë të drejtësisë për viktimat (“parimet bazë”) që Shtetet Anëtare duhet të miratojnë në mënyrë që të reduktojnë viktimizimin dytësorë dhe të sigurojnë drejtësi dhe ndihmë për viktimat.

Deklarata përshkruan katër mënyra të dëmshpërblimit për viktimat e krimit: aksesin në drejtësi dhe trajtim të drejtë (pikat 4–7), kthimi (pikat 8–11), kompensimi (pikat 12–13) dhe ndihma (pikat 14–17).¹³⁶ Shumë parime bazë të përfshira në Deklaratë kanë të bëjnë me ofrimin e “shërbimeve” për viktimat. Të tilla “të drejta shërbimi” përfshijnë trajtimin e viktimave me respekt, sigurimin e tyre me informacion në lidhje me procedurat, si dhe përparimin e çështjes së tyre individuale dhe ofrimin e mundësive për të marrë dëmshpërblim nga shkelësi ose kompensim nga shteti për humbjet e pësuar nga një akt kriminal. Këto parime bazë “të lidhura me shërbimin” janë kryesisht të padiskutueshme në Shtetet Anëtare.

Një parim bazë i përfshirë në seksionin 6(b) lidhur me dhënien e zërit të viktimave në sistemin e drejtësisë penale, megjithatë, u debatua fuqishëm gjatë

¹³⁴ Braun Kerstin, “Victim participation rights-variation across criminal justice systems”, 2019, pg.2

¹³⁵ United Nations. Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power, November 1985

¹³⁶ Po aty

hartimit të Deklaratës. Seksioni 6(b) i Deklaratës përcakton në mënyrë eksplicite se:

Përgjegjshmëria e proceseve gjyqësore dhe administrative ndaj nevojave të viktimave duhet të lehtësohet nga:

(Pika b) Lejimi i paraqitjes dhe shqyrtimit të pikëpamjeve dhe shqetësimeve të viktimave në fazat e duhura të procedurës ku preken interesat e tyre personale, pa paragjykuar të akuzuarit dhe në përputhje me sistemin përkatës kombëtar të drejtësisë penale.¹³⁷

Gjatë procesit të hartimit të Deklaratës, Shtetet Anëtare reagueshan ndryshe ndaj propozimit për futjen e të drejtave pjesëmarrëse të viktimave në sistemet përkatëse kombëtare të drejtësisë penale. Disa Shtete Anëtare ishin të shqetësuara për rreziqet e mundshme për garancitë procedurale të të pandehurve nëse viktimave u lejohej të paraqisnin pikëpamje dhe shqetësime. Të tjerë argumentuan se viktimave nuk u ishte dhënë e drejta të paraqisnin pikëpamje dhe shqetësime në sistemin e tyre për të mbrojtur viktimat nga procedimet që përndryshe mund të ishte traumatike. Pavarësisht këtyre shqetësimeve, Deklarata u miratua unanimisht nga Asambleja e Përgjithshme në 1985 pa votim dhe pa asnjë rezervë nga shtetet anëtare.¹³⁸

3.1 E drejta Europiane për të drejtat e viktimave

Ndërsa komuniteti ndërkombëtar bëri përparim në të drejtat e viktimave, BE-ja filloi rrugën e saj drejt një zone të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, duke përfshirë edhe fushën e viktimave të krimit.

- BE-ja ndërmori hapin e parë në njohjen e rëndësisë së kompensimit për viktimat e

¹³⁷ United Nations. Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power, November 1985

¹³⁸ Po aty.

krimit me miratimin e “Vendimit Kuadër të Këshillit për gjendjen e viktimave në procedimet penale” në mars 2001. Ky vendim udhëzon shtetet anëtare të marrin masat e duhura për të siguruar që viktimat e veprave penale të kenë të drejtë të marrin vendim për kompensim në procedurë penale. Megjithatë, vendimi nuk përmend kompensimin shtetëror.

- Si hap tjetër madhor drejt krijimit të të drejtave evropiane të viktimave, në vitin

2004 u miratua “Direktiva e Kompensimit”¹³⁹. Direktiva imponon një detyrim të qartë për Shtetet Anëtare që të kenë skema shtetërore të kompensimit për krimin e dhunshëm të qëllimshëm, duke përfshirë krimin e terrorizmit. Instrumenti përfshin gjithashtu mekanizma për të lehtësuar kërkesat për kompensim në rastet ndërkufitare. Sipas nenit 1 të Direktivës së Kompensimit “Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që kur një krim i dhunshëm i qëllimshëm është kryer në një Shtet Anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar ku aplikuesi për kompensim është rezident i zakonshëm, aplikanti ka të drejtë të paraqesë kërkesën. një autoriteti ose ndonjë organi tjetër në këtë shtet anëtar të fundit”.¹⁴⁰

- Në vitin 2012, BE-ja ndërmori një hap tjetër të rëndësishëm drejt garantimit të të drejtave

të viktimave të krimit me Direktivën e vitit 2012 që përcakton standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit (Direktiva e të Drejtave të Viktimave)¹⁴¹. Kjo Direktivë forcon të drejtat e viktimave në krahasimi me Vendimin Kuadër të Këshillit të vitit 2001. Kjo direktivë horizontale përbën gurthemelin e politikës së BE-së për të drejtat e viktimave, e cila është e zbatueshme në Shtetet Anëtare që nga nëntori 2015. Direktiva për të drejtat e viktimave parashikon një sërë rregullash detyruese për

¹³⁹ Council Directive 2004/80/ EC of 29 April 2004 relating to compensation to crime victims, available at: <https://eur-lex.europa.eu/homepage.html>

¹⁴⁰ Po aty

¹⁴¹ Directive 2012/29/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012 establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA, available at: <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2012/29/oj>

të gjitha viktimat e të gjitha krimet. Ai përfshin të drejtën për t'u njohur dhe trajtuar në mënyrë të respektueshme, të ndjeshme, të përshtatur, profesionale dhe jodiskriminuese. Për sa i përket kompensimit, ai parashikon të drejtën për të marrë një vendim mbi kompensimin nga shkelësi brenda një kohe të arsyeshme gjatë procedimit penal dhe që Shtetet Anëtare do të nxisin masat për të inkurajuar shkelësit që të ofrojnë kompensim adekuat për viktimat (neni 16).¹⁴²

- Më 15 mars 2017, Bashkimi Evropian miratoi Direktivën (BE) 2017/541 për luftimin e

terrorizmit (Direktiva kundër terrorizmit)¹⁴³. Kapitulli V i kësaj directive përcakton në mënyrë eksplicite dispozitat për mbrojtjen, mbështetjen dhe të drejtat e viktimave të terrorizmit. Këto rregulla të reja bazohen në rregullat tashmë ekzistuese horizontale të BE-së për viktimat e krimit, (Direktiva për të Drejtat e Viktimave dhe Direktiva e Kompensimit). Shtetet Anëtare duhet të krijojnë shërbime mbështetëse konfidenciale, pa pagesë dhe lehtësisht të aksesueshme për të ndihmuar viktimat e terrorizmit menjëherë pas një sulmi terrorist dhe për aq kohë sa është e nevojshme. Për sa i përket kompensimit, kërkohet nga këto shërbime mbështetëse që të ndihmojnë viktimat e terrorizmit me pretendimet në lidhje me kompensimin që është në dispozicion sipas ligjit kombëtar. Kjo direktivë ka hyrë në zbatim në Shtetet Anëtare vetëm në shtator 2018 dhe ende nuk është aplikuar plotësisht në Shtetet Anëtare. Komisioni po vëzhgon nga afër këtë proces.

- Në nivel Evropian gjithashtu janë miratuar një varg dokumentesh me qëllim të avancimit

juridik të pozitës së viktimës, ndër to vlen të përmendën: Konventa Evropiane mbi kompensimin e viktimave të krimit e vitit 1983, rekomandimet si: Rekomandimi Nr. (85) 11 mbi pozitën e viktimave në kornizën e ligjit penal dhe të procedurës penale, që rregullon pozitën e viktimës prej momentit të

¹⁴² Po aty.

¹⁴³ Directive 2017/541/UE of the European Parliament and of the Council of 15 March 2017 on combating terrorism and replacing Council Framework Decision 2002/475/JHA and amending Council Decision 2005/671/JHA

pësimit, gjatë marrjes në pyetje për herë të parë si dhe mbrojtjen e saj në të gjitha fazat e procedurës penale. Si akte të tjera që përcaktojnë të drejtat e viktimave të krimit në nivel evropian janë: Rekomandimi Nr.4/85 Mbi mbrojtjen e viktimave në familje; Rekomandimi nr. 21/87 Mbi mbështetjen e viktimave dhe Parandalimin e Viktimizimit; Rekomandimi nr. 8/2006 Mbi ndihmën ndaj viktimave të krimit etj.¹⁴⁴

Viktimave (dhe dëshmitarëve) të krimeve shpesh u kërkohet të marrin pjesë në procesin e drejtësisë penale, pavarësisht nëse ata e kanë raportuar me dëshirë apo jo krimin. Pjesëmarrja në procedurat e drejtësisë penale mund të shtojë ndjenjat e ankthit, frikës, zhgënjimit, konfuzionit dhe zemërimit që viktimat ndjejnë si pasojë e viktimizimit¹⁴⁵, prandaj ndërmarrja e masave që të reduktohen përjetimet e pakëndshme për viktimën dhe duhet siguruar që nuk do të bëhet zvarritja e procedurës.

4. Viktima dhe të drejtat e saj, në Shqipëri

Në vendin tonë përkufizimi i termit ligjor që përdoret tani edhe në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë në lidhje me *viktimën* është ndikuar nga këndvështrime të ndryshme. Por, këtu mund të veçojmë disa prej tyre. Në përgjithësi konsiderohet si viktimë personi juridik, ose ai fizik, të cilit i janë lënduar apo atakuar të mirat e tij të garantuara me ligj, si: jeta, integriteti trupor a moral, liria, pasuria etj.

Në Fjalorin e Gjuhës së sotme Shqipe, me viktimë kuptohet ai që plagoset a vritet në një aksident, që dëmtohet a vdes nga termeti, përmytjet etj, ai që vritet a plagoset nga dikush, ai që pëson pa të drejtë një të keqe të madhe nga dikush. Për mënyrën se si është përkufizuar ky term, në akte të ndryshme janë shtjelluar edhe argumentet pro tij, nga të cilat mund të veçojmë dy aspekte: *Së pari*, nga keto përcaktime është lënë hapësirë që të përfitojnë dhe të quhen të tillë edhe viktimat e krimeve të luftës, pavarësisht në të shumtën e vendeve

¹⁴⁴ Avni Puka, "Mbrojtja Juridike e Viktimës së Krimit", fq.6

¹⁴⁵ Nicky Ali Jackson, Kathryn M. Campbell, Margaret Pate, "The victimology of wrongful conviction- Innocent Inmates and Indirect Victims", Routledge, 2022, pg.104

autorët e këtyre krimeve nuk janë evidentuar dhe nuk janë vënë para përgjegjësisë penale. Pra, në këto rrethana, ata vihen në një farë mënyre në një pozitë të mbrojtur. Së dyti, jo pa qëllim, sipas nenit 2 të Direktivës së Parlamentit dhe Këshillit të Europës, si të tillë janë nënkuptuar edhe të gjithë anëtarët e familjes së një personi, vdekja e të cilit është shkaktuar drejtëpërsëdrejti nga një veprë penale dhe që ka pësuar dëm si rezultat i vdekjes së atij personi.¹⁴⁶

Në Shqipëri të drejtat e viktimës janë të rregulluara në Kodin e Procedurës Penale, në nenin 9/a të tij theksohet se të gjitha organet publike duhet të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe që duhet të mbrohen nga ridëmtimi.

Gjithashtu një sërë të drejtash tjera janë të parapara po në Kodin e Procedurës Penale në Shqipëri për të drejtat e viktimës së veprës penale :

- a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;
- b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;
- c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;
- d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;

Por gjithashtu ka dhe pika tjera të parapara në Kod, ku viktimës duhet ti ofrohet dhe ndihmë juridike falas, që ka të drejtë ankimi në gjykatë ndaj

¹⁴⁶ Av. Prof. as. Dr. Fehmi Abdiu , Revista Avokatia, “Statusi i viktimës dhe padia civile në procesin penal nën optikën e ndryshimeve të K.Pr.P.”

vendimit të prokurorisë, të kërkojë shpërblim të dëmit, të informohet për arrestimin ose lirimit e të akuzuarit etj.¹⁴⁷

Për sa i përket të miturve është paraparë se duhet të shoqërohet nga një person i besuar, të ruhen të dhënat personale të të miturit, gjithashtu të miturit kanë të drejtë që me anë të përfaqësuesit të tij, të kërkojnë gjykim të zhvillohet pa publik. Për trajtimin e të miturve në procedurë penale nga ana e organit procedues të ketë parasysh moshën e të miturve, personalitetin e tyre që të shmangen pasojat e dëmshme për zhvillimin dhe edukimin e saj të ardhshëm.¹⁴⁸

Duke iu referuar atyre që u përmendën më lartë në një udhëzim nga Ministria e Brendshme e Shqipërisë për viktimat e dhunës në familje, thuhet:

Ju (viktima) keni të drejtë:

- të denonconi pranë çdo Stacioni Policie, ku jetoni apo ndodhni;
- t'i drejtoheni Njesisë Administrative ose Qendrës Shëndetësore ku banoni;
- të telefononi (ju ose te afërmit tuaj) në çdo moment, për të raportuar dhunën në numrin e Policisë së Shtetit pa pagesë 112;
- të trajtoheni me dinjitet, pa diskriminim;
- të kërkonin plotësimin e kërkesë padisë për urdhër mbrojtjeje nga dhunuesi/ja;
- të bëni kallëzim penal për dhunuesin/en;
- të keni ndihmë ligjore falas;
- t'ju sigurohet mbrojtje e menjëhershme, ju dhe familjarëve tuaj;
- të kërkonin strehim në një Qendër për Viktimat e Dhunës;
- të keni kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të dhunës.¹⁴⁹

¹⁴⁷ Kodi i Procedurës Penal i Republikës së Shqipërisë, Korrik 2017, Tiranë, Kreu VI - Viktima, Viktima Akuzuese, Paditësi dhe i Padituri Civil, Neni 58

¹⁴⁸ Po aty

¹⁴⁹ Ministria e Brendshme Shqipërisë, “Dhuna në familje- të drejtat e viktimave të dhunës”

4.1 Të miturit si viktimat të trafikimit

Viktimë trafikimi do të konsiderohet çdo person fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore¹⁵⁰. Trafikim i personave sipas të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë nënkupton “rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.”¹⁵¹

Një vëmendje të posaçme mbi viktimat e trafikimit i kushtohet të miturve si viktimat të trafikimit. Në një udhëzim nga Ministria e Brendshme, tregohet se cilët janë profesionistët që bëjnë identifikimin e viktimës:

- *Punonjësit e policisë (përfshi, policinë e kufirit)* Duke qenë të profilizuar, punonjësit e policisë nisin identifikimin e viktimave të trafikimit që në kontaktin e parë, në pikat kufitare dhe në vijim zbatohet përpikmërisht Procedurat Standarde të Veprimet.
- *Punonjësit e shëndetësisë (punonjësit e shëndetit parësor (mjekë e infermierë) dhe të mjekësisë ligjore, të psikiatrisë, etj)* Në praktikë, profesionistët e shëndetësisë kanë pozitë unike për të identifikuar fëmijët viktimat, edhe kur këta fëmijë ndodhën nën shfrytëzim (fizik dhe/ose emocional), e për rrjedhojë, kanë një mundësi t’i shpëtojnë fëmijët nëpërmjet raportimit. Shpesh, për shkak të një ekzaminimi shëndetësor, mjeku mund të kryejë mbledhjen edhe dokumentimin e provave dhe të

¹⁵⁰ Ligji nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, Neni 4, pika e.

¹⁵¹ Ligji nr.7895, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 110/a

dhënave konkrete për një ndihmë të kualifikuar emocionale dhe ligjore. Bashkëpunimi ndërmjet profesionistëve të shëndetësisë, autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe OJQ-ve për këtë arsye është e domosdoshme. Së dyti, "si rezultat i vuajtjeve të tyre të tmerrshme", fëmijët viktimë përjetojnë situata që kërkojnë diagnozë dhe trajtim të saktë nga profesionistë të trajnuar dhe të profilizuar. Shumë herë, viktimave iu mungon kujdesi shëndetësor adekuat. Një trajtim mjaft i kujdesshëm mund t'iu ofrojë një jetesë më të shëndetshme dhe eliminojë rreziqet vdekjeprurëse nga sëmundjet që shoqërojnë këto situata abuzimi dhe shfrytëzimi.

- *Punonjësit e shërbimeve sociale:* Nëpërmjet zyrave vendore dhe agjensive përkatëse, punonjësit e shërbimeve sociale përfshihen në mënyrë aktive përgjatë procesit të identifikimit, referimit dhe ndihmës e mbështetjes sociale për fëmijët si viktimë të trafikimit. Kjo ndihmë, sikurse sqarohet në vijim, përfshin ndërgjegjësimin dhe adresimin e shenjave dalluese, bashkëpunimin me strukturat e tjera si psh policia apo shërbimi shëndetësor për garantimin e nevojave të ndërhyrjeve urgjente ndaj rasteve specifike.
- *Punonjësit e sistemi arsimor si aktorë në procesin e identifikimit:* Mësuesit, edukatorët dhe kujdestarët në sistemin shkollor mund të jenë një faktor mjaft i rëndësishëm parandalimi. Fëmijët mund të bëhen viktimë të drejtpërdrejta, por edhe ndërmjetës dhe ndihmës të grupeve të trafikimit. Për këtë, puna fillon nga stafi edukativ: njohja e fenomenit të trafikimit, rreziqeve potenciale dhe formave të tij, do të krijonte mundësi konkrete për mësuesit në identifikimin e shenjave dalluese, apo sendeve me vlerë.¹⁵²

4.1.1 Shenjat që nënkuptojnë rastet e trafikimit të të miturve

¹⁵² Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë, "Udhëzues për Identifikimin dhe punën me viktimat e trafikimit", Tiranë, fq.14-17

Gjithashtu në këtë udhëzues që u përmend më lartë jepen orientime për profesionistët që të marrin në konsiderate veprime apo shenja që të miturit shfaqen dhe që mund të lidhen me trafikimin e tyre.

Disa nga shenjat që të miturit viktimë të trafikimit mund të shfaqin janë:

- I mituri/e mitura informon se është keqpërdorur, abuzuar, kërcënuar, shfrytëzuar
- I mituri/e mitura që po kalon kufirin ilegalisht nuk udhëton me dijeninë e prindërve
- I mituri/e mitura nuk ka pasaportë apo ndonjë dokumentidentifikimi dhe rezulton si i paregjistruar (nuk ka pasur ndonjëherë dokument)
- I mituri/e mitura është i/e frikësuar apo i/e pakënaqur
- I mituri/e mitura duket i/e lënë pas dore: është i/e kequshqyer, i/e veshur në mënyrë të papërshtatshme për moshën apokushtet atmosferike
- Shfaqja e lodhjes ekstreme (rrathë të errëta nën sytë ose sy të fryrë, lëvizje të ngadalta të trupit), njolla të errëta/shenja në trup
- Varësia nga droga/alkooli.
- Shtatzëni të padëshiruara për shkak të shfrytëzimit të prostitucionit,
- Depresioni, ankthi, armiqësia, sjellja e nënshtruar
- Ekspozimi ndaj viktimizimit, apo problemeve të integritetit etj.¹⁵³

Në trajtimin e të miturve të cilët mund të kenë qenë viktimë të trafikimit kërkohet një kujdes i veçantë për shkak të natyrës delikate që ato shfaqin, prandaj kërkohet profesionalizë nga ana e personelit që merret me trajtimin e tyre në secilën fazë.

¹⁵³ Po aty

Konkluzione dhe Rekomandime

Viktimizimi në shoqëri është një nga faktorët negativ që pasohet me problematika në zhvillimi e saj, pasi që siç u përmend më lartë faktorët që çojnë në viktimizim janë dhe faktorët që sjellin kriminalitetin në vend. Përballja me rastet e viktimizimit është një sfidë më vete jo vetëm për profesionistët e fushës, apo shtetin por për gjithësecilin prej nesh, pasi në momente të ndryshme mund të jemi viktimë.

Është për t'u vlerësuar fakti që shumë shtete gjithmonë kanë si prioritet përkrahjen dhe ndihmën për viktimat e krimeve të ndryshme, duke filluar që nga momenti që ato i drejtohen organeve për të denoncuar padrejtësitë ndaj tyre dhe më pas kjo ndihmë dhe përkrahje vazhdon edhe gjatë procesit gjyкësor dhe nga shtetet synohet shumë që ndihma dhe përkrahja ndaj viktimave mos të ndalojë me përfundimin e gjykimit dhe dënimin e kryerësit, por të ofrohet e gjithë ndihma e nevojshme për viktimën edhe më pas, duke i ofruar një jetesë të sigurt, një vend pune në rastet e nevojshme, një vendstrehim, trajtim mjekësor/psikologjik .

Përgjegjësia e shtetit mund të shihet në disa faza:

- Parandalimin e viktimizimit
- Luftën kundër viktimizimit
- Identifikimin e viktimave të mundshme
- Mbrojtjen e viktimave
- Riintegrimin e viktimave

Duhet punuar më tepër në ndërtimin e instituconeve profesionale për trajtimin e viktimave, ose marrjes në konsideratë paraprakisht të personave që mund të jetë viktimë potenciale në të ardhmen.

Përgatitja profesionale e kuadrit të punonjësve që kanë të bëjnë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre me viktimë, në mënyrë që ata të arrijnë më tepër të kuptojnë për qasjen që kanë viktimat e krimit dhe krijimin e besimit tek ato.

Ndërtimi i një politike afatgjate për trajtimin/mbështetjen e viktimave në procesin e risocializimit të tyre, sidomos kujdes i veçantë duhet vazhduar në punën e trajtimit të viktimave të mitur.

Referenca

1. Av. Prof. as. Dr. Fehmi Abdiu , Revista Avokatia, “Statusi i viktimës dhe padia civile në procesin penal nën optikën e ndryshimeve të K.Pr.P.
2. Avni Puka, “Mbrojtja Juridike e Viktimës së Krimit”.
3. Braun Kerstin, “Victim participation rights-variation across criminal justice systems”, 2019.
4. Council Directive 2004/80/ EC of 29 April 2004 relating to compensation to crime victims.
5. Directive 2012/29/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012 establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA.
6. Directive 2017/541/UE of the European Parliament and of the Council of 15 March 2017 on combating terrorism and replacing Council Framework Decision 2002/475/JHA and amending Council Decision 2005/671/JHA.
7. [Global study on homicide](#)
8. Halili, Ragip, “Viktimologjia”, Prishtinë , 2011.
9. Harvey Wallace, Cliff Roberson, Julie L.Globokar, “Family Violence: Legal, Medical, and Social Perspectives”, 2019.
10. Kodi i Procedurës Penal i Republikës së Shqipërisë, Korrik 2017, Tiranë, Kreu VI - Viktima, Viktima Akuzuese, Paditësi dhe i Padituri Civil.
11. Ligji nr.7895, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
12. Ligji nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”

13. Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë, “Udhëzues për Identifikimin dhe punën me viktimat e trafikimit”, Tiranë
14. Ministria e Brendshme Shqipërisë, “Dhuna në familje- të drejtat e viktimave të dhunës”
15. Nicky Ali Jackson, Kathryn M. Campbell, Margaret Pate, “The victimology of wrongful conviction- Innocent Inmates and Indirect Victims”, Routledge, 2022.
16. Rejani Thudalikunnil Gopalan , Editor, “Victimology - A Comprehensive Approach to Forensic, Psychosocial and Legal Perspectives", 2022.
17. Sengstock, Mary C. , "The Culpable Victim in Mendelsohn's Typology", April 1976.
18. Shelly Clevenger, Jordana N. Navarro, Catherine D. Marcum, George E. Higgins , “Understanding Victimology", 2018.
19. United Nations. Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power, November 1985.

ABSTRACTS

RREZIKU I KRIJIMIT TË NJË SHTETI HEGJEMON DHE PASOJAT PËR KOMUNITETIN NDËRKOMBËTAR

PhD. Guximtar Rushani

(g.rushani@eust.edu.mk)

MSc. Armand Braho

(a_braho@yahoo.com)

ABSTRAKT

Historia e botës në arenën ndërkombëtare, njeh krijimin e disa shteteve të ndyrshme hegjemonë të cilët krijuan kampe të rrezikshme për sigurinë dhe stabilitetin. Gjithashtu e njëjta pasiguri pasqyrohet edhe sot. Pas përfundimit të luftës së dytë botërore, kampet fituese të saj, ku përfshihej dhe ish Bashkimi Sovjetik, të cilat rezultuan triumfatore nga përplasja ushtarake me miliona të vdekur, do të vendosnin fatet e shteteve humbëse dhe shteteve të tjera të përfshira direkt ose indirekt në luftë.

Fati i shkruar nga fuqitë e medha për shtetet e tjera pas luftës së dytë botërore do të linte të pakënaqur vendet e vogla dhe ato humbëse të luftës. Në këtë moment u krijuan shtet hegjemone të cilat deri në këto momente shtrinë influencat e tyre edhe tek vendet e tjera. Njëkohësisht këto shtete janë aktorët kryes ndërkombëtar të cilat krijojnë fatet për shtetet si Shqipëria, etj.

Krijimi i shtetit hegjemon është një problem tepër i madh për stabilitetin, për shkak se fitimi i një lufte nga një superfuqi, tregon forcën ushtarake dhe potencialin agresiv të tij. Ky mund të përdoret si një kërcënim i mëtejshëm në marrëdhëniet ndërmjet shteteve, pra dominancë ndaj më të dobta. Në një perceptim të përgjithshëm, shtetet hegjemone me influencat e tyre ndikojnë direkt edhe tek shtetet e tjera. Fuqitë fituese në emër të fitores mund të abuzojnë duke vazhduar të rrisin influencat e jashtme të tyre dhe kontrollohet mbi shtetet e vogla.

Shembull tipik është Rusia, dikur Ish Bashkimi Sovjetik, që ka një shtrirje të influencës në të gjithë botën dhe është një prej faktorëve që mund të krijojë një destabilitet. Sidomos dhe perjudhën e fundit, ku ka rritur aspiratat për agresion dhe pushtim ndaj territoreve Ukrainase dhe po përgatit përplasje ushtarake. Pra thënë më thjeshtë Rusia konsiderohet plotësisht një shtet hegjemon dhe mbart një rrezikshmëri të madhe për shtetet e tjera.

Fjale Kyçe: *Hegjemon, Fitues, Marrëdhënie, Shtet, Gjeopolitike, Influcë.*

ПРОБЛЕМАТИЧНИ (НЕФУНКЦИОНАЛНИ) КРЕДИТИ И НИВНОТО ВЛИЈАНИЕ НА ЕКОНОМСКИОТ РАСТ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

PhD. Candidate Elmedina Shuajibi

e.shuajibi@eust.edu.mk

Абстракт

Истражувачките трендови во делот на банкарскиот систем во земјите на транзиција како и влијанијата на банкарските политики и активности врз целовкупната економија на една земја е главната основа на оваа емпириско–теоретска истражување со кое на концизен начин се анализира поимот на проблематичните кредити и кредитниот ризик во Република Северна Македонија во периодот од 2006-2020 година потпирајќи се врз функционирањето на самиот банкарски систем, теоретска конфигурација на концептот на проблематичните кредити па до импактот на овие кредити врз целовкупната економија на Република Северна Македонија.

Врз основа на податоците од Народна Банка на РСМ и Заводот за Статистика на РСМ, со детални описни статистики прецизно се потенцираат статистичките трендови на стапките на проблематичните кредити во РСМ, потоа на Бруто домашниот производ, Активите на банките, Инфлацијата, Невработеноста и вработеноста како и Стапката на вкупна продуктивност на економијата на РСМ како показатели или макроекономски показатели за целовкупната економија на Република Северна Македонија. Потоа, со конклузивни статистики е покажано и каузалноста и импактот на проблематичните кредити врз економијата на Република Северна Македонија.

По обработените податоци, во оваа студија е констатирано дека проблематичните кредити имаат позитивен импакт на Вкупната стапка на продуктивност на економијата на РСМ ($R=.858$ со $\text{sig.}=0.006$), но исто така е констатирано дека проблематичните кредити немаат поврзаност со стапката на Бруто Домашниот Производ на РСМ.

Клучни поими: *Проблематични кредити; Банкарски ризик; Макроекономски показатели; Бруто домашен Производ; Продуктивноста на економијата;*

PROCEDIMI PENAL DHE GJYKIMI SIPAS LEGJISLACIONIT PENAL TE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.

Phd. Firdusi AJAZI

Msc. Elton Kanapari

Abstrakt

Në këtë temë do të mundohemi që të trajtojmë të gjitha fazat në të cilat kalon një çështje penale sipas parashikimeve të legjislacionit penal në Republikën e Shqipërisë.

Fillimi i procedimit penal është një veprim procedural gjatë së cilës bëhet regjistrimi i njoftimit të veprës penale dhe i autorit të dyshuar të saj. Gjatë kësaj periudhe duhet që të bëhen vlerësime të shpejta për të bërë të mundur veprime të tjera hetimore, kufizimin e lirisë, dërgimin e personit në gjykatë për të caktuar masën e sigurisë dhe kur vlerësohet se nuk kemi të bëjmë me një veprë penale, mosfillimin e procedimit penal.

Në fazën e fillimit të procedimit penal duhet që nga ana e autoriteteve proceduese të respektohen të gjitha të drejtat e autorit të dyshuar të veprës penale por edhe të viktimës ose viktimave të veprave penale duke i dhënë letrën e të drejtave të tyre. Në këtë fazë është e rëndësishme që personat e arrestuar ose të shoqëruar t'i mundësohet mbrojtje efektive duke i dhënë mundësinë që të sigurojë një avokat ose në rast të pamundësisë së personave të arrestuar ose të shoqëruar, t'i mundësohet nga ana e autoriteteve një avokat kryesisht i cili do të mund ta mbrojë atë.

Me ndryshimet që janë bërë në vitin 2017 përrsa i përket legjislacionit penal në Republikën e Shqipërisë, një trajtim të veçantë marrin edhe rastet kur kemi të bëjmë me autorë të veprave penale persona të mitur ose kur viktima të veprave

penale janë të miturit. Në këtë rast legjislatori ka parashikuar specifikisht sesi duhet që të veprohet dhe masat e dënimit janë gjithmonë më të ulëta se në rastet kur autorë të veprave penale janë persona madhorë.

Megjithëse kemi të bëjmë me ndryshime ligjore të cilat favorizojnë në mbrojtje viktimat e veprave penale ose autorët e veprave penale të cilët janë të mitur sërish këto të drejta në shumë raste nuk respektohen pasi neglizhohen si nga autoritetet ligjzbatuese po ashtu edhe nga vetë viktimat e veprës penale ose mbrojtësit e tyre, duke mos kryer një mbrojtje efektive dhe të jenë pjesëmarrës aktiv në gjykim. Pavarësisht se këtë të drejtë ja ka njohur ligji sërish kemi mangësi në këtë pjesë pasi në të shumtën e rasteve viktimat është thjeshtë pjesëmarrëse në gjykim dhe nuk merr pjesë aktivisht në gjykim duke ja lënë këtë të drejtë përfaqësuesve të organit të akuzës.

NDËRKOMBETARIZIMI I TERRORIZMIT

PhD. Edlir Ajazi

Msc. Av. Elton Kanapari

Abstrakt

Mund të themi se terrorizmi modern ka filluar më 1968, kur Fronti Popullor për Çlirimin e Palestinës, rrëmbeu një avion dhe i ndryshoi drejtimin për në Romë. Megjithëse avionë ishin rrëmbyer edhe më parë, ishte hera e parë që nacionaliteti i të rrëmbyerve (Izraelit), dhe vlera simbolike që ata përfaqsonin ishte qëllimi i objektivit. Gjithashtu ishte hera e parë që përdorimi i pasagjerëve si pengje bëhej për të fituar publicitet dhe njekohësisht përdorej si një armë kundër Qeverisë Izraelite. Kombinimi i të gjithë këtyre faktorëve çoi në ndërkombëtarizimin e kësaj çështje e cila fitoi një vëmendje të madhe në media. Themeluesi i FPCP, Dr. George Habash tha se niveli i mbulimit nga mediat i kësaj ngjarje ishte shumë herë më i madh se të gjitha betejat e bëra deri më sot me ushtarët Izraelit.

“Të paktën bota është duke folur për ne tani”¹⁵⁴

Është e ditur se strategjia e përbashkët e të gjithë terroristëve është të kryejnë akte dhune të cilat do të tërheqin vëmendjen e publikut, qeverive dhe botës ndaj aspiratave të tyre.

Publiciteti për hir të kauzës është ndoshta çështja kyçe dhe natyrisht media luan një rol të rëndësishëm në strategjinë e tyre. Shumica e njerëzve e shohin aktin e

¹⁵⁴ Gjate një koference për shtyp të Dr. George Habash

dhunshëm të terroristit si iracional dhe të paarsyeshëm. Nëse shqyrtohet nga afër cilido akt terrorist, do të shikoni se kjo nuk është zakonisht e vërtetë. Vetë akti nuk është i rëndësishëm, por rezultati dhe reagimi ndaj dhunës, terroristit pothuajse i garantohet publiciteti për kauzen e tij. Kjo është gati absolute në një demokraci dhe ndoshta më pak e vërtetë në një formë totalitare të qeverisjes. Në shumë vende të botës, terroristi duhet të bëhet me i dhunshëm dhe më spektakolar që të fitojë hapësirë në lajmet kryesore, gjë që fitohet me lehtësi në të kaluarën, por edhe në ditët tona. Megjithatë, duhet thënë se tani shtypi ndërkombëtar nuk raporton për shumë akte që ndodhin në çdo shtet të botës. Terroristi e kupton plotësisht situatën dhe mënyrën për të zënë hapësirën e dëshiruar. Një shembull i ekstremit të dhunës për të fituar lajmin kryesor demonstron më së miri duke kryer akte. Duhet të kuptohet qartë se viktima e një sulmi terrorist shpesh nuk është shënjestra e vërtetë. Shënjestra janë zakonisht spektatorët, shteti, bota. Sulmi mund t'i drejtohet një sektori të veçantë të shoqërisë. Duke kërcënuar dhe duke zbatuar akte të dhunës ekstreme kundër një viktime, terroristi përpiqet të krijojë frikë te viktima, por ç'është më e rëndësishmja tek ata që shikojnë. Të dy varen nga qeveria për mbrojtje, nga ajo që duket e pakuptimtë dhe nga aktet terroriste, të cilat duken të rastësishme. Kur qeveria nuk ofron këtë siguri, ajo mund të duket e paaftë. Terroristi do ta përdorë propagandën e organizatës së vet dhe do të përpiqet të shfrytëzojë këtë dobësi deri në fund. Terroristi mund t'ua tërheqë vërejtjen autoriteteve para një shpërthimi ose një krimi tjetër, nëse autoritetet dështojnë të veprojnë dhe të parandalojnë terrorin, atëherë propaganda e terroristëve për paaftësinë e qeverisë fiton terren. Nëse sulmet terroriste ndodhin për një periudhë të gjatë kohore, gjithnjë ekziston rreziku që qeveria ose publiku të lodhen. Pavarësisht nga nevojat strategjike ose humane për intervenim, sulmi mund të ndikojë në ndryshimin e axhendës botërore ndërsa në kursin e marrëdhënieve ndërkombëtare një individ mund të luajë rol qënësor.

KONTIBUTI I ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR RUAJTJEN DHE ZHVILLIMIN E PAQES DHE SIGURISË GLOBALE

PhD. Gezim Rushiti

(ge-zim1990@hotmail.com)

ABSTRAKT

Problemi i paqes dhe i luftës është një nga problemet më thelbësore që i shtrohen njerëzimit. Trajtimi shkencor i luftës dhe paqes është po aq i vjetër sa edhe vetë shkenca. Paqaja paraqet marrëdhënie të mira ndërmjet njerëzve, pa grindje e pa armiqësi. Gjendje pa shqetësime e një njeriu a e një mjedisi, qetësi, gjendje e qetë në një vend a ndërmjet dy a më shumë shteteve, pa luftëra e pa ndeshje. Marrëveshje ndërmjet dy a më shumë shteteve për të pushuar luftën. Siguria është nevojë dhe gjendje të cilën në mënyrë të drejtpërdrejtë e kanë ndier shumë popuj dhe kombe të botës. Fuqia dhe rëndësia e saj për qytetarin e zakonshëm dhe për shtetin i motivon njerëzit për gjetjen e korrelacionit të sigurisë me ekzistencën e njeriut dhe me mbijetesën e shtetit. Çdoherë kur gjendja e sigurisë ka të bëjë me bashkësinë globale ndërkombëtare, ne këtë e emërtojmë si siguri ndërkombëtare, globale ose universale. Siguria ndërkombëtare, jo vetëm që e përcakton sigurinë kombëtare individuale të përgjithshme por, gjithashtu, është edhe opsion i vlerave të marrëdhënieve ndërkombëtare në kornizat e kombeve-shtete. Organizata e Kombeve të Bashkuara mbijetoi në kohërat e vështira dhe u afirmua si qendër e politikës botërore, institucion i cili ka dhënë kontribut për paqen dhe sigurinë si dhe për zgjidhjen e çështjeve globale të planetit tonë. Qëllimi kryesorë i OKB –së dhe institucioneve të saj është që të ruaj dhe zhvillojë paqen dhe sigurinë globale.

Fjalët kyçe : *Paqja dhe siguria globale, Organizata e Kombeve të Bashkuara, Kontributi i OKB –së për ruajtjen dhe zhvillimin e paqes dhe sigurisë globale, Paqeruajtja, Misionet paqësore të OKB –së.*

GUERNICA, A DOCUMENTARY OF WAR

PhD. Bledar Kurti

Lecturer at Albanian University (bledarkurti77@gmail.com)

Abstract

The painting *Guernica*, by the Spanish painter Pablo Picasso has become a symbol of the terror of war, of human pain and violence against life. It is the postcard of every war around the world, and it even transcends time, symbolizing both the human loss in archaic and modern warfare. It speaks even today, and it remains the most unmasking or unwanted image by the masters or pioneers of war. *Guernica* is a documentary, a nation's lament, a political and human manifesto, a symbol of Cubism and the brilliance of Pablo Picasso's mind and brush. It is not beautiful. It is a masterpiece of pain, a reflection of death, terror, and above all a statement and manifesto written by the hand of humanity. During the Spanish Civil War of 1936-1939, Guernica was just an ordinary town, but the experiment of destruction that was planned for it exceeded human mercy and integrity. On April 26, 1937, fighters of the German Condor Legion, together with Mussolini's Italian forces, bombarded Guernica for more than three hours. Low-flying planes dropped bombs and machine-gunned the residents hiding in the fields, killing two thousand innocent people.

In this paper I will explain the historical background, artistic symbolism, the usage of imagery and literary frame from Nietzsche's "madman", in some concepts of his works, and from the myths of Perseus, Pegasus and Medusa. I will interpret how the composition conveys the human tragedies. The paper provides detailed explanation on the lantern, the stigmata, and the bull who looks furious at the center of the work; and how fury and beastliness are manifest through the bull, the soul of Spain.

This paper deals with how *Guernica* is a symbolic provocation, a tragic documentary, and a strong message of indignation and personal anger, and why has become the symbol of anti-war movement and stance.

Key words: *Guernica, Picasso, Nietzsche, Hitler, Franco, Spain, Bull, painting, war, terror, documentary, art.*

MARRËDHËNIET TURQI-BE, MBI 50 VJET NË DYERT E UNIONIT

PhD.Cand.Robert Dauti

[\(robertdauti@outlook.com\)](mailto:robertdauti@outlook.com)

ABSTRAKT

Marrëdhënia e Turqisë dhe Bashkimit Evropian ka qënë gjithmonë një nga çështjet më të diskutuara dhe më të komplikuar në historinë e Bashkimit Evropian, që nga fillimi i zgjerimit të tij. Prej vitit 245, kur Turqia aplikoi për anëtarësim në Bashkimin Evropian, marrëdhëniet midis tyre kanë qënë sa të afërta aq shpesh edhe të ftohta dhe tepër të tensionuara. Turqia ka punuar për të realizuar zhvillimin dhe përshtatjen e duhur, për të siguruar anëtarësimin në BE, por ngjarjet e ndryshme, faktorët e brendshëm dhe të jashtëm, shpesh e kanë cuar shumë pranë anëtarësimit dhe shpesh e kanë bërë tejet të pamundur, sa përpjekjet për anëtarësimin e Turqisë të zgjasin për më shumë se 50 vjet.

Studiuesit e kësaj marrëdhënie kanë menduar si zgjidhje më të mirë, partneritetin e privilegjuar në vend të anëtarësimit të plotë edhe pse mënyra se si Bashkimi Evropian ka verpuar ndaj Turqisë, është ajo e anëtarësimit të privilegjuar. Turqia, si një vend me 97% të territorit në Azi, me një popullsi shumë të madhe dhe besim muslyman, por dhe me një ekonomi mjaftueshëm të zhvilluar, nuk e ka të nevojshme anëtarësimin në BE, por cilat janë arsyet që një marrëdhënie reciproke mes tyre, është e domosdoshme? Ky punim ka si qëllim, të studiojë historinë e Turqisë ndaj Bashkimit Evropian, faktorët që kanë ndikuar në mosanëtarësimin e saj, problemet aktuale të Turqisë, ku përmendim atë me Qipron, konfliktin në detin Egje, apo çështjen e refugjatëve Sirianë, të hedhë dritë në përparimet që ka bërë Turqia dhe kriteret e Kopenhagenit. Gjithashtu, në fund të tij analizohen përfundimet dhe mundësia e një anëtarësimi të ardhshëm.

Fjalë kyçe: Turqi, BE, anëtarësim i privilegjuar, faktorët e brendshëm, Qipro

COMMUNICATIONTECHNIQUES IN THE RECOGNITION AND REASSESSMENT OF CULTURAL HERITAGE

PhD. Dhurata LAMÇJA

Abstract

A culturally sensitive curriculum is best suited to a multicultural society. Schools that recognize the variety of their student body appreciate the value of developing cultural understanding. Teachers who want to create cultural awareness in their classrooms should actively show their pupils that they care about their cultural, emotional, and intellectual requirements. To that end, there are various tactics you may employ in order to develop trusted connections with different kids. Anthropologists and biologists define culture as the combination of characteristics that distinguishes one group from another. There are two options: either fierce competition between distinct cultures or an evolutionary growth spiral in which traits and innovative impulses are readily shared between otherwise distinctly different cultures. As a result, new knowledge would be accumulated. Education is defined as "the tool for both the whole development of the human individual and that person's engagement in social life."⁶ It may happen at any age, thanks to the acts of multiple institutions such as family, community, and the workplace. It can also happen through engagement with nature, especially when that interaction is socially and culturally defined. Despite these numerous influences, the school remains the most visible educational institution, and its role is critical to the evolution of society. It strives to enhance learners' potential through knowledge transfer and the development of competencies, attitudes, and values that will prepare them for life in society. As a result of this paper there have historically been two ways of understanding human culture, cultural creation, and cultural heritage: as an indivisible complementing whole, the outcome of social actions, or merely as a matter for the individual, ultimately bound by human nature. The aim of the paper is to examine the importance of cultural heritage and its adoption in the curriculum of education.

Keywords: *cultural, heritage, education, teachers, communication, techniques*

SFIDAT E MAQEDONISË TË VERIUT NË POLITIKËN E JASHTME

(A është gati RMV për një “*Marrëveshje të dytë të Prespës*” me Bullgarinë?)

PhD. Senada Laçka

International University of Struga (s.lacka@eust.edu.mk)

Abstrakt

Duke pasur parasysh faktin që Republika e Maqedonisë të Veriut sapo ka përfunduar një konflikt diplomatik 27 vjeçar me Greqinë duke e përmbyllur me sukses kontestin nëpërmjet Marrëveshjes të Prespës, sfida e radhës me Bullgarinë në pragun e realizimit të procesit e Berlinit, konsiderohet një sfidë e vështirë për të cilën Maqedonia e Veriut do të duhet të deklarohej nëse do të jetë gati për një “*Marrëveshje të re të Prespës*” me Bullgarinë ose palët do të mbështeten në Marrëveshjen për miqësi të mirë me shtetin Bullgar, të lidhur në 1 gusht 2017. Me përfundimin e Samitit të Sofijas në 10 dhjetor të vitit 2020 , i realizuar për herë të parë nga një shtet anëtar i BE-së, Bullgaria dhe një shtet kandidat për antarësim në BE- Maqedonia e Veriut, si një moment historik dhe për vetë faktin që dy shtetet fqinje ndodhen para një sfide të rëndësishme politike, historike dhe diplomatike që mund të bllokojë më tej rrugën e integritetit të Maqedonisë të Veriut në BE.

Duke analizuar vështrimin historik të marrëdhënjëve bilaterale mes palëve, ky punim shkencor do të vendos theksin mbi çështjet e pazgjidhura dhe sfidat dy shteteve si pengesë serioze në hapjen e negociatave për antarësim të Maqedonisë të Veriut në BE duke u mbështetur në Marrëveshjen për Fqinjësi të mirë mes palës bullgare dhe asaj maqedonase.

Fjalë Kyçe- Marrëdhënie bilaterale, Maqedonia e Veriut, Bullgaria, BE, Marrëveshja për fqinjësi të mirë.

KONCEPTI JURIDIKO-PENAL I BASHKËPUNIMIT NË OPTIKËN HISTORIKO-JURIDIKE SHQIPTARE.

Xhenis Sina

Abstrakt:

Në këtë artikull bëhet një prezantim i konceptit juridik të Institutit të bashkëpunimit sipas një rendi kronologjik historik sipas të Drejtës në Shqipëri. Në veçanti analizohen kodet penale që kanë vepruar nën pushtete të ndryshme politike dhe ndryshimet thelbësore që ka pësuar bashkëpunimi në secilin prej tyre. Në lupën krahasimore shqyrtohen format nëpërmjet të cilave shfaqet ky institut i rëndësishëm i të drejtës penale dhe evoluimi i tyre.

Fjalë kyce: *E drejta zakonore; Kanuni i Lek Dukagjinit; Kodi penal otoman; Kodi penal i vitit 1928; Kodi penal i vitit 1952; Kodi penal i vitit 1972; Kodi penal i vitit 1977; Kodi penal i vitit 1993; organizatë kriminale.*

PARALLEL LEARNING OF TWO OR MORE LANGUAGES

PhD. Edi KELA

Edikela17@gmail.com

ABSTRACT

There are various theories about how to teach a child to simultaneously use two languages. Many scientists agree that a child who is exposed to a parallel study of two languages in early childhood will naturally learn to use both languages. The child in this period will certainly go through different stages of intermingling in languages; borrowing words from the other language to express an idea, sometimes even in the same sentence. This is because a particular word can exist in one language, but not in the other one. Although, more specifically the meaning of a particular word in one language, can give a message that is not easily translated into the other language.

Children can experiment with languages to make a special effect or to focus themselves in certain situations. For example, one language may have less significance and it will be used to transmit information related to one's home or family, while the other may be used more formally in communication outside the home. However, there will still be periods where one language will be used more.

With this paper I will try to examine the obstacles and problems that arise in the parallel learning of two languages.

Key words: *two languages, obstacles, problems*

VIKTIMOLOGJIA DHE RËNDËSIA E STUDIMIT TË SAJ (POZITA E VIKTIMAVE NË SHQIPËRI)

MSc.Albina BERISHA

International University of Struga (a.berisha@eust.edu.mk)

Abstrakt

Kriminaliteti ndër vite ka pësuar një rritje të madhe gjithashtu është sofistikuar në metodat e tij. Me rritjen kaq të madhe të numrit të krimeve, rriten edhe numrat e personave që bien viktima të krimit. Trajtimi i këtyre rasteve kërkon një përkushtim shumë të madh të aktorëve shtetëror dhe jo-shtetëror dhe një bashkëpunim ndërkombëtar për minimizim të rasteve të viktimizimit.

Shoqëria është një hallkë shumë e rëndësishme e zhvillimit të një shteti, përballja e saj me fenomene negative si kriminaliteti, korrupsioni, varfëria, problemet e shumta në brendësi të strukturave familjare, çon në një probabilitet shumë të lartë që kategori të veçanta të bien pre e viktimizimit në vend.

Identifikimi i faktorëve bazë që ndikojnë në shfaqjen e viktimizimit dhe analizimi i këtyre faktorëve dhe pasojat që ato sjellin mund të ndikojnë në uljen e rasteve të viktimizimit.



The Heritage

Çmimi 15 Euro



ISSN 1857-7482